



**AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE**

---





**2022**  
**RAPORT**  
**VJETOR**



CHIEF EXECUTIVE OFFICER

The economic downturn caused by the on-going COVID-19 global pandemic continues to create uncertainty in the global investments market.

The economic downturn caused by the on-going COVID-19 global pandemic continues to create uncertainty in the global investments market. The economic downturn caused by the on-going COVID-19 global pandemic continues to create uncertainty in the global investments market.



**ARMELA KRASNIQI-Kryetare e AMA**

# MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,**

**Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për  
Edukimin dhe Mjetet e informimit Publik,**

**Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,**

Viti 2022 ka pasur një angazhim shumëdimensional nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, angazhim që lidhet me konsolidimin e mbikqyrjes dhe rregullimit të tregut sipas kërkesave ligjore, por dhe me integrimin evropian, duke përfshirë praktikën dhe konceptet, si në homologët tanë nga vendet anëtare të BE-së.

Gjatë vitit të kaluar, AMA, duke njohur rëndësinë e transpozimit të Direktivës së BE - së 2018/1808, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me procesin e integritit të vendit tonë në BE, iu drejtua institucioneve përgjegjëse për nisjen e procesit të transpozimit të pjesshëm të këtij akti ndërkombëtar ligjor. AMA, në bashkëpunim me MIE ka realizuar hartimin e projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndryshimet e propozuara do të sjellin përmirësim të legjislacionit kombëtar lidhur me:

- Garantimin e të drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes;
- Rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive;
- Mbrojtjen e dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve nga përmbytjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre;
- Nxitjen e vetë - rregullimit dhe bashkërregullimit si një plotësim të mekanizmave legjislativë, gjyqësorë dhe administrativë;
- Rritje e aksesit në përmbytjet audiovizive për personat me aftësi ndryshe.

Gjatë vitit 2022, është punuar për hartimin apo ndryshimin e legjislacionit sekondar me qëllim që, brenda kuadrit ligjor të përmirësohet aktiviteti i AMA - s dhe të lehtësohet veprimtaria e operatorëve audio/audiovizivë.

Pas finalizimit të procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, një tjetër proces ka marrë vëmendje prioritare për AMA - n, procesi i lirimit të brezit të Dividentit Digjital, i njohur si brezi DD2. Lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke siguruar përmbushjen e kërkesës në rritje të përdoruesit për trafik dhe ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

Autoriteti, gjatë vitit 2022, u përball me një proces koordinimi shumë kompleks, për shkak të reduktimit të ndjeshëm të brezit UHF, papajtueshmërive midis allotmenteve kufitare me fqinjët, si dhe numrit të lartë të rrjeteve numerike në operim në Shqipëri. Për të zgjidhur këto problematika, u angazhuam në takime bilaterale, multilaterale, komunikime të vazhdueshme shkresore dhe me e - mail me vendet fqinje, për të përshpejtuar dhe nxitur marrjen e dakordësisë mbi Planin (470-694 MHz). Në shtator 2022, AMA finalizoi me sukses procesin e koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti, të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), i cili modifikon Planin GE06.

Si rezultat i negociatave me përgjegjësi dhe profesionalizëm të AMA - s, si dhe vullnetit të mirë të fqinjëve, u mundësua dakordësia për operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin e AMA - s për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audioviziv kombëtar në operim (publik/privat), me qëllim shmangien e deformimit të tregut audioviziv, impaktin negativ tek konsumatori, si dhe garantimin e pluralizmit mediatik.

Shqipëria do të jetë i vetmi vend në rajon, me 7 rrjete numerike kombëtare, ndërkohë që vendet me popullsi dhe hapësira territoriale më të mëdha të tilla si Slloveni, Kroaci, Greqi, Serbi - do të operojnë me 6 rrjete të tilla.

AMA në vijim të eksperiencës së saj të parë, për monitorimin e mbulimit nga OSHMA - të të zgjedhjeve të përgjithshme të 25 prillit 2021, realizoi monitorimin dhe të zgjedhjeve të pjeshme vendore të 6 marsit 2022, në territorin e bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë.

Si dhe në proceset e mëparshme zgjedhore, përmes përmbajtjeve të transmetuara, votuesve u jepej më shumë mundësi të njohin dhe të vlerësojnë kandidatët garues, subjektet politike, platformat dhe propozimet e tyre për komunitetin, të ndjekin dinamikën e fushatës në terren, udhëzimet e KQZ - së etj.

Bazuar në metodologjinë e monitorimit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, AMA çdo ditë raportoi pranë KQZ mbi rezultatet e monitorimit të OSHMA-ve, ndërkohë që paraqiti dhe një raport përmbledhës për të gjithë periudhën.

AMA raportoi pranë KQZ mbi:

- rastet e 6 OSHMA - ve, të cilat nuk respektuan kërkesat e Kodit Zgjedhor, duke transmetuar reklama politike jashtë orarit të përcaktuar;
  - rastet e 12 OSHMA - ve që në edicionet informative nuk mbajtën balancë në kohën që iu lanë dy partive kryesore PS dhe PD;
  - rastet e 9 OSHMA - ve që nuk respektuan kohën e caktuar për subjektin konkurrues me deri në 20% të votave;
  - rastet e 3 OSHMA - ve që tejkaluan kohën limit për transmetimin e reklamave politike për një subjekt konkurrues në zgjedhje;
  - rastet e 7 subjekteve që nuk respektuan kërkesat e Kodit për periudhën e heshtjes zgjedhore;
  - rastet e 3 OSHMA - ve që në sondazhet e publikuara gjatë fushatës nuk prezantuan të plotë treguesit identifikues;
  - rastet e 2 OSHMA - ve që transmetuan sondazhe jashtë kohës së lejuar.
- Ashtu si për zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021, edhe në ato për zgjedhjet e pjesshme vendore të 6 marsit 2022 nuk pati asnjë kontestim në adresë të të dhënave që AMA paraqiti pranë KQZ - së, si nga subjektet politike konkurruese, ashtu dhe nga OSHMA - të.

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Ankesave ka administruar 310 ankesa, të dërguara respektivisht:

- 3% - nga mediat
- 9% - nga bizneset
- 9% - nga shoqëria civile
- 27 % - nga institucionet
- 52 % - nga individë

Ankesat e paraqitura kanë pasur për objekt:

- 32 % - shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 38 % - shkeljen e të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit;
- 15 % - jashtë objektit të AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- 2 % - të drejtën e përgjigjes;
- 13 % - të ndryshëm.

Në lidhje me rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë për rishikimin e Kodit e Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, ka zhvilluar një kalendarintensiv konsultimesh publike, prej të cilave, dy tryeza tematike në Tiranë dhe dhjetë tryeza konsultuese gjeneraliste në qarqet e tjera të vendit (Shkodër/Lezhë, Kukës, Dibër, Elbasan, Korçë, Durrës, Gjirokastër, Berat, Fier, Vlorë).

Përveç shqyrtimit të çdo ankese që mbërritur në Autoritet, në fokus kanë qenë dhe shqyrtimet kryesisht, që ndërrmerren vetë nga stafi. Në vitin 2022 kishte 96 shqyrtime tematike kryesisht, nga të cilat në 38 raste iu akordua tërheqje vëmendjeje OSHMA – ve.

Ndarja e shkeljeve të evidentuara, janë:

- Shkelje etike 29% të rasteve;
- Reklamë e fshehtë 55% të rasteve;
- Reklamë politike 5% të rasteve;
- Të tjera 11% të rasteve.

AMA ka adresuar dhe apele për OSHMA – të gjatë vitit 2022, ku përmendim disa prej tyre:

- Respektimi i kërkesave ligjore për mbulimin e fushatës zgjedhore nga OSHMA-të;
- Apel për OSHMA-të: Kujdes Dezinformimin!;
- Mbi identifikimin e rasteve të shkeljeve etike në programe;
- Identifikimi i viktimeve të abuzimeve seksuale me të mitur është i papranueshëm;
- Respektimi i standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në transmetimet audiovizive;
- Evitimi i përmbajtjeve audiovizive që nxisin dhe justifikojnë dhunën etj.

Një ndër detyrat funksionale të AMA - s është verifikimi i respektimit të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2022, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 249 kontrole të aktivitetit të OSHMA-ve. Nga këto 134 janë inspektime të OSHMA-ve dhe 177 janë monitorime në terren.

Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

Pesembëdhjetë (15) vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar, prej të cilave:

-15 sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve (kabllorë, IPTV, OTT), nga të cilat 12 gjoba janë lënë në fuqi nga Këshilli i AMA-s (tre nga gjobat kanë ulje të masës) dhe 2 është brenda afatit për t'u ankimuar;

-Ndërsa 1 (një) gjobë është shfuqizuar me vendim të bordit të AMA.

Ndërsa për 20 raste të tjera është vendosur tërheqja e vëmendjes ndaj subjekteve OSHMA.



Nisur nga funksionet institucionale dhe objektivat e planit strategjik të veprimit 2021 - 2023 të AMA - s, duke konstatuar pamjaftueshmëri në mbulimin e të gjitha funksioneve e proceseve të kërkuara për realizimin e këtyre objektivave strategjike përfshirë dhe përbalimin e sfidave të hasura nga detyrimet e akteve ndërkombëtare dhe zhvillimet teknologjike në fushën e medias, mbështetur në ligjin organik të AMA - s neni 19 pika 17, AMA i propozoi Kuvendit gjatë vitit 2022 ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Ndryshimet strukturore të propozuara u hartuan në vlerësim të plotë të ligjshmërisë, konkretisht ligjit të AMA-s, atij të pagave e shpërblimeve të strukturave të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe u miratuan me vendimin nr. 64, datë 07.07.2022 të bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në unanimitet.

Pas miratimit të strukturës dhe organikës së re të AMA - s nga Kuvendi i Shqipërisë, vendimi nr. 86/2022, dhe në përmbushje të afateve ligjore, është duke u kryer intensivisht procesi i ristrukturimit në mbështetje të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013” Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil.

Këto që kam përmendur përmbledhtazi, Ju do të keni rast t'i shikoni të detajizuara në përmbajtjen e raportit vjetor 2022, ilustruar me të dhëna dhe faktografi nga aktiviteti dhe performanca e Autoritetit në periudhën për të cilin raportohet.

Ne kemi vlerësuar dhe vlerësojmë maksimalisht bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, rekomandimet e lëshuara prej tij për institucionin, por dhe akorde të tjera që patjetër do të vijojnë, në dobi dhe favor të përmirësimit të punës, duke garantuar shërbim profesional në cilësi dhe në kohë, në përmbushje të detyrave që na ngarkon kuadri ligjor në fuqi.

*Ju faleminderit për vëmendjen Tuaj!*



AUTORITETI I  
MEDIARE  
AUDIOVIZIVE



MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE .....	5
HYRJE .....	15
1. STRATEGJIA AUTORITETIT .....	25
2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2022 .....	27
3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT .....	60
4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT .....	64
5. QEVERISJA E AUTORITETIT .....	70
5.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet .....	71
5.2 Ecuria e proceseve gjyqësore .....	77
6. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM.....	79
6.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara .....	80
6.2 Monitorimet e përmbajtjeve .....	87
7. KËSHILLI I ANKESAVE.....	94
8. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE .....	111
8.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit .....	112
8.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve.....	113
8.4 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit.....	119
8.5 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave.....	122
9. TRANSMETIMET NUMERIKE .....	128
9.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital.....	129
9.2 Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit.....	132
9.3 Kontrata AMA – RTSH.....	134
9.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave .....	135
9.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive.....	136
Kanalet frekuencore të lira në brezin VHF dhe UHF.....	137
9.4.2 Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv .....	138
9.4.3 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio .....	140
9.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive .....	140

10	AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL.....	142
10.1	Organizimi i brendshëm i institucionit .....	143
10.2	Programi i transparencës .....	144
10.3	Aktivitetet e Autoritetit.....	146
10.4	AMA në bashkëpunim me partnerët.....	155
10.5	Marrëveshjet e bashkëpunimit .....	158
10.6	Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s.....	159
10.7	Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore.....	160
11	TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE .....	161
11.1	Menaxhimi i burimeve financiare.....	162
11.2	Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2022.....	162
11.3	Detyrimet financiare të OSHMA-ve.....	167
11.4	Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2022.....	168
12.4.1	Shpenzimet dhe investimet në vitin 2022 .....	169
11.4.2	Ecuria e investimeve: .....	170
11.5	Pasqyrat Financiare .....	171
	ANEKS 1 .....	179
	Anulimi i vendimit nr. 82/2019, datë 04.07.2019, i Kuvendit të Shqipërisë, për lirimin nga detyra të anëtarit të AMA- s.....	188



# PANORAMË E PËRGJITHSHME

## HYRJE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Autoritetit, për vitet 2021-2023, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2022, Autoriteti është angazhuar maksimalisht t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti i Mediave Audiovizive është fokusuar në disa procese të rëndësishme, ndër më prioritaret kanë qenë, ai i lirimit të brezit të Digjital Dividentit, i njohur si brezi DD2 transpozimi i Direktivës së BE-së, rishikimi i Kodit të Transmetimit, Konsultimi Publik për aktet e rëndësishme, ndërveprimi me organizatat partnere, rritja e imazhit ndërkombëtar të Autoritetit, etj.

Lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke siguruar përmbushjen e kërkesës në rritje të përdoruesit për trafik dhe ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti. Në zbatim të këtij procesi, Autoriteti gjatë gjithë vitit ka ndërmarrë një proces koordinimi tejet sfidues për shkak të masave dhe detyrave që na vendos përpara ky proces, por edhe si rezultat i aktorëve të përfshirë.

Në shtator 2022, fal rolit, kontributit, përpjekjeve të pashtershme, këmbënguljes dhe bindjes së homologëve, AMA finalizoi me sukses procesin e koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti, të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), i cili modifikon Planin GE06.

Realizimi i këtij objektivi ishte shumë i rëndësishëm për Autoritetin, pasi i hapi rrugë vijimit të proceseve pasardhëse në kuadër të lirimit të brezit 700 MHz DD2, dhe dhënien në përdorim të këtij brezi në të ardhmen për rrjetet e shpejtësisë së lartë 5G.

Ndërkohë fal negociatave të AMA-s, si dhe vullnetit të mirë të fqinjëve, u mundësua dakordësia për operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin e AMA-s për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audioviziv kombëtar në operim (publik/privat), me qëllim shmangien e deformimit të tregut audioviziv, impaktin negativ tek konsumatori, si dhe garantimin e pluralizmit mediatik.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, Autoriteti është angazhuar në koordinimin ndërkufitar me vendet që lagen nga ujrat e deteve Adriatik dhe Jon për rialokimin e brezit III VHF, i cili do të mundësojë për administratën shqiptare 3 rrjete kombëtare për transmetimet zonare digjitale, në krahasim me 2 rrjete kombëtare sipas Planit GE06. Draft akti është përgatitur nga të gjithë shtetet pjesëmarrëse në këtë grup, dhe pritet të finalizohet për t'u nënshkruar.



Prej muajit shkurt 2022, AMA e ka ushtruar aktivitetin e tij administrativ me trupë të plotë kolegjinale të përbërë prej 7 anëtarësh, duke bërë të mundur miratimin e të gjithë vendimmarrjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, si dhe shumicë të thjeshtë.

Në zbatim të nenit 60 të ligjit organik, AMA, me nismën e tij, ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur disa gara për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë të transmetimit.

Gjatë vitit 2022, për aplikimet për licencë/autorizim, AMA ka vendosur dhënien e licencës së transmetimit audiovizive numerik për 2 subjekte dhe refuzimin e licencës për 2 subjekte (1 radio dhe 1 televizion).

Një prej detyrave më të rëndësishme të Autoritetit në funksion të shërbimit ndaj publikut përmes ofertës programore është edhe shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara.

Gjatë vitit raportues janë realizuar 96 shqyrtime përmbajtjesh, ku në 38 raste AMA ka dërguar tërheqje vëmendjeje për OSHMA-të që nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Duhet theksuar se OSHMA-të kanë pasur një reagim pozitiv ndaj tërheqjes së vëmendjes nga Autoriteti, sidomos në kujdesin që po tregohet prej tyre në transmetimin e reklamave mbi shitjen e barnave (pa recetën e mjekut, si dhe mostransmetimit të reklamave mbi barnat, kur ato bëhen nga moderatorët e programeve apo të ftuarit në programe të ndryshme.

Pozitiv ka qenë dhe reagimi nga OSHMA-të për transmetimin e reklamave të fshehura gjatë edicioneve të lajmeve, për të cilat AMA ka kontaktuar dhe me përfaqësues të sipërmarrësve që kanë promovuar mallrat apo shërbimet e tyre, duke kërkuar shtimin e bashkëpunimit me subjektet audiovizive për marketing, por që ky bashkëpunim të realizohet duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Gjatë këtij viti, puna monitoruese dhe vlerësuese u fokusua në mënyrë periodike në aspekte të rëndësishme të punës dhe aktivitetit të mediave audio/ audiovizive, sikurse:

- a.shkeljet etike në përgjithësi;
- b.mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme;
- c.reklamat dhe komunikimet tregtare, rastet kur janë të fshehura, kur përfshihen në edicionet e lajmeve, mbi medikamentet dhe shërbimin shëndetësor etj.;
- d.respektimi i standardit të shkruar dhe të folur të shqipes;
- e.mbi buketën programore të RTSH-së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive krahas detyrave të përditshme funksionale, ka pasur në fokus dhe përparësitë e vendosura nga Autoriteti si dhe ka vijuar punën instensive për rishikimin e Kodit të Transmetimit.

Për vitin 2022, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar mbi 310 ankesa, të dërguara në AMA, përmes postës, përmes postës elektronike të Autoritetit, rrjeteve sociale dhe strukturës së Call Center.

Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe propozuar masat përkatëse për qindra ankesa, të dërguara në AMA nga qytetarë, institucione dhe organizata të ndryshme, mbi probleme të përmbajtjeve audiovizive. Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave, të ardhura përmes postës zyrtare, postës elektronike, apo strukturës së Call Center, kanë pasur si objekt të tyre shkeljen e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenimin e dinjitetit, si dhe disa ankesa të shtuara ndaj rrjeteve sociale, portaleve dhe gazetave.

Gjithashtu, Këshilli i Ankesave ka vijuar shtimin e kontakteve me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, me agjencitë dhe organizatat për mbrojtjen e fëmijëve: - në veçanti me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, si një agjenci e cila ndjek drejtpërdrejt problemet që lidhen me fëmijët, duke i referuar pranë Këshillit të Ankesave rastet e evidentuara në mediat audiovizive; - me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” në Parlament, me strukturat parlamentare dhe ministore për Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe me aktorë dhe faktorë të rëndësishëm në fushën e mediave audiovizive.

Një proces tejet i rëndësishëm i KA-së ka qenë dhe puna për rishikimin e Kodit të Transmetimit, një detyrim ky që buron nga Strategjia e Autoritetit por edhe rekomandimet e lëna nga Kuvendi. Në këtë drejtim, Autoriteti në Prill të këtij viti organizoi një konferencë ndërkombëtare ku së bashku me grupet e interesit, përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues nga OJF-të etj, nisi procesin e rishikimit të Kodit të Transmetimit.

Projektkodi i ri i transmetimit gjatë procesit të hartimit dhe në fund u shoqërua me diskutime me të gjithë grupet e interesit dhe me aktorët relevantë në këtë fushë.

Që prej publikimit të Projekt - Kodit të plotë të Transmetimit në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi publik – dhe në vijim, AMA ka vijuar gjatë gjithë kohës, që si me njoftime për shtyp përkitazi tryezave konsultuese, ashtu edhe me publikime të herëpashershme, të cilat evidentojnë ndërhyrjet dhe shtesat në Projekt - Kodin e Ri krahasuar me Kodin ekzistues të Transmetimit, jo vetëm të informojë për ndryshimet, por edhe të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, që të konsultohen me këtë draft dhe të bëjnë komentet apo/dhe propozimet e tyre lidhur me të.

Sa i përket veprimtarisë administrative, AMA ka vijuar të ushtrojë kompetencat dhe funksionet që i ngarkon ligji organik, për çështje brenda fushës së kompetencës, si shqyrtimi i aplikimeve edhe kërkesave për marrje license/ autorizimi, dhënie mendimi, shqyrtim i kërkesave të ndryshme të autoritetit, vijim i procedimeve të ndryshme administrative.

Gjatë vitit raportues puna dhe veprimtaria e Autoritetit është fokusuar më së shumti në transpozimin e Direktivës së re për Shërbimet Mediatike Audiovizuale të rishikuar në vitin 2018, e cila është planifikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Shqiptar për 2022-2024. Në drejtim të këtij detyrimit, AMA në muajin qershor 2022, ka përcjellë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), draftin paraprak të projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, si dhe dokumentacionin shoqërues.

Ndërkohë, në muajin nëntor 2022, në takimin e zhvilluar me ekspertë të DG Near dhe DG CNECT, Observatorit European si dhe me përfaqësues AMA/MIE, u la si detyrë përfshirja në projekt - ligj të parashikimeve të Direktivës 2018/1808, lidhur me Video Sharing Platform (VSP) të cilat fillimisht nuk ishin përfshirë në draftin e projekt – ligjit. Ky proces ka vijuar në bashkëpunimin të ngushtë mes AMA-s, MIE-s dhe Komisionit European. Duke marrë në konsideratë punën e bërë, Komisioni ka vendosur të zgjasë për një periudhë 6- mujore afatin për të finalizuar punën legjislative në vazhdim dhe për të përfunduar hapat e mbetur ligjorë dhe procedural, me qëllim përmbylljen e transpozimit në nivelin e kërkuar deri në miratimin në Kuvendin e Shqipërisë brenda dhe jo më vonë se data 31 maj 2023.

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka vijuar plotësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore përkatëse që prekin veprimtarinë e mediave audiovizive. Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik dhe në kuadër të transparencës institucionale, si dhe nevojës për të kërkuar nga palët e interesuara opinione, propozime dhe reagime, hartimi i legjislacionit zbatues u shoqërua me një proces konsultimi dhe këshillimi publik midis palëve të interesuara.

Bazuar në Strategjinë e AMA-s dhe Planin e Veprimit për vitet 2021-2023, u punua për miratimin e rregullores analoge. Prej vitit 2016, kur është miratuar rregullorja audio, nuk është lëshuar asnjë licencë transmetimi audio numerike, si dhe nuk ka patur kërkesë apo interes nga subjekte për t'u pajisur me këtë lloj licence.

Projekt - akti përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e lëshimit dhe rinovimit të licencës të transmetimit audio analoge, duke hequr rregullimin e procedurave për lëshimin e licencave të transmetimit audio mbështetur në rrjet numerik, pasi aktualisht nuk zbatohet dhënia e këtyre licencave. Në këtë akt është hequr procedura rinovimit të licencës të transmetimit audio me përsëritës pasi duke marrë parasysh edhe eksperiencat e vendeve të tjera do të rregullohet me akt të veçantë.

Gjithashtu, kjo rregullore i'u nënshtrua konsultimit publik i cili nisi në Ditën Botërore të Radios, me grupet e interesit me tryeza të mbajtura respektivisht në Tiranë, Korçë dhe Shkodër.

Referuar Strategjisë së AMA-s, implementimi i teknologjisë së transmetimit audio T-DAB paraprakisht kërkon realizimin e një studimi (duke përfshirë identifikimin e interesit për këtë shërbim) dhe analizimi të një zbatimi teknik të planifikimit të frekuencave T-DAB, në përputhje me marrëveshjen GE06 dhe marrëveshje shumëpalëshe midis vendeve të rajonit, lidhur me alokimet e spektrit frekuencor VHF.

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, AMA gjatë vitit 2022, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 249 kontrole të aktivitetit të OSHMA-ve, duke konkluduar në 15 vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA dhe për 20 raste të tjera është vendosur tërheqja e vëmendjes ndaj tyre.

Sa i takon fenomenit të piraterisë dhe në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit mes AMA – AKEP, i cili parashikon dhe ngritjen e përbashkët të grupeve të inspektimit, gjatë vitit 2022 janë kryer 9 inspektime të përbashkëta pranë subjekteve që disponojnë ISP (internet service provider) në gjithë territorin e vendit dhe që kryenin transmetime televizive nëpërmjet internetit.

Ndërkohë, fenomen tjetër që po haset në këtë periudhë është shtimi i numrit të operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s. Për këtë problematikë, AMA, ka përcjellë zyrtarisht pranë AKEP – it (Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare) 14 (katërmëdhjetë) praktika, me qëllim marrjen e masave për mbylljen e 86 (tetëdhjetë e gjashtë) faqeve online, të cilat kryenin shkelje të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar.

AMA, gjatë vitit 2022, ka kryer studime teknike me qëllim rinovimin e licencave të subjekteve që ofrojnë transmetime audio analoge në qarqe të ndryshme të vendit. Gjatë këtij viti, nuk janë çelur gara për dhënie në përdorim të frekuencave audio FM për transmetime analoge, për shkak të mungesës së disponueshmërisë së frekuencave të lira, në ato qarqe ku është shprehur interesi për transmetime audio analoge nga subjektet përkatëse, si dhe nevojës për koordinim ndërkombëtar.

Përfaqësuesit e AMA-s kanë qenë prezent dhe kanë dhënë kontributet e tyre në takimet e organizuara nga Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), Observatori Evropian Audioviziv (OBS), Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES), Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AEK), OSBE/ODIHR, Këshilli i Mediave të Bullgarisë (CEM), Aleanca e Agjencive të Lajmeve Mesdhetare (AMAN), Këshilli i Evropës, Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Mediatike Audiovizive (ERGA), Instituti ASPEN dhe Shoqata e Europës Juglindore.

Në kuadër të bashkëpunimit në zgjerimin e marrëdhëniëve ndërkombëtare, Kryetarja e AMA-s, u zgjodh Zv. Presidente e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA), pas një procesi votimi ku u përfshinë përfaqësues nga 27 vendet anëtare. Kjo është hera e parë që Shqipëria merr një pozicion të lartë drejtues në një nga platformat më të rëndësishme në fushën e transmetimeve të mediave audiovizive.

Gjatë vitit 2022, një delegacion i përbashkët i dy rregullatorëve të medias, së Shqipërisë dhe Kosovës, përkatësisht Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) zhvilluan një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përfaqësuesit e dy autoriteteve rregullatore, kryesuar nga znj. Armela Krasniqi dhe z. Xhevat Latifi, në Departamentin Amerikan të Shtetit, u pritën nga z. Martin McDowell, Drejtor i Zyrës për Evropën Qendrore dhe Juglindore. Delegacioni gjithashtu zhvilloi një takim në Federal Communication Commission me përfaqësues të lartë të institucionit homolog amerikan Federal Communication Commission (Komisioni Federal i Komunikimit).

Gjatë vizitës në Washington, AMA dhe KPM u ndalën në National Press Club ku zhvilluan një takim me Bill McCarren Drejtor Ekzekutiv i National Press Club (Klubit Kombëtar të Shtypit) dhe Gilbert Klein President i Institutit të Gazetarisë, ish President i National Press Club.

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me partnerë të ndryshëm që punojnë në fushën e medias, për realizimin e projekteve të ndryshme në favor të përmirësimit të raportimit në median audiovizive, të pasurimit të literaturës profesionale, në dobi të standardizimit të raporteve mes punëdhënësit dhe punëmarrësit etj. Ka vijuar tradita e bashkëpunimit me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe u realizua studimi “Prirje dhe sfida të mediave televizive shqiptare në epokën e postdigjitalizimit”.

Gjithashtu, vijoi angazhimi i AMA-s për të sjellë në shqip tituj të literaturës së huaj, me “Përkthim në shqip të tekstit universitar “Understanding Human Communication” të Oxford University Press. Autoriteti mbështeti gjithashtu disa studime të rëndësishme mbi “Rolin e medias audiovizive, në formimin e personalitetit tek fëmijët e moshës 6 -14 vjeç”, “Tregu i punës dhe kontrata kolektive në mediat audiovizive”, si dhe “Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore dhe teknike të transmetimeve audio/audiovizive”.

Në zbatim të kontratës AMA - RTSH, gjatë vitit 2022 AMA realizoi dy shqyrtime, një në muajin qershor dhe një në muajin dhjetor, ku në fokus ishin përmbajtjet e transmetuara nga kanalet e RTSH-së, si dhe të dhënat mbi mosmbulimin me sinjal të disa zonave të shërbimit në territorin e vendit tonë.

Gjatë vitit 2022, AMA përgatiti Edicionin e 8 - të të Buletinit Periodik, që jep një pasqyrë të dinamikës në tregun audio/audioviziv, ku përfshihen dhe tregues me natyrë ekonomike dhe financiare, teknike e teknologjike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., në vitin 2021. Buletini është një produkt i standardizuar dhe i qëndrueshëm, si ndihmë konkrete për analizuar problematika e prirje brenda një viti.

AMA në vijim të eksperiencës së saj të parë, për monitorimin e mbulimit nga OSHMA-të të zgjedhjeve të përgjithshme të 25 prillit 2021, realizoi monitorimin dhe të zgjedhjeve të pjeshme vendore të 6 marsit, në territorin e bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë. Në prag të fillimit të fushatës Autoriteti iu drejtua me apel të gjitha OSHMA-ve, duke kujtuar detyrimet nga Kodi Zgjedhor i Republikës, ligji 97/2013, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në njoftimin që u adresua tek subjektet audio/audiovizive shprehej besimi për mbulim të balancuar dhe me standarde profesionale nga redaksitë, për të ndikuar për një proces transparent dhe sa më të dobishëm për qytetarët. Ashtu sikurse edhe procesi i mëparshëm edhe monitorimi i këtyre zgjedhjeve nuk pati ankesa në drejtim të matjeve si nga OSHMA - të ashtu dhe nga subjektet politik garues.





# STRATEGJIA AUTORITETIT

## **STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT TË AUTORITETIT JANË MIRATUAR NGA AMA ME VENDIMIN NR. 94, DATË 14.10.2020.**

Plani i Veprimit përcakton objektivat strategjike të Autoritetit për periudhën 2021-2023, duke marrë në konsideratë faktin se ka objektiva të cilat zgjaten në kohë, përderisa përkojnë me procese të vijueshme të punës së Autoritetit, për shkak të zhvillimeve të reja apo ndryshimeve a përmirësimeve të kuadrit ligjor. Qëllimet strategjike të Autoritetit, të cilat do të mbulojnë periudhën trevjeçare 2021-2023, shoqërohen me objektivat specifike, si më poshtë:

### **1.SIGURIMI DHE NXITJA E DIVERSITETIT DHE PLURALIZMIT:**

- a. Krijimi i lehtësirave në ofrimin e një panorame mediatike pluraliste dhe pasqyrimi i vlerave, aspiratave dhe identitetit të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet nxitjes së debatit demokratik dhe gjithëpërfshirjes.
- b. Nxitja e promovimit të prodhimit programor audioviziv cilësor në gjuhën shqipe, si dhe sigurimi i rritjes së shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive nga OSHMA-të publike dhe private.
- c. Mbrojtja e pluralizmit nga AMA, nëpërmjet forcimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimeve transmetuese, marrëveshjeve për licencimin e OSHMA-ve, si dhe, në veçanti, çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.

## **2. PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE EFEKTIVITETIT TË ROLIT TË MBIKËQYRJES DHE RREGULLIMIT:**

- a. Përmirësimi i zbatueshmërisë së kodeve dhe rregullave të transmetimit, njohja e përballimi i sfidave të rregullimit, përkatësisht amendimi dhe hartimi i legjislacionit, krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike, në harmoni me legjislacionin e BE-së, si dhe mënyrat dhe format e zbatimit të tyre në praktikë.
- b. Riaktivizimi i iniciativës së AMA-s dhe koordinimi i tërësishëm, me të gjithë faktorët institucionalë, në luftën kundër piraterisë dhe në mbrojtjen e të drejtave të autorit.
- c. Vijimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Kontratës së Shërbimit të lidhur me RTSH-në, duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të saj përmes garantimit të konkurrencës së ndershme, në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj.

## **3. QASJE PROAKTIVE PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE TË PËRGJEGJSHME:**

- a. Hartimi dhe realizimi i një sërë veprimtarish që promovojnë edukimin mediatik, duke nxitur aftësinë e audiencave për të vlerësuar dhe kuptuar përmbajtjet audiovizive, në një mjedis mediatik në zhvillim.
- b. Realizimi, organizimi, mbështetja dhe nxitja e kërkimit, duke përfshirë bashkëpunimin me publikun, transmetuesit dhe palët e tjera të interesuara, për të pasur një përfshirje aktive në çështjet e rregullimit të transmetimeve audiovizive.

## **4. NGRITJE E KAPACITETEVE DHE MIRËQEVERISJE:**

- a. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, nëpërmjet fuqizimit të besueshmërisë së publikut, duke zbatuar procese dhe procedura, që janë të hapura e të kontrollueshme, si dhe duke publikuar raportime të qarta e periodike mbi punën e tij, me vëmendje të veçantë ndaj procesit të monitorimit të ankesave.
- b. Vijimi i lehtësimit të barrës burokratike, për subjektet që Autoriteti licencon/autorizon, duke kërkuar mënyra më efikase për të arritur qëllimet e tij.
- c. Ngritja e kapaciteteve të institucionit nëpërmjet trajnimit të stafit aktual apo nëpërmjet shkëmbimit të praktikave të mira me autoritetet rregullatore rajonale, evropiane etj.
- d. Përmirësimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit, për të shmangur rreziqet e mundshme nga sulmet apo hyrjet e paautorizuara në sistemin TIK, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe qasjes në publik.

## 2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2022

**1) AMA menjëherë pas finalizimit të procesit të lirimit të brezit DD2 në fund të qershorit 2022, të fillojë nga puna me procesin e rishikimit të tarifave për t'i dhënë zgjidhje problemit të tarifave të mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së nga operatorët lokalë, duke patur parasysh edhe rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale të cilat janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi.**

Një ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga operatorët lokalë/rajonale ndikuar nga kalimi në transmetimet numerike, lidhet me tarifat e larta të mbështetjes në rrjetin e RTSH-së dhe kërkesa për rishikimin e tyre.

Rishikimi i tarifave të mbështetjes është i ndërvarur nga procesi i lirimit të brezit 700 MHz (DD2), pasi ky proces pritet të shoqërohet me ndryshime në kushtet e licencës të operatorëve lokalë/rajonale/kombëtare, sikurse është ndryshimi i zonës së shërbimit, ndryshimi i parametrave teknikë të transmetimit dhe për pasojë edhe ndryshime të natyrës financiare.

Në kuadër të procesit të lirimit të brezit 700 MHz, AMA në muajin nëntor 2021, ka miratuar Planin e ri Frekuencor në brezin 470-694 MHz, i cili parashikon ndryshime të Planit GE06. Rialokimi i këtij brezi, parashikon 7 rrjete kombëtare numerike, si dhe disa rrjete lokale. Me qëllim implementimin e këtij Plani, AMA në dhjetor 2021, filloi procedurën e koordinimit me vendet e rajonit për të marrë dakordësinë e tyre.

Autoriteti, gjatë vitit 2022, u përball me një proces koordinimi shumë kompleks, për shkak të disponueshmërisë së ulët të frekuencave, papajtueshmërive midis allotmenteve kufitare me fqinjët, si dhe numrit të lartë të rrjeteve numerike në operim në Shqipëri. Për të zgjidhur këto problematika, AMA u angazhua në takime bilaterale, multilaterale, komunikime të vazhdueshme shkresore dhe me e-mail me vendet fqinje, për të përshpejtuar dhe nxitur marrjen e dakordësisë mbi Planin (470-694 MHz).

Pavarësisht përpjekjeve tona, për shkak të kompleksitetit të këtij procesi, e patëm të pamundur finalizimin brenda afateve të kësaj procedure (qershor 2022), duke sjellë efekt domino në vonesa në proceset e mëtejshme të lirimit të brezit 700 MHz (DD2).

Në shtator 2022, fal rolit, kontributit, përpjekjeve të pashtershme, këmbënguljes dhe bindjes së homologëve, AMA finalizoi me sukses procesin e koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti, të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), i cili modifikon Planin GE06.

Finalizimi i procesit të koordinimit në nivel allotmenti i hapi rrugë hartimit të Planit të Migrimit (sipas procedurës së Ishujve Numerik), i cili u përgatit nga ekspertët e huaj në kuadër të projektit të BE "Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit", përfutur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), finalizuar në dhjetor 2022.

Bazuar në Marrëveshjet shumëpalëshe të koordinimit ndërkufitar (si SEDDIF dhe Adriatik & Jon), ku respektohet parimi i ndarjes së barabartë dhe cilësore e kanaleve frekuencore, administratat nënshkruese mundësojnë operimin e 6 rrjeteve kombëtare.

Ndërkohë fal negociatave të AMA-s, si dhe vullnetit të mirë të fqinjëve, u mundësua dakordësia për operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin e AMA-s për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audioviziv kombëtar në operim (publik/privat), me qëllim shmangien e deformimit të tregut audioviziv, impaktin negativ tek konsumatori, si dhe garantimin e pluralizmit mediatik.

Shqipëria do të jetë i vetmi vend në rajon, me 7 rrjete numerike kombëtare, ndërkohë që vendet me popullsi dhe hapësira territoriale më të mëdha të tilla si Slloveni, Kroaci, Greqi, Serbi..., do të operojnë me 6 rrjete të tilla.

Në vijim të procedurave që do të ndiqen nga të gjithë palët e interesit, me qëllim finalizimin e lirimit të brezit DD2, Autoriteti do të iniciojë menjëherë procesin e rishikimit të tarifave të mbështetjes, duke kërkuar nga operatori publik rishikimin e tyre, në mënyrë që këto tarifa të jenë propocionale dhe jodiskriminuese.

**2) AMA gjatë punës për rishikimin e Kodit të Transmetimit të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe faktorët përkatës, përfshi edhe organizatat ndërkombëtare si OSBE, KiE etj., për të bërë të mundur që Kodi i ri i Transmetimit të jetë sa më në koherencë me sfidat dhe zhvillimet në fushën e medias, duke i kushtuar një rëndësi të veçantëmbrojtjes së fëmijëvepërmes parandalimit të promovimit në emisioneapo programe audiovizive të fenomenittë bullizmit, abuzimit seksual, dhunës fizike e verbaleetj.**

Në lidhje me rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë për rishikimin e Kodit të Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, zhvilloi një konferencë në Tiranë në datën 21 Prill 2022 ku së bashku me grupet e interesit, përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues nga OJF-të etj., nisi procesin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Pjesë e këtij takimi ishin edhe Dr. Wolfgang Kreissig, Kryetar i Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të Landeve gjermane dhe i Komisionit të Licencimit dhe Mbikëqyrjes; Francesco Sciacchitano, konsulent për çështjet ligjore në autoritetin rregullator Italian, AGCOM dhe drejtues i grupeve të punës për platformat ndërkombëtare të rregullatorëve; Peter Metzner, zëvendëskryetari i EPRA-s dhe konsulent ligjor për çështjet europiane pranë Konferencës së Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të landeve gjermane; ekspertë komunikimi, përfaqësues të medias publike dhe private kombëtare, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Prof. Dr. Vasilika Hysi, eksperte e ngarkuar me hartimin e Kodit të Ri të Transmetimit. Ky ishte takimi i parë hapës, në kuadër të Rishikimit të Kodit të Transmetimit.

Në datën 16 Qershor 2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive nisi tryezat konsultuese me grupet e interesit për rishikimin e Kodit të Transmetimit. Takimi i parë konsultativ u zhvillua në bashkëpunim me UN WOMEN në Shqipëri, me pjesëmarrjen e gazetarëve të terrenit që mbulojnë kronikën dhe çështje të aktualitetit, si dhe me moderatorë programesh me natyrë sociale. Gjatë kësaj tryeze u prezantuan ndryshimet e bëra në Projekt - Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive, përfshirë seksionin e posaçëm për çështjet e barazisë gjinore. Fokusi i këtij propozimi lidhet me promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi gjinor përfshihen për herë të parë në Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive në Shqipëri.

Në datën 17 qershor 2022 Autoriteti i Mediave Audiovizive vijoi tryezat konsultuese për Projekt - Kodin e ri të Transmetimit, me pjesëmarrjen e shoqatave të grave në vendin tonë. Përfaqësueset e shoqatave të grave vlerësuan përfshirjen e kapitullit të posaçëm për çështjet e barazisë gjinore dhe theksuan nevojën që ka tregu audioviziv në lidhje me trajnimin për këtë fenomen. Shoqëria civile dha sygjerime konkrete sesi Kodi mund të shërbejë si nxitës për parandalimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

Takimet e mësipërme konsultuese u paraprinë nga një takim përgatitor (datë 13 Qershor 2022), gjatë të cilit AMA së bashku me ekspertin për hartimin e Kodit të Ri të transmetimit, znj. Vasilika Hysi diskutuan hollësisht (nen për nen) seksionin e barazisë Gjinore, për të vijuar më pas me të tjera konsultime nen për nen të Projekt - Kodit të Transmetimit me ekspertin, të zhvilluara në datat: 21, 22, 24 Qershor 2022. Rezultatet e këtyre konsultimeve paraprake si edhe sugjerimet e drejtorive përbërëse të AMA-s u hodhën në draftin e dytë të Kodit të Ri të Transmetimit, dorëzuar më datë 1 Korrik 2022.

Projekti i për Kodin e Ri të Transmetimit përmban 11 Seksione:  
SEKSIONI 1 (PARIMET THEMELORE),  
SEKSIONI 2 (E DREJTA PËR PRIVATËSI DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE PERSONALE),  
SEKSIONI 3 (TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE),

SEKSIONI 4 (FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE, me nënndarjet: Parimet themelore për mediat në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës, Media në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës, Ndalimi i identifikimit të fëmijës, Intervistimi i fëmijës, Reklamata dhe fëmijët, Programet kulturore, Argëtuese, Edukuese, Filmata dhe fëmijët, Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive),  
SEKSIONI 5 (RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA DHE AKSESI NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),  
SEKSION I RI (PARANDALIMI DHE LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),  
SEKSION I RI (PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE, PARANDALIMI DHE LUFTIMI I DISKRIMINIMIT GJINOR NË MEDIAT AUDIOVIZIVE),  
SEKSIONI 8 (I RI) (REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),  
SEKSIONI 9 (KËSHILLI I ANKESAVE), S  
EKSION I RI (DISPOZITA KALIMTARE),  
SEKSIONI 11 (HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI).

Gjatë muajit Korrik, Këshilli i Ankesave, si njësi përgjegjëse për ndjekjen e procesit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive verifikoi shkallën dhe mënyrën e reflektimit në Projekt - Kod të propozimeve, të dala nga konsultat e para si edhe të propozimeve të njësive përbërëse të AMA-s dhe ndërmori redaktimin e tekstit për ta bërë gati për konsultim publik.

Po nga Këshilli i Ankesave – si njësi e angarkuar më manaxhimin e procesit të Rishikimit të Kodit të Transmetimit – u hartua Kalendari i dymbëdhjetë i konsultimeve publike vijuese, prej të cilave, dy tryeza konsultuese tematike në Tiranë dhe dhjetë tryeza konsultuese gjeneraliste në qarqet e tjera të vendit (Shkodër/Lezhë, Kukës, Dibër, Elbasan, Korçë, Durrës, Gjirokastër, Berat, Fier dhe Vlorë).

Në fillim të muajit Tetor 2022, Projekt - Kodi i plotë i Transmetimit u publikua në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi Publik – ku do të qëndrojë deri në fund tremujorit të parë të vitit 2023, për të garantuar akses të plotë në dokument jo thjesht dhe vetëm të OSHMA-ve dhe grupeve të tjera të interesit, por edhe të publikut të gjerë, si për t'u njohur me të, ashtu edhe për të formuluar vërejtje, komente dhe propozime për aspekte të caktuara të tij.

Më 5 tetor 2022, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e tretë tematike të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Diskutimi i radhës u përqendrua tek “Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive” si edhe tek “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”. Të dyja problematikat janë kapituj të mëvetësishëm të Kodit ekzistues të Transmetimit, të cilët gjatë rishikimit janë pasuruar ndjeshëm. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile me fokus të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, shoqatave që operojnë në fushën e medias dhe të drejtave të njeriut, botës akademike, studiove ligjore, institucioneve qendrore dhe lokale, pranisë së OSBE-së dhe Këshillit të Europës në Tiranë. Përfaqësuesit e OSHMA-ve, shoqatave për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe atyre për Mbrojtjen e Fëmijëve parashtruan disa problematika dhe bënë disa propozime për ndërhyrje. Ata u përqendruan në rastet kur raportimi në media ka ndikuar identifikimin direkt apo indirekt të fëmijëve, të përfshirë në ngjarje të rënda, mungesën e emisioneve dedikuar fëmijëve, publikimin e pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen edhe nga të miturit, problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, problemet e terminologjisë përkitazi PAK, segregimit apo/dhe mospërfshirjes së tyre në formate gjeneraliste, reklama apo publicitete, mospërfshirjen e titrave në transmetimet audiovizive, problemet e aksesimit fizik të mediave nga ana e PAK dhe diskriminimit pozitiv të tyre në përmbajtje audiovizive, etj.

Më 6 tetor 2022, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e katërt tematike të këshillimit publik, me temë “Parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes” dhe “Të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”, ku morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, botës akademike, të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit Shqiptar të Medias, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Policisë së Shtetit, Bashkisë Tiranë, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në Tiranë.



Përfaqësuesit e institucioneve dhe grupeve të interesit veçuan një sërë problematikash shqetësuese, duke propozuar qasjet dhe këndvështrimet e tyre lidhur me kapitujt e Kodit të Transmetimit në diskutim, duke sjellë në vëmendje raste kur raportimi në media ka shkelur të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, të drejtën për prezumimin e pafajsisë apo ka përdorur gjuhë urrejtjeje, duke nxitur urrejtje dhe përçarje shoqërore. Ata theksuan rëndësinë e Kodit të Transmetimit edhe si mjet sensibilizimi për rritjen e përgjegjësisë profesionale dhe sociale të medias audiovizive në përpjekjet për ndalimin e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore.

Më 13 tetor 2022, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi në Shkodër, tryezën e pestë të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Në ndryshim me katë tryezat paraprirëse me karakter tematik, të zhvilluara në Tiranë, tryeza e zhvilluar në Shkodër pati karakter gjeneralist. Por ndonëse si paraqitja ashtu edhe diskutimet e nxitura prej saj, prekën të gjithë kapitujt e Projekt - Kodit, vëmendja kryesore u përqendrua veçanërisht tek “Barazia gjinore dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive”, tek “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”, tek “Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes” si edhe tek “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Pjesë e këshillimit në Shkodër u bënë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve arsimore, institucioneve lokale, etj.

Përfaqësuesit e OSHMA-ve dhe grupeve të interesit u ndalën tek publikimi i pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen nga fëmijët, tek problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, tek përpjekjet për shmangien e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore, në problemet e aksesit përmbajtësor dhe fizik të PAK në mediat audiovizive, etj.

Duke e shtrirë diskutimin edhe përtej çështjeve të rishikimit të Kodit të Transmetimit, të pranishmit formuluan edhe disa shqetësime të mediave lokale në tërësi, përfshirë vështirësitë financiare, rritjen e detyruar të peshës së njoftimeve me pagesë në programacion, minutazhin e tejzgjatur të komunikimeve tregtare dhe problemet e tyre etike, nevojën e formateve të dedikuara për pakicat kombëtare dhe shtresat vulnerabël, etj.

Që prej publikimit të Projekt - Kodit të plotë të Transmetimit në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi publik – dhe në vijim, AMA ka vijuar gjatë gjithë kohës, që si me njoftime për shtyp përkitazi tryezave konsultuese, ashtu edhe me publikime të herëpashershme, të cilat evidentojnë ndërhyrjet dhe shtesat në Projektkodin e Ri krahasuar me Kodin ekzistues të Transmetimit, jo vetëm të informojë për ndryshimet, por edhe të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, që të konsultohen me këtë draft dhe të bëjnë komentet apo/dhe propozimet e tyre lidhur me të.

### **3) AMA të propozojë ndryshimet e nevojshme lidhur me përmirësimin e legjislacionit mbi reklamat publike në përputhje me standardet ndërkombëtare.**


AMA vëren se ky është një rekomandim i përsëritur nga rezoluta e vitit të kaluar për autoritetin. Autoriteti e mbështet veprimtarinë e tij në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, objekti i të cilit është rregullimi i veprimtarisë së mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre. Në ushtrim të kompetencave të parashikuara në ligjin organik, AMA monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga subjektet audio dhe audiovizive.

Roli i AMA-s bazuar në kompetencat ligjore, lidhet me monitorimin e përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, përfshirë këtu edhe reklamat institucionale.


Sa i përket mënyrës së shpërndarjes së reklamave institucionale, sikurse kemi raportuar në mënyrë periodike dhe të përsëritur, ligji nr. 97/2013 “Per mediat audiovizive ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, nuk parashikon rregulla apo kritere për ndjekjen apo monitorimin e procedurave të shpërndarjes të reklamave institucionale (publike) nga AMA.

AMA monitoron volumin e reklamave institucionale (publike) në lidhje me reklamat e subjekteve tregtare private për subjektet kombëtare audio/audiovizive. Nga muaji gushte deri në dhjetor 2022, AMA ka monitoruar volumin e reklamave institucionale në raport me reklamat e këtyre subjekteve dhe më poshtë po prezantojmë treguesit për televizionet kombëtare, sipas muajve përkatës:

# TREGUESIT PËR TELEVISIONET KOMBËTARE SIPAS MUAJVE:




*Totali i reklamave institucionale (sekonda)*



*Totali i reklamave (sekonda)*

# TREGUESIT PËR TELEVISIONET KOMBËTARE SIPAS MUAJVE:



**4) Duke qenë se, siç theksohet edhe në Raport Progresin e fundit të KE-së, transparencja e financimit të medias mbetet një objektiv kyç për të përmirësuar lirinë e medias në vend, AMA një ndër objektivat kryesor të punës së saj të ketë forcimin e mbikëqyrjes lidhur me çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.**

Autoriteti në rolin e zbatuesit të ligjit organik nr. 97/2013, të ndryshuar monitoron respektimin e kërkesave të nenit 62 të tij që parashikon rregullimin e pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive. Po ashtu referuar planit të veprimit strategjik për vitet 2021-2023, një nga objektivat e punës të AMA-s, është edhe mbrojtja e pluralizmit nëpërmjet forcimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimeve të transmetimit, adresimit të çështjeve të pronësisë dhe kontrollit të medias.

Këto detyrime janë të zërthyer edhe në kuadrin nënligjor në fuqi që parashikon se subjektet që kërkojnë pajisjen me licencë/autorizim për ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive, në aplikimin e tyre duhet të depozitojnë origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen e licencës/autorizimit dhe AMA gjatë shqyrtimit të aplikimeve verifikon burimet financiare që zotërojnë aplikuesit si dhe aspektet e funksionimit ekonomik dhe financiar të subjekteve. Po ashtu, edhe në rastet kur subjektet OSHMA ndryshojnë strukturën e tyre pronësore, AMA përpara vendimmarrjes i kërkon subjektit blerës të kuotave, origjinën dhe burimet financiare justifikuese ligjore për masën e blerjes së tyre (referuar vlerës së kontratës).

Një tjetër instrument për garantimin e konkurrencës së ndershme në fushën e mediave audio/audiovizive është edhe bashkëpunimi rast pas rasti me Autoritetin e Konkurrencës, i formalizuar edhe përmes një memorandumi mirëkuptimi. Në zbatim të tij, AMA shkëmben informacion dhe të dhëna në rastet e ndryshimeve në të dhënat pronësore të subjekteve të licencuar.

Për të realizuar funksionin e tij mbikëqyrës, AMA në mënyrë periodike verifikon të dhënat që subjektet deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfshirë edhe kuotat e pronësisë dhe ndryshimet në to. Referuar legjislacionit në fuqi, të dhënat për regjistrimin e subjekteve janë publike, transparente dhe të disponueshme, ndërkohë që edhe në faqen zyrtare elektronike të Autoritetit publikohen të dhënat e subjekteve të licencuar dhe/ose autorizuar, përfshirë përqindjen e pjesëmarrjes pronësore.

Transparenca e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, parashikohet rishtazi edhe në Direktivën (BE) 2018/1808, që ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë) e cila pritet të transpozohet në ligjin organik të AMA-s.

Në linjë me parashikimet e Direktivës 2018/1808, në draftin e ndryshimeve në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, është propozuar detyrimi i OSHMA-ve për të bërë publik dhe të aksesueshëm, informacionin dhe detaje në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, si element i lidhur drejtpërdrejtë me lirinë e shprehjes.

Për transparencën e pronësisë mbi mediat dhe financimin e tyre, AMA, në cilësinë e zbatuesit të ligjit në fuqi nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga viti 2016 publikon Buletinin Periodik, një përmbledhje treguesish ekonomike e financiarë, teknike e teknologjike, mbi përmbajtjet e transmetuara, burimet njerëzore të angazhuara etj. Në Buletin bëhen transparente dhe të dhëna mbi pronësinë në aktivitetin audio dhe/ose audioviziv. Aty përfshihen tregues mbi strukturimin pronësor, përqëndrimin e kontribuesve të OSHMA-ve në degë të ndryshme të industrisë, si dhe pjesëmarrja pronësore për secilin operator mediatik. Në këtë linjë është dhe edicioni 8 i Buletinit Periodik që u përgatit gjatë vitit 2022.

**5) AMA si një institucion me ekspertizën e duhur teknike të japë kontributin e saj gjatë fazës së rishikimit në Kuvend të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediat online si një realitet i ri në industrinë mediatike ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit të Venecias, për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.**

Sikurse është raportuar në raportet vjetore të AMA-s për vitet 2019-2021, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ndërmarrë iniciativa ligjore, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, objekt i të cilit është përfshirja e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike në fushën e zbatimit të ligjit tonë organik. AMA si organ kolegjal me vendimin nr. 169, datë 18.11.2019, ka dhënë mendim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, duke u shprehur kundër tij.



**6) AMA të koordinojë punën edhe me institucionet e tjera që duhet të kontribuojnë për të bërë të mundur transpozimin e pjesëshëm, brenda vitit 2022, të Direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara etj.**

Me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 91, datë 09 shkurt 2022, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024” është parashikuar transpozimi i pjesëshëm i Direktivës 2018/1808/BE. Sikurse jeni në dijeni në 6-mujorin e parë të këtij viti, AMA duke njohur rëndësinë e transpozimit të Direktivës 2018/1808, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me procesin e integritimit të vendit tonë në BE, iu drejtua institucioneve përgjegjëse për iniciimin e procesit të transpozimit të këtij akti ndërkombëtar.

AMA gjithashtu, në cilësinë e rregullatorit ka analizuar dispozitat e Direktivës (BE) 2018/1808, që ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe ka përgatitur draftin paraprak të projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërkohë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfitoi një asistencë teknike (TAIEX Workshop) lidhur me eksperiencat e vendeve të BE-së për implementimin e Direktivës 2018/180. Në kuadër të kësaj asistence me qëllim njohjen me praktikën më të mirë të vendeve të BE si dhe me problematikat e ndeshura në këto vende gjatë transpozimit të direktivës 2018/1808, në muajt shkurt dhe qershor 2022, u zhvilluan seminare me ekspertët e BE-së. Materialet e prezantuara në seminaret e zhvilluara, njohja me rastet praktike të disa vendeve të BE mbi mënyrën e zgjedhur për transpozimin e Direktivës (BE) shërbyen gjatë hartimit të draftit paraprak të projekt - ligjit.

Në vijim të punës më Transpozimin e Direktivës, AMA, me shkresën nr. 2466 prot., datë 23.06.2022 ka përcjellë në Ministrinë e linjës, për vijimin e procedurave të mëtejshme, relacionin shpjegues të projekt - ligjit mbi analizën e arsyeve që kanë çuar në propozimin e tij si dhe draftin paraprak të projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Projekt - ligji, relacioni shpjegues, raporti i vlerësimit të ndikimit dhe tabela e përputhshmërisë u dërguan për mendim në Ministrinë përkatëse (Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), tek ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive (OSHMA), u publikua në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe tek Komisioni Evropian.

Drafti i projekt - ligjit është publikuar në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, për një periudhë 30 ditore. Gjatë kësaj periudhe, pranë AMA-s janë depozituar në formë shkresore komente nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe janë përcjellë nga MIE, komente nga palë të interesuara. Komentet e ardhura nga Ministrinë kanë qenë kryesisht për zbatimin e teknikës legjislative dhe azhurnimin e përkufizimeve sipas legjislacionit në fuqi, të cilat janë pasqyruar në draftin e projekt - ligjit.

Sa i përket komenteve të ardhurave nga palët e interesuara, AMA i ka përcjellë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (si Ministri e linjës) qëndrimin e saj në formë shkresore, duke nënvizuar se sa i përket dispozitave lidhur me ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit dhe përfshirjen e tyre në projektligjin e sipërcituar, në këtë fazë, ndryshimet e ligjit nr. 97/2013, vijnë si pasojë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me direktivën 2018/1808 (BE).

Ndërsa, lidhur me komentet për përfshirjen në projekt - ligj të disa aspekteve të barazisë gjinore, konkretisht garantimin e barazisë gjinore dhe luftës kundër seksizmit në median audiovizive, garantimin e barazisë gjinore në zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s si dhe të KDRTSH-s, AMA i ka bërë me dije se Kodi i Transmetimit për median audiovizive miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017, është në proces rishikimi publik dhe përmban një seksion të veçantë, dedikuar promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

Ndërkohë, në vijim të takimit teknik të mbajtur online në muajin nëntor 2022, mes ekspertëve të shërbimeve të Komisionit Evropian, Observatorit Europian dhe përfaqësues të AMA/MIE, u kërkuua përfshirja në projektligj të parashikimeve të Direktivës BE/ 2018/1808, lidhur me platformat e shpërndarjes së videove (Video Sharing Platforms / VSPs), si një kërkesë që Republika e Shqipërisë të vijojë të përfshihet në programin “Creative Europe”.

Në vijim të këtij takimi, AMA dhe MIE përgatitën ndryshimet e sugjeruara dhe përfshirjen e tyre në draftin e projekt - ligjit, të cilat iu përcollën sërish për mendim në javën e parë të muajit dhjetor 2022, Komisionit Europian.

Gjatë muajit dhjetor 2022, Komisioni Evropian njoftoi AMA dhe MIE se janë akorduar 6 muaj kohë shtesë (muaji maj i vitit 2023), me qëllim transpozimin në nivelin e kërkuar të Direktivës 2010/12/EU, duke përfshirë kryerjen e të gjitha proceseve të brendshme legislative.

Përfaqësuesit e AMA-s kanë qenë pjesë e grupit të punës “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve”. Në kuadrin e këtij angazhimi dhe planit konkret të veprimit, AMA kontribuoi me masat e mëposhtme:

- Ndryshime në Kodin e Transmetimit për median audiovizive në funksion të interesit më të lartë të fëmijës;
- Monitorim efektiv të përmbajtjeve të transmetuara për fëmijët, duke respektuar kërkesat e ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi. Komunikim me OSHMA-të për rastet e identifikuara si shkelje ligjore duke e shoqëruar me sanksione për rastet e rënda ose të përsëritura;
- Vlerësimin e rasteve të shkeljeve të OSHMA-ve në lidhje me transmetimin e përmbajtjeve audiovizive të papërshtatshme ose abuzive me/për të miturit.

Pasi u njoh përmes komunikimit elektronik me përmbajtjen e draftit “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve”, hartuar nga Ministria e Drejtësisë, AMA propozoi disa ndryshime në përcaktimet e parashikuara pasi disa nga aktivitetet e përcaktuara në matricën e masave dhe aktiviteve të strategjisë, ishin jashtë sferës së veprimtarisë dhe kompetencës së autoritetit rregullator.

Bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, AMA, është organi rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, AMA nuk lëshon licenca/autorizime për veprimtarinë e web-siteve/portaleve online dhe medias së shkruar dhe nuk monitoron veprimtarinë e tyre.

Për sa më sipër, AMA sugjeroi rishikimin e përmbajtjes së disa pikave të matricës së masave dhe aktiviteteve, si më poshtë:

- Në pikën 1.1.4 “Promovimi dhe fuqizimi i programeve me një fokus të veçantë tek prezenca virtuale e fëmijëve/të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta dhe mbrojtja ndaj bullizimit online” dhe nën pikat e saj 1.1.4.1 - 1.1.4.5, AMA nuk mund të kontribuojë si partner pasi mediat online dhe rrjetet sociale nuk janë në fushën e veprimtarisë së autoritetit;
- Në pikën 1.2.1.3 “Emisione në mediat audiovizive me një gjuhë miqësore mbi kuptimin, zbatimin dhe promovimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve”, AMA nuk mund të jetë institucion përgjegjës pasi një prej parimeve themelore të sanksionuara në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është se veprimtaria audiovizive është e lirë, e për pasojë OSHMA-të i bëjnë vetë përzgjedhjet e përmbajtjeve të katalogut programor të tyre.

## **7) AMA në bashkëpunim me AKEP, OSHEE dhe Shoqatën e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë dhe Valorë të punojë për gjetjen e rrugëzgjdhjeve lidhur me problematikën e heqjes nga shtyllat elektrike të kabllave të operatorëve kabllorë.**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në cilësinë e autoritetit rregullator i cili monitoron veprimtarinë e subjekteve të licencuar/autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive, është pale e ndjeshme në problematikat që hasin operatorët në përgjithësi, si dhe kabllorët në veçanti. Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Rezolutën e vitit 2022, na kërkon që të ndjekim me prioritet gjetjen e rrugëzgjdhjeve për heqjen e kabllave të transmetimit të këtyre subjekteve nga shtyllat elektrike.

Nisur nga sa më sipër, AMA, me shkresë nr 2555 prot., datë 04.07.2022, me lëndë “Kërkesë për takim në nivel teknik” iu është drejtuar autoriteteve të AKEP-it, OSHEE-së dhe RTTL për kryerjen e një takimi të përbashkët me fokus bashkërendimin e punës midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve më të mira teknike për këtë fenomen.

Pas këtij komunikimi, AMA, në mënyrë të përsëritur ka dërguar përsëri kërkesë këtyre organeve për kryerjen e një takimi në nivel teknik me shkresë nr.4484 prot., AMA, datë 15.12.2022.


Pas shkresave të përsëritura nga AMA, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), me shkresë nr. 12445 prot., datë 27.12.2022, protokolluar nga AMA, me shkresë nr.85 prot., datë 09.01.2023, ka shprehur dakordësinë për zhvillimin e një tryeze të përbashkët në nivel drejtues.

Pas marrjes së kësaj shkresë, AMA, ka njoftuar palet e interesuara për një takim në nivel drejtues në ambientet e AMA-s, në muajin mars 2023.

**8) AMA të vijojë të ndjekë çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, duke i vlerësuar me seriozitet, fakti që numri i ankesave pranë Këshillit të Ankesave që nga krijimi i tij në vitin 2016 ka patur një rritje progresive nga viti në vit tregon për rritjen e besimit tek Autoriteti në funksion të interesit publik në transmetimet audiovizive.**

Përputhur me detyrimin e vet ligjor dhe rekomandimin përkatës të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve, bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo aktet nënligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Ankesave ka administruar 310 ankesa, të dërguara respektivisht:



## ANKESAT E PARAQITURA KANË PASUR PËR OBJEKT:



Në 54,5% të rasteve, KA ka konkluduar me “tërheqje vëmendjeje”, 15% e tyre kanë qenë jashtë objektit të punës së KA/AMA-s, ndërkohë që në rastet e tjera (20.5%) vendimmarrja e KA ka shkuar në favor të lirisë së shprehjes.

# \* MASA ADMINISTRATIVE

Në muajin Korrik 2022, AMA dënoi me propozimin e KA-së me gjobë operatorin kombëtar (Top Channel) për shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për përmbajtje antisemitike në Rubrikën “Rrethi Katror”, të emisionit “E Diell”. Komentet e të ftuarit dhe drejtuesit të emisionit nxisnin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminimin racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës në cenim të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive dhe ishin në shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht :



- Neni 4, “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pika 2/d: “moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve” dhe 2/dh: “moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën” ,
- Neni 32, “Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive”, pika 4 “OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi”.
- Neni 33, “Detyrimet e OSHMA-ve”, pika 1/a: “të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive”, pika 1/b: “të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme” dhe pika 1/ç: “të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut”.

Në muajin Dhjetor 2022, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s propozoi gjobë ndaj operatorit kombëtar Top Channel për emisionin “Për’puthen”, pasi ka evidentuar në mënyrë të përsëritur shkelje etike, si: fyerje, stigmatizim, diskriminim, vulgaritet dhe tone të pakontrolluara komunikimi, të cilat kanë përfunduar edhe në dhunë, për të cilat Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA ka reaguar edhe me herët me disa tërheqje vëmendjeje (nr.3607 prot., dt. 11.11.2021, nr.408 prot., dt. 20.01.2022, nr.3755/1 prot., dt. 17.11.2022).



# \* Thirrje/Sensibilizime

·Operatorit “Top Channel” për formatin televiziv “Big Brother Vip” (21 dhe 22 Nëntor 2021), iu sollën në vëmendje detyrimet e OSHMA-ve (ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 33, pika 1/ç) për respektimin e diversitetit dhe promovimin e personave me aftësi të kufizuara.

Operatorit “Top Channel” për emisionin “Shqipëria Live” (14 Shtator 2022) iu sollën në vëmendje kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve (ligji nr.97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b).

·Paralelisht me tërheqjen e vëmendjes ndaj 9 OSHMA-ve për shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për publikimin e të dhënave sensitive që identifikuan të miturën e abuzuar, iu bë thirrje Policisë së Shtetit, për mospublikim të të dhënave rrethimore në njoftimet për shtyp, në emër të interesit më të lartë të fëmijës.

·Operatorit RTSH për emisionin “Qatar 2022” (24 Nëntor 2022) iu bë thirrje për sensibilitet të shtuar ndaj shprehjeve diskriminuese ndaj komunitet rom/egjiptian pavarësisht faktit, se gazetarja kishte reaguar dhe i ftuari kishte kërkuar ndjesë.

·Operatorit “Top Channel”, për emisionin “Më lër të flas” (3 Qershor 2022) iu bë thirrje për shmangien e skenave të papërshtatshme dhe vendosjen shenjave paralajmëruese në oraret që mund të ndiqen nga fëmijët.

·Operatorit “TV Klan” për emisionin “Stop” (24 Nëntor 2022), iu rikujtuan detyrimet përkitazi normave etike dhe deontologjisë së profesionit të gazetarit pavarësisht natyrës investiguese të emisionit dhe kontributit shoqëror në zbardhjen e çështjes përkatëse.

·Operatorit “Euronews”, për emisionin “Goodmorning Albanians” (15 dhjetor 2022) iusoll në vëmendje domosdoshmëria e trajtimit me kujdes dhe përgjegjësi të problematikave sensitive, që lidhin diskutimin për fenë me atë për dhunën, me synim shmangien e keqkuptimeve dhe promovimin qoftë dhe të pandërgjegjshëm të sjelljeve që bien ndesh me ligjin.

# \* SEANCA DËGJIMORE

## (NENI 52, PIKA 6 E LIGJIT 97/2013)

### Me Radiotelevizionin Shqiptar

Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë me pretendimin se në emisionin “Ditë pas dite”, transmetuar në “RTSH1”, në datën 18.09.2022, ora 17:00, ishte transmetuar përmbajtje e papërshtatshme. Ankuesi pretendonte se një përmbajtje e tillë audiovizive ishte “e paarsyeshme për transmetim sidomos për personazhin dhe për ato që ai shfaq në rrjete sociale të cilat bien në kundërshtim me kodin etik dhe moral të shoqërisë”.

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave zhvilloi një bisedë këshilluese me autorët e emisionit “Ditë pas dite”, transmetuar në Radio Televizionin Shqiptar. Këshilli, si strukturë në përbërje të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i kujtoi autorëve parimet dhe detyrimet e OSHMA-ve në përmbushje të misionit mediatik, nisur edhe nga fakti se këto formate televizive iu drejtohen kryesisht të rinjve dhe të rejave dhe se imazhi që iu përcillet atyre rrezikon që të shndërrohet në model sjelljeje edhe për të miturit, marr parasysh faktin se orari i e transmetimit dhe në disa raste përmbajtjet problematike, ku ndjekësit potencialë mund të jenë edhe të miturit.

Në vijim të argumentimit të mësipërm, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, u kërkoi autorëve zbatimin e kërkesave të legjislationit, me fokus kryesor mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe apeloj ata për rishikimin e çdo përmbajtje audiovizive në kuadër të zbatimit të dispozitave të ligjore në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave ka zhvilluar gjithashtu edhe katër vëzhgime, nisur nga sensibiliteti i ngjarjeve/temave të trajtuara nga media, duke konkluduar në tri prej katër syresh me “tërheqje vëmendjeje” për operatorët përkatës dhe dy seanca dëgjimore.

### Me OST dhe News 24

OST nisi një ankesë AMA-s/KA-së për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga operatori audioviziv, në lidhje me një lajm të transmetuar në televizionin “News 24” në edicionet qendrore informative të orës 19:00, në datat 17.08.2022 dhe 18.08.2022, lidhur me një procedurë tenderi të shpallur nga OST, për të cilin ankuesi pretendonte se ishte i pavërtetë, i pasaktë dhe plotësisht disinformues.

Këshilli i Ankesave, bazuar në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 51), rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave” si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, i kërkoi subjektit televiziv privat vendor “News 24” paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën, të cilat u paraqitën në mënyrë zyrtare pranë AMA-s.


Bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe pretendimet e paraqitura nga televizioni “News 24”, Këshilli i Ankesave i dërgoi konstatimin e tij Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), i cili e refuzoi këtë konstatim. Referuar ligjit, u zhvillua një seancë dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe rishqyrtimit të pozicioneve, të paraqitura, Këshilli i Ankesave arriti në përfundimin se, palët nuk ofruan fakte dhe argumente shtesë në raport me qëndrimet e mëhershme dhe për rrjedhojë, i mbetet konstatimit të vet të mëhershëm.


# \* VËZHGIME/SONDAZHE ME VETËINICIIM

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave ka zhvilluar gjithashtu edhe katër vëzhgime, nisur nga sensibiliteti i ngjarjeve/temave të trajtuara nga media, duke konkluduar në tri prej katër syresh me “tërheqje vëmendjeje” për operatorët përkatës.

Në zbatim të ligjit si dhe të detyrave të saj funksionale, AMA, ka kryer inspektime në terren me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve që kanë të bëjnë me cilësinë e ofrimit të sinjalit në të gjithë allotmentet sipas shërbimit që ofrojnë OSHMA-të, qofshin këto TV apo Radio, respektimin e të drejtës së transmetimit, etj. Në periudhën janar - dhjetor 2022, janë kryer 249 inspektime.




Specifikisht 134 inspektime për të drejtat e transmetimit të subjekteve kabllore si dhe 115 verifikime në terren mbi cilësinë e sinjalit në të gjitha allotmentet dhe të shtrirjes territoriale të zonave të subjekteve OSHMA ku ata operojnë.




Sa i përket të drejtës së transmetimit të kontentit audioviziv, janë vendosur 15 sanksione për dënim me gjobë ndaj subjekteve OSHMA ritransmetuese të kontentit, prej të cilave:

- 12 janë vendosur për transmetime audiovizive pa të drejta;
- 2 është vendosur për moslejtim inspektimi;
- 1 është vendosur për dalje jashtë zonës së autorizimit.

Nga sa më sipër, në vijim të ankimeve administrative nga subjektet përkatëse, nga Bordi i AMA-s, 12 vendime për dënim me gjobë janë lënë në fuqi, një (1) vendim është shfuqizuar dhe 2 vendime ende nuk janë marrë në shqyrtim nga Bordi i Autoritetit.



Në këtë periudhë janë vendosur edhe 20 tërheqje vëmendje për transmetime pa të drejta në momentin e inspektimit, ku dokumentacioni përkatës është depozituar përgjatë procedimit administrativ.



Tërheqje Vëmendje

# \* Vëzhgime/sondazhe me vetëiniciim

Autoriteti i Mediave Audiovizive në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me Autoritetin për Komunikimet Elektronike dhe Postare, ka ndërmarrë 9 kontrole të përbashkëta në subjekte të ndryshme për ISP të paautorizuara nga AMA.

Ndërkohë, vlen të theksohet se një fenomen i ri që po haset në këtë periudhë është shtimi i numrit të operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit. Faqe të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s. Për këtë fenomen, AMA, ka adresuar 14 praktika zyrtare AKEP-it, me qëllim marrjen e masave për mbylljen e 86 faqevë online, të cilat shkelnin ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar.



**9) AMA të vijojë të kërkojë marrjen e hapave konkretë e të shpejtë në lidhje me zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave duke theksuar që zgjidhja e kësaj çështje është një detyrim që garanton të drejtën e informimit dhe mjaft e ndjeshme për “Komunitetin me nevoja të veçanta shqisore”.**

Në prill 2022, lidhur me ofrimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive ka pasur një korrespondencë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale (nr.1764/1, datë 27.04.2022), në të cilën, dikasteri përkatës informohet për sa më poshtë:

“Autoriteti i Mediave Audiovizive që prej vitit 2017 është në komunikim të vazhdueshëm jo vetëm shkresor me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, duke i nxitur të përmbushin detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimeve të interpretimit ose “gjuhën e shenjave”, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, rezulton të aplikojë shërbim interpretimi për Personat që nuk Dëgjojnë në “gjuhën e shenjave”. Komunikimi me operatorët e tjerë me licensë kombëtare, ka evidentuar mungesën e interpretëve, që do të ofronin shërbimin e “gjuhës së shenjave”. Operatori audioviziv “Tv Klan” i është drejtuar me një kërkesë (Nëntor 2020) bashkëpunimi Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Personave që nuk Dëgjojnë, por vetë Shoqata, në përgjigje të kërkesës, ka vënë në dijeni operatorin audioviziv se “nuk disponon specialistë që mund të vihen në dispozicion për këtë shërbim të përditshëm”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, sipas të cilit “Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë” (pika 15, kreu II); dhe “Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimin të gjuhës së shenjave shqipe” (pika 16, kreu II), Autoriteti i Mediave Audiovizive, me anën e shkresës nr. 1232 Prot., datë 11.03.2021 u sugjeroi ministrive përkatëse (Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) nxitjen dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive, nëpërmjet përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave.

Në prill 2022, lidhur me ofrimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive ka pasur një korrespondencë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale (nr.1764/1, datë 27.04.2022), në të cilën, dikasteri përkatës informohet për sa më poshtë:

“Autoriteti i Mediave Audiovizive që prej vitit 2017 është në komunikim të vazhdueshëm jo vetëm shkresor me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, duke i nxitur të përmbushin detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimeve të interpretimit ose “gjuhën e shenjave”, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, rezulton të aplikojë shërbim interpretimi për Personat që nuk Dëgjojnë në “gjuhën e shenjave”. Komunikimi me operatorët e tjerë me licensë kombëtare, ka evidentuar mungesën e interpretëve, që do të ofronin shërbimin e “gjuhës së shenjave”. Operatori audioviziv “Tv Klan” i është drejtuar me një kërkesë (Nëntor 2020) bashkëpunimi Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Personave që nuk Dëgjojnë, por vetë Shoqata, në përgjigje të kërkesës, ka vënë në dijeni operatorin audioviziv se “nuk disponon specialistë që mund të vihen në dispozicion për këtë shërbim të përditshëm”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, sipas të cilit “Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë” (pika 15, kreu II); dhe “Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimin të gjuhës së shenjave shqipe” (pika 16, kreu II), Autoriteti i Mediave Audiovizive, me anën e shkresës nr. 1232 Prot., datë 11.03.2021 u sugjeroi ministrive përkatëse (Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) nxitjen dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive, nëpërmjet përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave.

Ndërkohë që procesi vazhdon dhe mendohet se do zgjasë, nga diskutimet e zhvilluara me grupet e interesit në kuadrin e tryezave konsultative në Tiranë dhe në rrethe, ka rezultuar, se një zgjidhje alternative të pranueshme dhe më pak të kushtueshme për periudhën kalimtare deri në sigurimin e interpretëve të certifikuar, paraqet edhe titrimi. Qasja është ndarë edhe me OSHMA-të, të cilat, të paktën në tryeza, janë treguar të gatshme ta fusin praktikën në përdorim.

**10) AMA të punojë për rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit si rregullator, nëpërmjet zbatimit të proceseve dhe procedurave, që janë të hapura e të kontrollueshme si dhe duke lehtësuar barrën burokratike, për subjektet që Autoriteti licencën/autorizon.**

AMA, si rregullator i tregut mediatic është duke punuar për hartimin apo ndryshimin e kuadrit nënligjor, duke synuar mbështetjen dhe lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve në fushën audio/audiovizive. Gjatë këtyre proceseve, janë mbajtur në konsideratë problematikat e ndeshura gjatë implementimit të kuadrit rregullator në fuqi. Konkretisht gjatë rishikimit të rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës dhe/ose autorizimeve apo akteve të tjera në çdo rast konsiderohen komentet dhe propozimet e grupeve të interesit.

Miratimi dhe rishikimi i legjislacionit sekondar është pasuar me lehtësimin dhe eliminimin e barrierave administrative sidomos në proceset e licencimit dhe autorizimit, aplikimeve për rinovimet e licencave/autorizimeve, duke reduktuar në maksimum afatet e procedimeve administrative në respekt të ligjit organik dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion i pavarur publik, krahas veprimtarisë së tij, të përcaktuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, sigurohet që të jetë transparent ndaj publikut, duke zbatuar dispozitat që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive, publikon “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, i cili pasqyron të gjitha kërkesat për informacion, që kanë mbërritur në institucion dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Autoritetit. Gjatë vitit 2022, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, kanë mbërritur rreth 54 kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afatit të parashikuar në ligj (10 ditë pune), duke shënuar kështu një rekord pozitiv për Autoritetin.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjital për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, ndikon në fuqizimin e besueshmërisë së qytetarëve.

Lehtësimit i barrës burokratike, nëpërmjet komunikimit me publikun apo dhe me subjektet që autoriteti licencen/autorizon, është një nga synimet kryesore të Autoritetit, kjo dhe falë postës elektronike të AMA-s, info@ama.gov.al, përgjigjet e të cilëve dërgohen sipas afateve të përcaktuara nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke qënë se rrjetet sociale facebook dhe instagram janë të aksesueshëm nga shumë qytetar, AMA ka adresat e saj zyrtare, gjë e cila ka rritur interaktivitetin me qytetarët dhe është parë si mënyrë efektive për të arritur qëllimet në rrugë më të shpejtë dhe më pak burokratike.

Ambientet e Autoritetit të Mediave Audiovizive janë të hapura për takimet me qytetarët që kanë ankesa/pyetje apo për subjektet që kanë paqartësi në procesin e plotësimit të dokumenteve, vështirësi në fazat e aplikimit apo pyetje rreth procesit të marrjes/rinovimit të licencës. Drejtoritë e Autoritetit, të udhëhequra kryesisht nga drejtori, zhvillojnë takime ballë përballë në sallën e pritjes duke vendosur në shërbim të subjekteve apo qytetarëve informacionin e nevojshëm, duke shmangur procesin burokratik që mund të krijohet nëpërmjet komunikimit shkresor. Po ashtu, në vijim të komunikimit dhe transparencës mes subjekteve/ qytetarëve dhe autoritetit në faqen zyrtare të AMA-s krahas e-mailit zyrtar janë të publikuara dhe e-mailet e secilës drejtori dhe numrat e telefonit për të lehtësuar dhe adresuar problematikat në departamentin përkatës.

Nisur nga funksionet institucionale dhe objektivat e planit strategjik të veprimit 2021-2023 të AMA-s, duke konstatuar pamjaftueshmëri në mbulimin e të gjitha funksioneve e proceseve të kërkuara për realizimin e këtyre objektivave strategjike, përfshirë dhe përballimin e sfidave të hasura nga detyrimet e akteve ndërkombëtare dhe zhvillimet teknologjike në fushën e medias, mbështetur në ligjin organik të AMA-s neni 19 pika 17, Autoriteti i propozoi Kuvendit ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Ndryshimet strukturore të propozuara u hartuan në vlerësim të plotë të ligjshmërisë, konkretisht ligjit të AMA-s, atij të pagave e shpërblimeve të strukturave të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe u miratuan në unanimitet me vendimin nr. 64, datë 07.07.2022 nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Pas miratimit të strukturës dhe organikës së re të AMA-s, me vendimin nr. 86/2022 të Kuvendit të Shqipërisë dhe në përmbushje të afateve ligjore, është duke u kryer procesi i ristrukturimit në mbështetje të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013” Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil.



**11) Të vijojë të luajë një rol proaktiv, në bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët përkatës, për të bërë të mundur forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës dhe sociale të gazetarëve si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias dhe kërkesë përsëritur në Raportet e Progresit të KE-së .**

Gjatë vitit 2022 u zbatua projekti “Marrëdhëniet e punës së gazetarëve audiovizivë dhe prezantim i modeleve bashkëkohore”, projekt i mbështetur financiarisht dhe nga AMA.

Problematikat e nxjerra nga monitorimi dhe kontaktet me grupet e interesit në disa qytete të vendit si, Korçë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Tiranë, ishin pjesë e diskutimeve që janë realizuar me komunitetin e gazetarëve që punojnë për mediat lokale dhe ato kombëtare. Në takime janë përmendur rastet e angazhimit në redaksi pa kontrata, ose në rastet kur nga punëdhënësi nuk janë shlyer rregullisht dhe në mënyrë të plotë kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe sociale, si dhe janë marrë për referencë aplikimi konkret i modeleve të kontratave të punës nga një vend anëtar i BE-së, Italia, si dhe modeli i një vendi nga rajoni ynë, nga Kosova.

Pjesë e projektit ishte dhe publikimi “Një draft i kontratës kolektive dhe dy modele për gazetarët, stafin teknik dhe atë mbështetës të mediave audiovizive” (botim me ISBN) që përfshin aspekte të situatës të marrëdhënieve të punës në vendin tonë, si dhe ka prezantuar dhe modelet e kontratave kolektive në Itali dhe Kosovë.

**12) Të analizojë me përgjegjësi raportet ndërkombëtare të cilët lidhen me lirinë emediave në Shqipëri dhe të trajtojë me seriozitet problematikat të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).**

AMA mbetet e angazhuar për të njohur dhe vlerësuar në mënyrë kritike çdo raport apo studim analitik të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare që kanë në fokus lirinë e medias dhe funksionalitetin e sistemit mediatik shqiptar, në mënyrë të veçantë ato aspekte që lidhen direkt ose indirekt me objektivat dhe detyrat e Autoritetit, në përmirësimin e performancës dhe vendimarrjen për tregun audio/audioviziv në vendin tonë.

**13) AMA të jetë më proaktive në rastet e dhunimit verbal apo fizik në krye të detyrës, të gazetarëve si dhe në çdo rast që çënohet integriteti moral apo fizik i gazetarëve.**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në muajin mars 2022, përcolli me shumë shqetësim rastin e keqtrajtimit me kanosje të një gazetarje dhe kameramanit që e shoqëronte, nga redaksia e emisionit “Fiks Fare”, nga dy punonjës të një stabilimenti shpendësh në Durrës. Ekipi i medias ishte duke bërë detyrën në terren për hetimin e problematikave dhe ndjeshmërive të opinionit publik.

AMA shpërndau një njoftim për median me titull “Kanosja e gazetarëve në detyrë, akt i rrezikshëm për lirinë e fjalës dhe demokracinë”, ku mes të tjerave e përshkruante ushtrimin e dhunës fizike e psikologjike, si dhe sekuestrimin e dëmtimin mjeteve të punës të kameramanit, si “një rast flagrant kundër lirisë së fjalës, që çënon veprimtarinë e medias për transparencë. AMA dënon akte të tilla nga kushdo dhe kërkon respektimin e të drejtave të gazetarëve për informim në shërbim të mirës publike”.

#### **14) AMA të monitorojë intensivisht dhe në vijimësi veprimtarinë e RTSH në lidhje me përmbajtjen e detyrimeve të tij si televizioni publik kombëtar dhe si një institucion që financohet me taksat e publikut shqiptar.**

Në mënyrë periodike, në muajin qershor dhe dhjetor, AMA monitoron dhe shqyrton përmbajtjen e buketës programore të kanaleve të vetë Transmetuesit Publik, por dhe nivelin e mbulimit me sinjal të transmetimeve të RTSH-së në të gjithë territorin e vendit.

Në këtë kuadër Autoriteti aktualisht po realizon një monitorim dhe shqyrtim, gjetjet e të cilit do i prezantohen brenda gjysmës së parë të muajit janar 2023 Këshillit Drejtues të RTSH-së si dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë.

Ndërkohë, gjetjet e këtyre monitorimeve do trajtohen në mënyrë të detajuar në vijim të raportit vjetor.

Monitorimi dhe shqyrtimi bazohen në kërkesat e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht, nenet 18 dhe 19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e AMA-s; nenin 33, mbi detyrimet e OSHMA-ve; kreun 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH-së, ku përfshihen nenet 90 – 126 etj; si dhe i referohet përmbajtjes së Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, me vendim nr. 18, datë 02.03.2017.

AMA ka marrë zyrtarisht nga RTSH draft kontratën e shërbimit (protokolluar në institucion me nr. 3467/2, datë 12.12.2022), e cila ka kaluar në një fazë të detajuar shqyrtimi gjatë muajit dhjetor 2022 dhe në janar 2023 është dërguar me komentet e institucionit për diskutim pranë RTSH-së.



### 3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES- RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT

Disa nga rekomandimet e progres raportit të BE – së për Shqipërinë, për vitin 2021:

**-Shqipërisë i bëhet thirrje të ndërmarrë hapa për të bërë plotësisht funksional autoritetin rregullator audiovizual, në mënyrë që të garantojë pavarësi dhe legjitimitet**

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv dhe shërbimet e tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji përcakton statusin, kompetencat, organizimin dhe funksionet e AMA-s, si një organ i pavarur që vepron si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Po ashtu, në ligj garantohet pavarësia e AMA-s, duke filluar me përcaktimin e statusit të AMA-s, mënyrën e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve dhe Kryetarit të AMA-s. Rastet e papajtueshmërisë dhe konfliktet e interesit të anëtarëve dhe kryesisë së AMA-s, për të vazhduar me mënyrën e pavarur të financimit, mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së AMA-s.

Bazuar ne nenin 8 të ligjit, AMA, përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi: Kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë: nga ku tre anëtarë të mbështetur nga shumica parlamentare, tre anëtarë të mbështetur nga opozita parlamentare dhe anëtari i shtatë, i cili është edhe kryetar i AMA-s, zgjidhet nga Kuvendi.

Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

---

Sa i përket pavarësisë financiare (burimet e financimit të AMA-s), ato përcaktohen në nenin 24 të ligjit organik, konkretisht:

- a) të ardhurat nga pagesat për dhënien dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikim;
- d) të ardhurat nga tarifatat për shërbimet e transmetimit të përcaktuara në ligjet tatimore, roli e agjentit tatimor;
- e) financimi nga Buxheti i Shtetit;
- f) burime të tjera të ligjshme.

Gjithashtu, në ligj parashikohet se “... Për të përballuar shpenzimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të veta, AMA përcakton, me vendim të veçantë, të gjitha tarifatat për licencat dhe/ose autorizimet e subjekteve audio dhe ofruesit e shërbimeve të transmetimit audio-vizual, shërbimet e tjera, si dhe pagesat për përpunim administrativ”.

AMA është një institucion i vetëfinancuar dhe në bazë të nenit 25 pika 5 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar “... Çdo tepricë nga të ardhurat e tarifave/pagesave, që mbetet nga shpenzimet funksionale të AMA-s përkatëse, në fund të vitit financiar, është mbahet në llogaritë e AMA-s dhe përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit të ardhshëm...”.

Po ashtu, bazuar në nenin 15 të ligjit, struktura dhe organika e AMA-s, propozohen nga vetë institucioni dhe miratohen nga Kuvendi i RSH.

- Shqipëria ftohet të marrë masa për të mbështetur vetërregullimin mediatik. Shqipërisë i bëhet thirrje të sigurojë një politikë me zero tolerancë për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve

Mjedisi i përgjithshëm legjislativ është i favorshëm për ushtrimin e lirisë së shprehjes. Lidhur me angazhimin e AMA-s, sa i përket rasteve të dhunës së ushtruar ndaj gazetarëve, informojmë se AMA reagon publikisht duke dënuar ashpër ushtrimin e dhunës verbale dhe fizike me qëllim frikësimin dhe intimidimin e gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës. Përmes këtij njoftimi, AMA nxit autoritetet ligjzbatuese në zbardhjen e plotë të ngjarjeve të ndodhura, duke qëndruar në krahë të kolegëve gazetarë që punojnë me angazhim dhe përgjegjësi profesionale për informimin e publikut.


Po ashtu, në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të punës të gazetarëve në fushën e mediave audiovizive, së fundmi, AMA, në përmbushje dhe të objektivave, funksioneve dhe kompetencave që ligji i njeh, ka mbështetur financiarisht projektin me titull “Tregu i punës dhe kontrata kolektive në mediat audiovizuale”. Me këtë projekt, Autoriteti ka hedhur hapin e parë për zbatimin e Rekomandimit të Komisionit Evropian të datës 16.9.2021 “Për garantimin e mbrojtjes, sigurisë dhe fuqizimit të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias në Bashkimin Evropian.

Pika 19 e këtij Rekomandimi trajton rolin e rëndësishëm e gazetarëve gjatë tubimeve politike, protestave dhe demonstratave. Ai i referohet sigurisë së gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias, të cilët janë në gjendje të operojnë të sigurt dhe pa kufizime gjatë ngjarjeve të tilla.

Autoriteti është i përditësuar dhe në fazë njohjeje të thelluar ndaj të gjitha rekomandimeve të Komisionit Evropian për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve – një çështje kjo që po diskutohet gjerësisht nga autoritetet rregullatore të shteteve anëtare të BE-së. Njohja e këtyre akteve ligjore do të shoqërohet edhe me kryerje të trajnimeve të stafit, pas hyrjes në fuqi të këtyre akteve, si dhe ndjekjes së praktikave më të mira në zbatim.

---

Gjithashtu, Autoriteti promovon fuqishëm punën me shoqatat e gazetarëve ose grupet e tjera në planifikimin e angazhimeve që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e gazetarëve. Një e dhënë interesante që AMA nënvizon sa i takon fuqizimit të gazetareve apo profesionisteve femra në media, është raporti gjinor i monitoruar nga AMA. Bazuar në informacionet nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 në vend, 42% e profesionistëve të medias janë femra, si gazetare, reportere dhe 58% janë meshkuj.





**MM**

#### **4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT**


Një ndër detyrat funksionale të AMA-s është verifikimi i respektimit të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi. AMA, gjithashtu, ka kompetencë të vendosë sanksione sipas nenit 133, “Gjobat” për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sanksionet gjobë mund të vendosen nga inspektorët ose nga vetë AMA me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.

Gjatë vitit 2022, nga AMA janë vendosur 15 sanksionë me gjobë, të gjitha të ndërmarra nga Drejtoria e Mbikëqyrjes.



Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2019 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore në terren. Gjatë vitit 2020 dhe 2021, numri i inspektimeve ka qenë në rënie, kjo shkaktuar dhe nga pandemia e COVID-19 si dhe nga kërkesat në rënie të subjekteve për ndërhyrje nga ana jonë. Ndërsa, në vitin 2022 numri i inspektimeve për subjektet OSHMA është dyfishuar në krahasim me vitin paraardhës.






2022

Sa i përket ankesave nga subjektet mbajtës të së drejtës së transmetimit, ato lidhen kryesisht me mosrespektimin e kësaj të drejte nga operatorët kabllor/IPTV dhe OTT të autorizuar nga AMA. Gjithashtu, ankesa nga këto operatorë ka pasur dhe në lidhje me subjektet ISP të pa autorizuar nga AMA për shkeljen e të drejtës së transmetimit.

Të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore,IPTV, OTT dhe ISP të ndryshme, AMA, i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese për periudhën 2019-2022:





Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2022, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 249 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve. Nga këto 134 janë inspektime të OSHMA-ve dhe 177 janë monitorime në terren.


Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

Ø 15 (pesëmbëdhjetë) vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar, prej të cilave:

-15 (pesëmbëdhjetë) sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve (kabllorë, iptv, ott), prej të cilave 12 (dymbëdhjetë) gjopa janë lënë në fuqi nga Bordi i AMA-s (tre nga gjobat kanë ulje të masës), 2 (dy) janë marrë akoma në shqyrtim nga Bordi i AMA-s dhe 1 (një) gjobë është shfuqizuar me vendim të Bordit të AMA-s;

-Për 20 raste të tjera është vendosur tërheqja e vëmendjes ndaj subjekteve OSHMA.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:




2022

Gjithashtu, vlen për tu përmendur një fenomen i ri në transmetimet audiovizive që po kryhet nëpërmjet internetit. Kjo është një formë e sofistikuar piraterie, e cila po përhapet gjithmonë e më shumë në vitet e fundit.

Përsa i përket këtij fenomeni, AMA në dhjetor të vitit 2021 ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me institucionin e AKEP - it. Ndër të tjera, ky Memorandum parashikon dhe ngritjen e përbashkët të grupeve të inspektimit. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022 janë kryer 9 inspektime të përbashkëta pranë subjekteve që disponojnë ISP (internet service provider) në gjithë territorin e vendit dhe që kryenin transmetime televizive nëpërmjet internetit.

Vlen për tu theksuar se fenomeni i piraterisë televizive që kryhet nëpërmjet internetit, është një fenomen sa shqetësues aq dhe i komplikuar për tu identifikuar, për shkak se në shumicën e rasteve produkti audioviziv që transmetohet në formë abuzive, vjen nga servera të vëndëve të ndryshme të botës dhe nuk janë të instaluar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye, identifikimi i tyre bëhet shumë i vështirë.





Megjithatë, AMA, për vitin 2023 ka programuar kryerjen e disa trajnimeve të stafit, në mënyrë që të përditësohen sa më shumë më teknologjitë dhe risitë që ofrohen së fundmi në këtë drejtim. Vlerësojmë që këto trajnime do ti vijnë në ndihmë institucionit jo vetëm për rritjen e performancës së punonjësve në këtë drejtim, por me perspektivën që në vitet në vijim të kryhen edhe investimet e nevojshme në teknologji, në mënyrë që të bëhen ndërhyrjet e duhura për reduktimin e këtij fenomeni.

Ndërkohë, fenomen tjetër që po haset në këtë periudhë është shtimi i numrit të operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s. Për këtë problematikë, AMA, ka përcjellë zyrtarisht pranë AKEP – it (Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare) 14 (katërmëdhjetë) praktika, me qëllim marrjen e masave për mbylljen e 86 (tetëdhjetë e gjashtë) faqeve online, të cilat kryenin shkelje të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2022, është fokusuar në monitorimin e programeve mbi tematikën e tyre, respektimin e parashikimeve ligjore për transmetimin e reklamave dhe për evidentimin e volumit të reklamave në televizionet kombëtare, sikurse edhe në monitorimin e programeve të lira në platformat numerike tokësore. Gjithashtu, një fokus të veçantë ka pasur dhe monitorimi për respektimin e të drejtës së transmetimit për filmat artistikë dhe eventet sportive, në platforma/programe të ndryshme me pagesë. Për vitin 2022 janë kryer 1,132 orë monitorime për të drejtat e transmetimit për filmat artistikë.

2022



<b>Çelja në fillim të vitit 2022</b>	<b>519,250,097</b>	<b>Lekë</b>
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2022	21,440,000	Lekë
+ Kamatëvonesa të lindura në vitin 2022	0	Lekë
- Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë dhe kamatëvonesat e lindura	5,950,666	Lekë
- Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	2,000,000	Lekë
<b>Detyrimi në fund të vitit 2022</b>	<b>332,719,431</b>	<b>Lekë</b>

2022

Masa e detyrimeve të lindura prej 16 sanksioneve me gjobë në vitin 2022 është 21,440,000 lekë.

Masa e uljes në vlerën 2,000,000 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendimin e AMA-s nr. 4, date 07.01.2022, është ulur masat e dënimit me gjobë nr. 14, datë 10.11.2021, me 1,000,000 lekë;
- Me vendim të AMA-s nr. 114, datë 12.10.2022 është shfuqizuar sanksioni me gjobë nr. 8, datë 29.08.2022, në masën 1,000,000 lekë.



# 5. | QEVERISJA E AUTORITETIT

## 5.1 VENDIMARRJA MBI LICENCAT/AUTORIZIMET

Prej muajit shkurt 2022, AMA e ka ushtruar aktivitetin e tij administrativ me trupë të plotë kolegjinale të përbërë prej 7 anëtarësh, duke bërë të mundur miratimin e të gjithë vendimmarrjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, si dhe shumicë të thjeshtë.

Përveç kryerjes së funksioneve në cilësinë e organit kolegjal, gjatë periudhës raportuese, vend të rëndësishëm kanë edhe aspekte të tjera të veprimtarisë administrative të AMA-s, si përfaqësimi i institucionit në proceset gjyqësore ku AMA është palë, kryerja e kontrolleve dhe inspektimeve të ndryshme ndaj subjekteve, që ushtrojnë veprimtari audiovizive, bashkëpunimi dhe këshillimi me organe të tjera shtetërore.

Në zbatim të nenit 60 të ligjit organik, AMA, me nismën e tij, ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur disa gara për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë të transmetimit.

---

Konkretisht, në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 82, datë 15.07.2022 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”, AMA shpalli garën e kandidaturave për:

1. Lëshimin e 1 (një) licence rajonale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier (allotmentet Tiranë, Elbasan dhe Fier);
2. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv tematik informativ në Qarqet Tiranë dhe Durrës (allotmenti Tiranë).

Në vijim të njoftimit “Për çeljen e garës për lëshimin e 2 (dy) licencave të shërbimit të programit audioviziv”, të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetat “Panorama” (datat 29-31 gusht 2022); “Tema” (30, 31 gusht dhe 01 shtator 2022) dhe “Dita” (datat 29-31 gusht 2022) me shpërndarje kombëtare, depozituan aplikim:

1. Shoqëria “Inter Active Media” sh.p.k., për marrje licence rajonale shërbimi programi audioviziv të përgjithshëm, në allotmentet Tiranë, Elbasan dhe Fier. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të aplikimit AMA me vendimin nr. 125, datë 30.11.2022, ka vendosur dhënien e licencës, shoqërisë “Inter Active Media” sh.p.k., me NIPT: M0230308M dhe administrator: Panajot Braja, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “IN TV”, në allotmentet Tiranë, Elbasan dhe Fier, për një periudhë prej 8 (tetë) vjetësh.
2. Shoqëria “City News Albania HD”, për marrje licence lokale shërbimi programi audioviziv tematik informativ në Allotmentin Tiranë “City News Albania HD”. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të aplikimit, AMA me vendimin nr. 124, datë 30.11.2022, ka vendosur dhënien e licencës, shoqërisë “City News Albania” sh.p.k., me NIPT: M22113005L dhe administrator: Etleva Skonja, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv tematik informativ “City News Albania HD”, në allotmentin Tiranë (Qarqet Tiranë-Durrës), për një periudhë prej 8 (tetë) vjetësh.



- 
- Bëjmë me dije se gjatë vitit 2020, AMA, në zbatim të nenit 59 të ligjit të posaçëm dhe vendimit nr. 141, datë 10.12.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge private”, ka çelur garën për dhënien e 1 licence private të transmetimit audio analoge në (qarkun Gjirokastër).

Në vijim të njoftimit të AMA-s, shoqëria “Radio Channel 7” sh.p.k., depozitoi aplikimin me nr. 489 prot., datë 25.01.2021, për marrje licence transmetimi audio analoge lokale, i cili nuk u shqyrtua nga AMA, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor. Me plotësimin e trupës kolegjiale në vitin 2022, AMA me vendim nr. 68, datë 07.07.2022, vendosi rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Channel 7” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio analoge “Radio Channel 7”, në Qarkun Gjirokastër.

- Në vijim të garës së çelur nga AMA, me vendimin nr. 9, datë 02.02.2021, për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv, tematik informativ në allotmentin Tiranë (Qarqet Tiranë dhe Durrës), depozitoi aplikim shoqëria “Evro Media” sh.p.k., aplikim i cili nuk u shqyrtua nga AMA, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor. Me plotësimin e trupës kolegjiale në vitin 2022, AMA me vendimin nr. 97, datë 07.07.2022, vendosi rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës, shoqërisë “Evro Media” sh.p.k., për shërbimin e programit audioviziv tematik informativ, në allotmentin Tiranë.

Po kështu, AMA në vijim të kërkesës të palës së interesuar, nëpërmjet vendimit nr. 123, datë 30.11.2022, çeli garën për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv në qarkun Lezhë. Për këtë garë, ka depozituar aplikim shoqëria “Star News RTV” sh.p.k. aplikim i cili është aktualisht në proces shqyrtimi.

- Sa i përket aplikimeve për marrje autorizimi, aplikime të cilat shqyrtohen mbi bazë kërkesë, për vitin 2022 rezulton se kanë shfaqur interes 17 subjekte nga të cilët, 1 subjekt është pajisur me autorizim për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, 2 subjekte janë pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit mbështetur në rrjet kabllor, 1 subjekt është pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit sipas kërkesës së përdoruesit, 1 subjekt është pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit në IPTV dhe 1 subjekt është pajisur me 12 autorizime për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në rrjet IP (OTT). Po gjatë këtij viti, 4 subjekte ekzistues të autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, kanë kërkuar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.

## 5.1 NDRYSHIMET NË PRONËSI

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, subjektet e licencuara/autorizuara kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtit subjekt tregtar.

Një ndër kushtet e licencës/autorizimit të subjekteve OSHMA është detyrimi për të njoftuar AMA-n për ndryshime në të dhënat e licencës dhe autorizimit. Bazuar në nenin 133, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, mosnjoftimi i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e subjektit të licencuar/autorizuar përbën kundërvajtje administrative që ndëshkohet me gjobë nga 120,000 lekë deri në 2,000,000 lekë. Ky detyrim ligjor ka si qëllim vënien në dijeni dhe njohjen e autoritetit rregullator me çdo ndryshim të të dhënave që i licencuari/autorizuari ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës/autorizimit, të tilla si: ndryshime në pronësi, një nga më të rëndësishmit, emrin e subjektit, ndryshime në strukturën programore, etj.


Nga ana tjetër, AMA, kryesisht, në mënyrë periodike, verifikon në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), statusin, objektin e veprimtarisë si dhe të dhëna të tjera për subjektet e licencuar/autorizuar nga autoriteti. Në vijim të verifikimeve të kryera, AMA ka iniciuar, rast pas rasti, procedimet administrative ndaj OSHMA-ve duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim.

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 9 subjekte, nga të cilat 3 ndryshime janë miratuar nga AMA ndërsa 6 ndryshime janë në proces.


Ndërkohë, 9 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, të cilat janë miratuar nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2022, për aplikimet për licencë/autorizim, AMA ka vendosur:

- Dhënie e licencës së transmetimit audiovizive numerik për 2 subjekte;
- Mosdhënie e licencave për 2 subjekte, 1 radio dhe 1 televizion;



-Dhënien e autorizimit për 17 subjekte nga të cilët 1 subjekt për përsëritjen e shërbimit të programit kabllor, për 2 subjekte ofrimin e shërbimit të programit audioviziv me karakter të përgjithshëm mbështetur në rrjet kabllor, për 14 subjekte ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet IP (OTT/IPTV), 1 subjekt (VOD) dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 4 subjekte OSHMA;



-Rinovimin e autorizimit për 26 subjekte (përsëritës/ ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT);

-Rinovimin e licencës për 11 subjekte audio;

-Heqjen e licencës për transmetime televizive për 3 subjekte dhe 1 radio për subjekte, mosdhënien e licencës për 1 subjekt (TV) dhe (RADIO) 2 subjekte, mosrinovimin e licencës/autorizimit për 3 subjekte dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit për 10 subjekte;

-Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e ndodhura në kërkesën për marrje licence/autorizimi për 12 subjekte duke përfshirë në këtë numër edhe kalimin e të drejtave të autorizimit (5 subjekte) dhe kalimi i të drejtave të licencës 5 subjekte.

## 5.2 ECURIA E PROCESIVE GJYQËSORE

E drejta për të investuar pushtetin gjyqësor, lidhur me vendimmarrjet administrative të autoritetit, nga palët e prekura nga këto akte administrative, është një instrument i së drejtës, që e ka bërë AMA-n palë në procese të ndryshme gjyqësore.

Kryesisht, aktet administrative, ligjshmëria dhe themeltësia e të cilave është objekt shqyrtimi gjyqësor, lidhen me dënimet administrative ndaj subjekteve audio dhe/ose audiovizive, vendimet për heqjen/pavlefshmërinë e licencës etj.

AMA, si person juridik publik, në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e OSHMA-ve, ka investuar organet gjyqësore duke kërkuar prej subjekteve audio/audiovizive debitorë të shlyejnë detyrimet financiare ndaj AMA-s ose Buxhetit të Shtetit. Po ashtu, AMA i është drejtuar gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.


AMA, gjatë vitit 2022, është përfshirë në 26 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilat:

a) 5 procese gjyqësore në cilësinë e palës paditëse:

- Fituar (3);
- Humbur (0);
- Kthim aktesh (1);
- Në proces (1);

b) 21 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur:

- Fituar (4);
- Humbur (4);
- Në proces (12);
- Pushuar gjykimi (1).



Përveç proceseve gjyqësore në gjykim në shkallë të parë, AMA ka vijuar me ndjekjen e proceseve gjyqësore, të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, çështje këto të mbartura nga vitet paraardhëse.

Si në vitet e kaluara edhe gjatë periudhës raportuese, ekzekutimi i vendimeve të AMA-s të shndërruara në tituj ekzekutivë, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbarimor. Për vitin 2022, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 3 titujve ekzekutivë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

Gjatë vitit 2022, 8 subjekte debitorë kanë shlyer detyrimet kundrejt AMA-s, nga të cilët:

- 2 prej tyre, detyrime financiare ndaj Autoritetit;
- 6 prej tyre, detyrime për sanksione me gjobë.

Po kështu, AMA ka nënshkruar me 2 subjekte OSHMA, marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimeve për 4 sanksione me gjobë.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tri shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur.

---

# 6

## AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM





## 6.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

Gjatë vitit 2022, AMA vijoi me shqyrtimet tematike për përmbajtjet e transmetuara, ku në mënyrë periodike u fokusua në këto aspekte kryesore:

- a.shkeljet etike në përgjithësi;
- b.mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme;
- c.reklammat dhe komunikimet tregtare, rastet kur janë të fshehura, kur përfshihen në edicionet e lajmeve, mbi medikamentet dhe shërbimin shëndetësor etj.;
- d.respektimi i standardit të shkruar dhe të folur të shqipes;
- e.mbi buketën programore të RTSH-së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit.

Gjatë vitit raportues janë realizuar 96 shqyrtime përmbajtjesh, ku në 38 raste AMA ka dërguar tërheqje vëmendjeje për OSHMA-të që nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Të dhënat vjetore janë përmbledhur në tabelën vijuese:



## Tërheqjet e vëmendjes për OSHMA-të gjatë vitit 2022

Nr	Kategoria e shkeljes	OSHMA	Emisioni
1	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e pikave 1.1 dhe 1.12, seksioni 1 i Kodit të Transmetimit)	RTSH 1	Zëri i Popullit
2	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e pikave 1.1, 1.3 dhe 1.12, seksioni 1 i Kodit të Transmetimit)	TCH	Për'puthen
3	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	TCH	Në edicionet kryesore të lajmeve
4	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/2 dhe neni 35/1 të ligjit nr. 97/2013)	KLAN	Love story 2
5	Përmbajtje me qëndrime joobjektive dhe joasnjëanëse. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/1.ç dhe nenit 33/1a,b të ligjit nr. 97/2013)	EuroNews Albania	Now
6	Përmbajtje me qëndrime joobjektive dhe joasnjëanëse. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/1.ç dhe nenit 33/1a,b të ligjit nr. 97/2013)	MCN	Të paeksponuarit
7	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 33 të ligjit 97/2013 dhe pika 1.3 e Kodit të Transmetimit)	RTV Ora	Why not
8	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013 dhe pika 3.1 e Kodit të Transmetimit)	Report TV	Pa gjurmë
9	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013 dhe pikat 1.3 dhe 1.6 në Kodin e Transmetimit)	ABC News	Style Star
10	Reklamë e fshehtë. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	TCH	Ftesë në 5
11	Reklamë e fshehtë. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	Klan	Rudina

12	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	Ora News	Vila 24
13	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	TCH	Pushime on Top
14	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	ABC NEWS	Në edicionet e lajmeve kryesore
15	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	Syri TV	Në edicionet kryesore të lajmeve
16	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/2 dhe neni 35/1 të ligjit nr. 97/2013)	News 24	Me zemer te hapur
17	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	TCH	Për' puthen
18	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	TCH	Kepi i tundimeve
19	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	RTSH	Si ne familje
20	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. Mosrespektim i nenit 4 (pikat/b,ç), neni 33, (pikat ç,d); por dhe të Kodit të Transmetimit, seksioni 1 (pikat 1,3,5,12) dhe seksionit 5 (pikat 5.31, 5.34)	TCH	Ftesë në 5
21	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme. Mosrespektimi i nenit 33, por dhe Kodit të Transmetimit pika 1.3 dhe 1.6.	TV ORA	D-Night
22	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	TV ORA	Why Not
23	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	NEWS 24	Në edicionet kryesore të lajmeve
24	Transmetim reklame politike (Nuk u respektua kërkesa e nenit 41 të ligjit nr. 97/2013)	SYRI TV	Në bllokun e reklamave
25	Transmetim reklame politike (Nuk u respektua kërkesa e nenit 41 të ligjit nr. 97/2013)	FAX NEWS	Në bllokun e reklamave

26	Reklamë e parregullt për barnat (Nuk është respektuar neni 19, pika 10 e rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”.	TCH	Top Arena
27	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 97/2013)	RTSH 1	Si në familje


Nisur nga dukuri të identifikuara në procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, AMA, në mënyrë periodike, ka apeluar përmes njoftimeve të shpërndara në faqen zyrtare apo duke iu adresuar drejtpërdrejt subjekteve, për respektimin e kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi. Në tabelën e mëposhtme jepen adresimet për vitin 2022.

#### Adresime kujtesë për OSHMA-të gjatë vitit 2022

	Tematika	Link-u	Data
1	Respektimi i kërkesave ligjore për mbulimin e fushatës zgjedhore nga OSHMA-të	<a href="http://ama.gov.al/respektimi-i-kerkesave-ligjore-per-mbulimin-e-fushates-zgjedhore-nga-oshma-te/">http://ama.gov.al/respektimi-i-kerkesave-ligjore-per-mbulimin-e-fushates-zgjedhore-nga-oshma-te/</a>	10.02.2022
2	Apel për OSHMA-të: Kujdes Dezinformimin!	<a href="http://ama.gov.al/apel-per-oshma-te-kujdes-dezinformimin/">http://ama.gov.al/apel-per-oshma-te-kujdes-dezinformimin/</a>	28.02.2022
3	Evitimi i dizinformimit në përmbajtjet e transmetuara	<a href="http://ama.gov.al/njoftim-per-median-7/">http://ama.gov.al/njoftim-per-median-7/</a>	04.03.2022
4	Kanosja e gazetarëve në detyrë, akt i rrezikshëm për lirinë e fjalës dhe demokracinë	<a href="http://ama.gov.al/kanosja-e-gazetareve-ne-detyre-akt-i-rrezikshem-per-lirine-e-fjales-dhe-demokracine/">http://ama.gov.al/kanosja-e-gazetareve-ne-detyre-akt-i-rrezikshem-per-lirine-e-fjales-dhe-demokracine/</a>	23.03.2022
5	Mbi identifikimin e rasteve të shkeljeve etike në programe	<a href="http://ama.gov.al/njoftim-per-median-8/">http://ama.gov.al/njoftim-per-median-8/</a>	25.03.2022
6	Identifikimi i viktimave të abuzimeve seksuale me të mitur është i papranueshëm	<a href="http://ama.gov.al/identifikimi-i-viktimave-te-abuzimeve-seksuale-me-te-mitur-eshte-i-papranueshem/">http://ama.gov.al/identifikimi-i-viktimave-te-abuzimeve-seksuale-me-te-mitur-eshte-i-papranueshem/</a>	28.04.2022
7	Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive mbetet prioritet	<a href="http://ama.gov.al/mbrojtja-e-femijeve-nga-permbajtjet-e-demshme-audiovizive-mbetet-prioritet/">http://ama.gov.al/mbrojtja-e-femijeve-nga-permbajtjet-e-demshme-audiovizive-mbetet-prioritet/</a>	02.05.2022

8	Për respektimin e standardit në prezantimin e vlerave monetare	<a href="http://ama.gov.al/njoftim-i-ama-s-per-respektimin-e-standardit-ne-prezantimin-e-vlerave-monetare/">http://ama.gov.al/njoftim-i-ama-s-per-respektimin-e-standardit-ne-prezantimin-e-vlerave-monetare/</a>	18.05.2022
9	Mbi gjuhen e hakmarrjes, të cënimit të personalitetit	<a href="http://ama.gov.al/njoftim-per-media-7/">http://ama.gov.al/njoftim-per-media-7/</a>	27.05.2022
10	Reklamat e fshehta në transmetimet audiovizive janë të ndaluara	<a href="http://ama.gov.al/reklamat-e-fshehta-ne-transmetimet-audiovizive-jane-te-ndaluara/">http://ama.gov.al/reklamat-e-fshehta-ne-transmetimet-audiovizive-jane-te-ndaluara/</a>	07.06.2022
11	Respektimi i standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në transmetimet audiovizive	<a href="http://ama.gov.al/respektimi-i-standardit-te-shqipes-se-folur-dhe-te-shkruar-ne-transmetimet-audiovizive/">http://ama.gov.al/respektimi-i-standardit-te-shqipes-se-folur-dhe-te-shkruar-ne-transmetimet-audiovizive/</a>	23.06.2022
12	Trajtimi i rasteve të abuzimit seksual i të miturve	<a href="http://ama.gov.al/njoftim-per-shtyp-4/">http://ama.gov.al/njoftim-per-shtyp-4/</a>	23.07.2022
13	OSHMA-të përgjegjësi profesionale në raport me sigurinë kombëtare	<a href="http://ama.gov.al/oshma-te-pergjegjesi-profesionale-ne-raport-me-sigurine-kombetare/">http://ama.gov.al/oshma-te-pergjegjesi-profesionale-ne-raport-me-sigurine-kombetare/</a>	20.09.2022
14	Evitimi i përmbajtjeve audiovizive që nxisin dhe justifikojnë dhunën	<a href="http://ama.gov.al/evitimi-i-permbajtjeve-audiovizive-qe-nxisin-dhe-justifikojne-dhunen/">http://ama.gov.al/evitimi-i-permbajtjeve-audiovizive-qe-nxisin-dhe-justifikojne-dhunen/</a>	01.10.2022

	Gjatë vitit 2021	Gjatë vitit 2022
Shqyrtime tematike	67	96
Tërheqje vëmendje OSHMA-ve	24	38



### Ndarja e shkeljeve të evidentuara, 2022

Tipologjia	Numër	Përqindje
Shkelje etike	11 raste	29%
Reklamë e fshehtë	21 raste	55%
Reklamë politike	2 raste	5%
Të tjera	4 raste	11%
<b>Total</b>	<b>38 raste</b>	<b>3.</b>



Shqyrtimet dhe tërheqjet e vëmendjes kanë sjellë impakt pozitiv në performancën e OSHMA-ve, sidomos në kujdesin që po tregohet prej tyre në transmetimin e reklamave mbi shitjen e barnave (pa recetën e mjekut), ku po respektohet kërkesa ligjore për pjesën e detyrueshme të njoftimit për pacientët, bazuar dhe në kërkesat e Rregullores “Për publicitetin e barnave”, referuar Urdhrit nr. 25 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 17.01.2019. Po ashtu ka reflektim nga redaksitë audiovizive sa i takon mostransmetimit të reklamave mbi barnat, kur ato bëhen nga moderatorët e programeve apo të ftuarit në programe të ndryshme. Nuk ka pasur muajt e fundit të vitit 2022 raste që janë në kundërshtim me kërkesat e rregullores së miratuar nga AMA, që më datë 19.03.2018 “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, konkretisht me nenin 19, pika 10, ku saktësohet se: “Gjatë transmetimeve televizive është e ndaluar që realizuesit e programit dhe pjesëmarrësit në të, të bëjnë reklamimin e barnave”.

Pozitiv ka qenë dhe reagimi nga OSHMA-të për transmetimin e reklamave të fshehura gjatë edicioneve të lajmeve, për të cilat AMA ka kontaktuar dhe me përfaqësues të sipërmarrësve që kanë promovuar mallrat a shërbimet e tyre, duke kërkuar shtimin e bashkëpunimit me subjektet audiovizive për marketing, por që ky bashkëpunim të realizohet duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Nga tërheqjet e vëmendjes për reklamat e fshehura mbi aktivitetin turistik, sidomos gjatë periudhës së verës, OSHMA-të kanë vijuar me identifikimin e pjesës promociionale, në zbatim të kërkesave ligjore.

Megjithatë aspektet e mësipërme, ashtu sikundër dhe ato që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme, vendosjen e sinjalistikës për paralajmëruese për programet për të rritur mbeten në fokus të shqyrtimeve periodike, në identifikimin e rasteve me shkelje të standardeve.



## 6.2 Monitorimet e përmbajtjeve

Për monitorimin e transmetimeve digjitale në Studion e Monitorimit dhe Arkivës së AMA-s, në periudhën janar – dhjetor 2022, kanë qenë në regjistrim 48 njësi regjistrimi, ku përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor, Tibo dhe Vodafone.


Në terma statistikore, në total, gjatë këtij viti, janë regjistruar:

- në transmetimet digjitale, në total, janë regjistruar 420,000 ( $48 \times 365 \times 24$ ) orë transmetime audiovizive dhe rreth 34,500 ( $4 \times 12 \times 30 \times 24$ ) orë transmetime audio.

Krahasuar me vitet e mëparshme janë si më poshtë:

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Orë regjistrime televizione	70,000	142,000	178,000	299,500	410,000	420,000	420,000
Orë regjistrime radio	5,000	5,650	15,700	26,200	30,000	34,500	35,000

### ECURIA E ORËVE TË REGJISTRIMIT PËR RADIO DHE TELEVISIONE





Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, puna në Studion e Monitorimit fokusohet në monitorimin e:

#### A. Edicioneve informative:

- Edicione informative, në subjektet audio dhe audiovizivë kombëtarë:

*Janë monitoruar rreth 2,600 edicione informative (1,500 (4\*365) edicione të subjekteve audiovizivë kombëtarë dhe 1,100 (3\*365) edicione të subjekteve audio kombëtare).*

#### B. Reklamave:

- Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizivë kombëtarë:

*janë rreth 25,500 orë programe të monitoruara.*

Sa i takon monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, nga AMA realizohet vlerësimi i një edicioni në ditë, si bartës i linjës editoriale. Të dhënat sasiore të proporcionalitetit kohor, në edicionet informative kryesore, publikohen rregullisht çdo muaj në faqen zyrtare të Institucionit, në një rubrikë të veçantë.

Krahasuar me vitet e mëparshme, të dhënat janë si më poshtë:


##### a. Monitorime edicione lajmesh

	<b>Kategoria e OSHMA-ve</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Viti 2017</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2021</b>	<b>Viti 2022</b>
1	Televizione	900	1,340	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
2	Radio	600	770	1,000	1,100	1,100	1,100	1,100






## MONITORIME EDICIONE LAJMESH



### b. Monitorime reklamash


	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Subjekte audiovizive kombëtarë	14,000	16,000	17,500	17,500	25,500	25,500	25,500



### c. Shqyrtimin e ankesave nga publiku


Gjatë vitit 2022 në Studion e Monitorimit dhe Arkivës kanë ardhur për ndjekje 22 kërkesa/ankesa nga subjekte të ndryshme. Ndërsa gjatë vitit 2021 kanë qënë 14 kërkesa.

Gjatë gjithë vitit 2022 mbështetur në ankesat e vazhdueshme nga operatorë të ndryshëm televizivë në lidhje me piraterinë, Studio e Monitorimit dhe Arkivës ka kryer monitorimin e vazhduar platformës TIBO, në lidhje me zbatimin e listës së kanaleve të transmetuara (gjithsej 65 relacione konstatimi).



**2021**

14 kerkesa.



**2022**

22 kerkesa/ankesa

## **d. Monitorimi i zgjedhjeve të pjeshme vendore të 6 marsit 2022**



AMA në vijim të eksperiencës së saj të parë, për monitorimin e mbulimit nga OSHMA-të të zgjedhjeve të përgjithshme të 25 prillit 2021, realizoi monitorimin dhe të zgjedhjeve të pjeshme vendore të 6 marsit, në territorin e bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë. Në prag të fillimit të fushatës Autoriteti iu drejtua me apel të gjitha OSHMA-ve, duke kujtuar detyrimet nga Kodi Zgjedhor i Republikës, ligji 97/2013, i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në njoftimin që u adresua te subjektet audio/audiovizive shprehej besimi për mbulim të balancuar dhe me standarde profesionale nga redaksitë, për të ndikuar për një proces transparent dhe sa më të dobishëm për qytetarët. Si dhe në proceset e mëparshme zgjedhore, përmes përmbajtjeve të transmetuara, votuesve u jepej më shumë mundësi të njohin dhe të vlerësojnë kandidatët garues, subjektet politike, platformat dhe propozimet e tyre për komunitetin, të ndjekin dinamikën e fushatës në terren, udhëzimet e KQZ etj.

Gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore për të 6 bashkitë, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës, nr.13438, datë 20.01.2022, si dhe bazuar në metodologjinë e monitorimit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, AMA çdo ditë raportoi pranë KQZ mbi rezultatet e monitorimit të OSHMA-ve, ndërkohë që paraqiti dhe një raport përmbledhës për të gjithë periudhën.



---

AMA raportoi pranë KQZ mbi:

- rastet e 6 OSHMA-ve, të cilat nuk respektuan kërkesat e Kodit Zgjedhor, duke transmetuar reklama politike jashtë orarit të përcaktuar;
- rastet e 12 OSHMA-ve që në edicionet informative nuk mbajtën balancë në kohën që iu lanë dy partive kryesore PS dhe PD;
- rastet e 9 OSHMA-ve që nuk respektuan kohën e caktuar për subjektin konkurrues me deri në 20% të votave;
- rastet e 3 OSHMA-ve që tejkaluan kohën limit për transmetimin e reklamave politike për një subjekt konkurrues në zgjedhje;
- rastet e 7 subjekteve që nuk respektuan kërkesat e Kodit për periudhën e heshtjes zgjedhore;
- rastet e 3 OSHMA-ve që në sondazhet e publikuara gjatë fushatës nuk mosprezantuan të plotë treguesit identifikues;
- rastet e 2 OSHMA-ve që transmetuan sondazhe jashtë kohës së lejuar.

---

Ashtu si për zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021, edhe në ato për zgjedhjet e pjeshme vendore të 6 marsit 2022 nuk pati asnjë kontestim në adresë të të dhënave që AMA paraqiti në KQZ, si nga subjektet politike konkurruese ashtu dhe nga OSHMA-të.

# 7 | KËSHILLI I ANKESAVE




## 7.1 ADMINISTRIMI I ANKESAVE TË QYTETARËVE APO GRUPEVE TË NDRYSHME TË INTERESIT NË ADRESË TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZIVE

Përputhur me detyrimin e vet ligjor dhe rekomandimin përkatës të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve, bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo aktet nënligjore në fuqi.


Gjithsej, gjatë gjithë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar mbi 310 ankesa, të dërguara respektivisht:

- 3% - nga mediat;
- 9% - nga bizneset;
- 9% - nga shoqëria civile;
- 27% - nga institucionet;
- 52% - nga individë.



Ankesat e paraqitura kanë pasur për objekt:

- 32 % - shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 38 % - shkeljen e të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit
- 15 % - jashtë objektit të AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- 2 % - të drejtën e përgjigjes;
- 13 % - të ndryshëm.





Në 54,5% të rasteve, KA ka konkluduar me “tërheqje vëmendjeje”, 15% e tyre kanë qenë jashtë objektit të punës së KA/AMA-s, ndërkohë që në rastet e tjera (20.5%) vendimmarrja e KA ka shkuar në favor të lirisë së shprehjes.



## 7.2 MASA ADMINISTRATIVE

Me propozim të Këshillit të Ankesave, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vendosur dy gjopa ndaj subjekteve audiovizive kombëtare për shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

- 1.Gjopa e parë u vendos për përmbajtje antisemitike. Në emision komentet e të ftuarit dhe drejtuesit të emisionit nxisnin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminimin racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës në cenim të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive.
- 2.Gjopa e dytë u vendos ndaj një emisioni i cili ishte gjetur me shkelje të përsëritura si: fyerje, stigmatizim, diskriminim, vulgaritet dhe tone të pakontrolluara komunikimi. Paralelisht me këto shkelje, në një nga episodet e emisionit, fyerjet dhe diskriminimi kishin përfunduar edhe në dhunë.

Në muajin Korrik 2022, AMA dënoi me propozimin e KA-së me gjobë operatorin kombëtar një subjekt audioviziv kombëtar për shkelje të ligjit Nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për përmbajtje antisemitike në Rubrikën “Rrethi Katror”, të emisionit “E Diell”. Komentet e të ftuarit dhe drejtuesit të emisionit nxisnin intolerancën, justifikonin dhunën dhe diskriminimin racor dhe nuk respektonin rregullat e etikës në cenim të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive dhe ishin në shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht :

- Neni 4, “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pika 2/d: “moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve” dhe 2/dh: “moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën” ,
- Neni 32, “Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive”, pika 4 “OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi”.
- Neni 33, “Detyrimet e OSHMA-ve”, pika 1/a: “të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive”, pika 1/b: “të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme” dhe pika 1/ç: “të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut”.

---

Në muajin Dhjetor 2022, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s propozoi gjobë ndaj ndaj nje subjekti audioviziv kombëtar, pasi në emision kishte pasur në mënyrë të përsëritur shkelje etike, si: fyerje, stigmatizim, diskriminim, vulgaritet dhe tone të pakontrolluara komunikimi, të cilat kanë përfunduar edhe në dhunë, për të cilat Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA ka reaguar edhe me herët me disa tërheqje vëmendjeje (nr.3607prot., dt. 11.11.2021, nr.408prot., dt. 20.01.2022, nr.3755/1prot., dt. 17.11.2022).

## 7.3 THIRRJE/SENSIBILIZIME

•Maj 2022 – Një subjekti audioviziv kombëtar, iu sollën në vëmendje detyrimet e OSHMA-ve (ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 33, pika 1/ç) për respektimin e diversitetit dhe promovimin e personave me aftësi të kufizuar.

•Qershor 2022 - Një subjekti audioviziv kombëtar, iu bë thirrje për shmangien e skenave të papërshtatshme dhe vendosjen shenjave paralajmëruese në oraret që mund të ndiqen nga fëmijët.

•Korrik 2022 - Paralelisht iu është tërhequr vëmendja 9 OSHMA-ve (subjekte audiovizive kombëtare dhe lokale/rajonale) për shkelje të ligjit nr .97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për publikimin e të dhënave sensitive që identifikuan të miturën e abuzuar. Po kështu, iu bë thirrje Policisë së Shtetit, për mospublikim të të dhënave rrethimore në njoftimet për shtyp, në emër të interesit më të lartë të fëmijës.

•Shtator 2022 - Një subjekti audioviziv kombëtar iu sollën në vëmendje kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve (ligji nr.97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b).

•Nëntor 2022 - Një subjekti audioviziv kombëtar iu bë thirrje për sensibilitet të shtuar ndaj shprehjeve diskriminuese ndaj komunitet rom/egjiptian pavarësisht faktit, se gazetarja kishte reaguar dhe i ftuari kishte kërkuar ndjesë.

•Nëntor 2022 - Një subjekti audioviziv kombëtar, iu rikujtuan detyrimet përkitazi normave etike dhe deontologjisë së profesionit të gazetarit pavarësisht natyrës investiguese të emisionit dhe kontributit shoqëror në zbardhjen e çështjes përkatëse.

•15 dhjetor 2022 - Një subjekti audioviziv lokal/rajonale iu soll në vëmendje domosdoshmëria e trajtimit me kujdes dhe përgjegjësi të problematikave sensitive, që lidhin diskutimin për fenë me atë për dhunën, me synim shmangien e keqkuptimeve dhe promovimin qoftë dhe të pandërgjegjshëm të sjelljeve që bien ndesh me ligjin.

## 7.4 SEANCA DËGJIMORE (NENI 52, PIKA 6 E LIGJIT 97/2013)

### - Me Operatorin Publik

Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë me pretendimin se në emisionin “Ditë pas dite”, transmetuar në “RTSH1”, në datën 18.09.2022, ora 17:00, ishte transmetuar përmbajtje e papërshtatshme. Ankuesi pretendonte se një përmbajtje e tillë audiovizive ishte “e paarsyeshme për transmetim sidomos për personazhin dhe për ato që ai shfaq në rrjete sociale të cilat bien në kundërshtim me kodin etik dhe moral të shoqërisë”.

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave zhvilloi një bisedë këshilluese me autorët e emisionit. Këshilli u kujtoi autorëve parimet dhe detyrimet e OSHMA-ve në përmbushje të misionit mediatik, nisur edhe nga fakti se këto formate televizive iu drejtohen kryesisht të rinjve dhe të rejave dhe se imazhi që iu përcillet atyre rrezikon që të shndërrohet në model sjelljeje edhe për të miturit, marr parasysh faktin se orari i e transmetimit dhe në disa raste përmbajtjet problematike, ku ndjekësit potencialë mund të jenë edhe të miturit.

Në vijim të argumentimit të mësipërm, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, i kërkoi autorëve zbatimin e kërkesave të legjislacionit, me fokus kryesor mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe apeloj ata për rishikimin e çdo përmbajtje audiovizive në kuadër të zbatimit të dispozitave të ligjore në fuqi.

### - Mes një kompanie publike dhe një subjekti audioviziv lokal/rajonal

Një kompani publike iu drejtua me një ankesë AMA-s/KA-së për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një subjekt audioviziv lokal/rajonal, në lidhje me një lajm të transmetuar në edicionet qendrore informative, lidhur me një procedurë tenderi të shpallur nga kjo kompani, për të cilin ankuesi pretendonte se ishte i pavërtetë, i pasaktë dhe plotësisht disinformues.

Këshilli i Ankesave, bazuar në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 51), i rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave” si dhe Udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, i kërkoi subjektit audioviziv lokal/rajonal paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën, të cilat u paraqitën në mënyrë zyrtare pranë AMA-s.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, Këshilli i Ankesave i dërgoi konstatimin e tij kompanisë publike, e cila, nga ana e saj, e refuzoi këtë konstatim. Referuar ligjit, u zhvillua një seancë dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe rishqyrtimit të pozicioneve, të paraqitura, Këshilli i Ankesave arriti në përfundimin se, palët nuk ofruan fakte dhe argumente shtesë në raport me qëndrimet e mëhershme dhe për rrjedhojë, i mbeti konstatimit të vet të par, në favor të subjektit audioviziv lokal/rajonal.

## 7.5 VËZHGIME/SONDAZHE ME VETËINICIIM

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave ka zhvilluar gjithashtu edhe katër vëzhgime, nisur nga sensibiliteti i ngjarjeve/temave të trajtuara nga media, duke konkluduar në tri prej katër syresh me “tërheqje vëmendjeje” për operatorët përkatës

## 7.6 RISHIKIMI I KODIT TË TRANSMETIMIT NË BASHKËPUNIM ME TË GJITHË GRUPET E INTERESIT DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE SI OSBE DHE KIE

Në lidhje me rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë për rishikimin e Kodit të Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, zhvilloi një konferencë në Tiranë në datën 21 Prill 2022 ku së bashku me grupet e interesit, përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues nga OJF-të etj, nisi procesin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Pjesë e këtij takimi ishin edhe Dr. Wolfgang Kreissig, Kryetar i Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të Landeve gjermane dhe i Komisionit të Licencimit dhe Mbikëqyrjes; Francesco Sciacchitano, konsulent për çështjet ligjore në autoritetin rregullator Italian, AGCOM dhe drejtues i grupeve të punës për platformat ndërkombëtare të rregullatorëve; Peter Metzner, zëvendëskryetari i EPRA-s dhe konsulent ligjor për çështjet europiane pranë Konferencës së Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të landeve gjermane; ekspertë komunikimi, përfaqësues të medias publike dhe private kombëtare, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Prof. Dr. Vasilika Hysi, eksperte e ngarkuar me hartimin e Kodit të Ri të transmetimit. Ky ishte takimi i parë hapës, në kuadër të Rishikimit të Kodit të Transmetimit.

Në datën 16 Qershor 2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive nisi tryezat konsultuese me grupet e interesit për rishikimin e Kodit të Transmetimit. Takimi i parë konsultativ u zhvillua në bashkëpunim me UN WOMEN në Shqipëri, me pjesëmarrjen e gazetarëve të terrenit që mbulojnë kronikën dhe çështje të aktualitetit, si dhe me moderatorë programesh me natyrë sociale. Gjatë kësaj tryeze u prezantuan ndryshimet e bëra në Projektkodin e Transmetimit për Median Audiovizive, përfshirë seksionin e posaçëm për çështjet e barazisë gjinore. Fokusi i këtij propozimi lidhet me promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi gjinor përfshihen për herë të parë në Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive në Shqipëri.

Në datën 17 qershor 2022 u zhvillua takimi i dytë Autoriteti i Mediave Audiovizive vijoi tryezat konsultuese për draft- Kodin e ri të Transmetimit, me pjesëmarrjen e shoqatave të grave në vendin tonë. Përfaqësueset e shoqatave të grave vlerësuan përfshirjen e kapitullit të posaçëm për çështjet e barazisë gjinore dhe theksuan nevojën që ka tregu audioviziv në lidhje me trajnimin për këtë fenomen. Shoqëria civile dha sygjerime konkrete sesi kodi mund të shërbejë si nxitës për parandalimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

Takimet e mësipërme konsultuese u paraprinë nga një takim përgatitor (datë 13 Qershor 2022), gjatë të cilit AMA së bashku me ekspertin për hartimin e Kodit të Ri të transmetimit, znj. Vasilika Hysi diskutuan hollësisht (nen për nen) Seksionin e barazisë Gjinore, për të vijuar më pas me të tjera konsultime nen për nen të draftit të ri të Kodit të Transmetimit me ekspertin, të zhvilluara në datat: 21, 22, 24 Qershor 2022. Rezultatet e këtyre konsultimeve paraprake si edhe sugjerimet e drejtorive përbërëse të AMA-s u hodhën në draftin e dytë të Kodit të Ri të Transmetimit, dorëzuar më datë 1 Korrik 2022.

Projekti i për Kodin e Ri të Transmetimit përmban 11 Seksione:

SEKSIONI 1 (PARIMET THEMELORE),

SEKSIONI 2 (E DREJTA PËR PRIVATËSI DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE PERSONALE),

SEKSIONI 3 (TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE),

SEKSIONI 4 (FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE, me nënndarjet: Parimet themelore për mediat në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës, Media në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës, Ndalimi i identifikimit të fëmijës, Intervistimi i fëmijës, Reklammat dhe fëmijët, Programet kulturore, argëtuese, edukuese, filmat dhe fëmijët, Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive),

SEKSIONI 5 (RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA DHE AKSESI NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),

SEKSION I RI (PARANDALIMI DHE LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),

SEKSION I RI (PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE, PARANDALIMI DHE LUFTIMI I DISKRIMINIMIT GJINOR NË MEDIAT AUDIOVIZIVE),

SEKSIONI 8 (I RI) (REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE),

SEKSIONI 9 (KËSHILLI I ANKESAVE),

SEKSION I RI (DISPOZITA KALIMTARE),

SEKSIONI 11 (HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI). Tryezat konsultuese me grupet e interesit për Kodin e Ri të Transmetimit do të vazhdojnë.



Gjatë muajit Korrik, Këshilli i Ankesave, si njësi përgjegjëse për ndjekjen e procesit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive verifikoi shkallën dhe mënyrën e reflektimit në Draft-Kod të propozimeve, të dala nga konsultat e para si edhe të propozimeve të njësive përbërëse të AMA-s dhe ndërmori redaktimin e tekstit për ta bërë gati për konsultim publik.

Po nga Këshilli i Ankesave – si njësi e angarkuar më manaxhimin e procesit të Rishikimit të Kodit të Transmetimit – u hartua Kalendari i dymbëdhjetë konsultimeve publike vijuese, prej të cilave, dy tryeza konsultuese tematike në Tiranë dhe dhjetë tryeza konsultuese gjeneraliste në qarqet e tjera të vendit (Shkodër/Lezhë, Kukës, Dibër, Elbasan, Korçë, Durrës, Gjirokastrë, Berat, Fier, Vlorë).

Në fillim të muajit Tetor 2022, Projektkodi i plotë i Transmetimit u publikua në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi publik – ku do të qëndrojë deri në fund tremujorit të parë të vitit 2023, për të garantuar akses të plotë në dokument jo thjesht dhe vetëm të OSHMA-ve dhe grupeve të tjera të interesit, por edhe të publikut të gjerë, si për t'u njohur me të, ashtu edhe për të formuluar vërejtje, komente dhe propozime për aspekte të caktuara të tij.

Më 5 tetor 2022, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e tretë tematike të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Diskutimi i radhës u përqendrua te “Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive” si edhe te “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”. Të dyja problematikat janë kapituj të mëvetësishëm të Kodit ekzistues të Transmetimit, të cilët gjatë rishikimit janë pasuruar ndjeshëm. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile me fokus të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, shoqatave që operojnë në fushën e medias dhe të drejtave të njeriut, botës akademike, studiove ligjore, institucioneve qendrore dhe lokale, pranisë së OSBE-së dhe Këshillit të Europës në Tiranë. Përfaqësuesit e OSHMA-ve, shoqatave për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe atyre për Mbrojtjen e Fëmijëve parashtruan disa problematika dhe bënë disa propozime për ndërhyrje. Ata u përqendruan në rastet kur raportimi në media ka ndikuar identifikimin direkt apo indirekt të fëmijëve, të përfshirë në ngjarje të rënda, mungesën e emisioneve dedikuar fëmijëve, publikimin e pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen edhe nga të miturit, problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, problemet e terminologjisë përkitazi PAK, segregimit apo/dhe mospërfshirjes së tyre në formate gjeneraliste, reklama apo publicitete, mospërfshirjen e titrave në transmetimet audiovizive, problemet e aksesimit fizik të mediave nga ana e PAK dhe diskriminimit pozitiv të tyre në përmbajtje audiovizive, etj.

Më 6 tetor 2022, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e katërt tematike të këshillimit publik, me temë “Parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes” dhe “Të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”, ku morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, botës akademike, të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit Shqiptar të Medias, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Policisë së Shtetit, Bashkisë Tiranë, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në Tiranë. Përfaqësuesit e institucioneve dhe grupeve të interesit veçuan një sërë problematikash shqetësuese, duke propozuar qasjet dhe këndvështrimet e tyre lidhur me kapitujt e Kodit të Transmetimit në diskutim, duke sjellë në vëmendje raste kur raportimi në media ka shkelur të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, të drejtën për prezumimin e pafajsisë apo ka përdorur gjuhë urrejtjeje, duke nxitur urrejtje dhe përçarje shoqërore. Ata theksuan rëndësinë e Kodit të Transmetimit edhe si mjet sensibilizimi për rritjen e përgjegjësisë profesionale dhe sociale të medias audiovizive në përpjekjet për ndalimin e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore.

Më 13 tetor 2022, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi në Shkodër, tryezën e pestë të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Në ndryshim me katë tryezat paraprëse me karakter tematik, të zhvilluara në Tiranë, tryeza e zhvilluar në Shkodër pati karakter gjeneralist. Por ndonëse si paraqitja ashtu edhe diskutimet e nxitura prej saj, prekën të gjithë kapitujt e Projektkodit, vëmendja kryesore u përqendruar veçanërisht te “Barazia gjinore dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive”, te “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”, te “Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes” si edhe tek “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Pjesë e këshillimit në Shkodër u bënë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve arsimore, institucioneve lokale, etj. Përfaqësuesit e OSHMA-ve dhe grupeve të interesit u ndalën te publikimi i pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen fëmijët, te problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, te përpjekjet për shmangien e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore, në problemet e aksesit përmbajtësor dhe fizik të PAK në mediat audiovizive, etj. Duke e shtrirë diskutimin edhe përtej çështjeve të rishikimit të Kodit të Transmetimit, të pranishmit formuluan edhe disa shqetësime të mediave lokale në tërësi, përfshirë vështirësitë financiare, rritjen e detyruar të peshës së njoftimeve me pagesë në programacion, minutazhin e tejzgjatur të komunikimeve tregtare dhe problemet e tyre etike, nevojën e formateve të dedikuara për pakicat kombëtare dhe shtresat vulnerabël, etj.



---

Që prej publikimit të Projekt - Kodit të plotë të Transmetimit në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi publik – dhe në vijim, AMA ka vijuar gjatë gjithë kohës, që si me njoftime për shtyp përkitazi tryezave konsultuese, ashtu edhe me publikime të herëpashershme, të cilat evidentojnë ndërhyrjet dhe shtesat në Projekt - Kodin e Ri krahasuar me Kodin ekzistues të Transmetimit, jo vetëm të informojë për ndryshimet, por edhe të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, që të konsultohen me këtë draft dhe të bëjnë komentet apo/dhe propozimet e tyre lidhur me të.

Tryezat e konsultimit publik lidhur me Kodin e Transmetimit kanë vijuar deri në fund të muajit janar 2023, gjatë të cilit u zhvilluan tryezat në qarqet; Kukës, Dibër, Elbasan, Korçë, Durrës, Berat, Gjirokastër, Fier dhe Vlorë. Ato reflektuan jo thjesht dhe vetëm interesim dhe angazhim, por dhe karakter tejet interaktiv, duke ia dalë të vjelin mendimet dhe propozimet e pjesëmarrësve në takime si drejtpërdrejt ashtu edhe me vërejtje me shkrim pas takimeve. Në këtë fazë, Projekt - Kodi u është dërguar për një opinion të kualifikuar edhe partnerëve ndërkombëtarë, që kanë qenë gjatë gjithë kohës pjesë integrale e këtij procesi, përfshirë Këshillin e Evropës dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Pas reflektimit të komenteve të tyre dhe miratimit të tij nga Bordi i AMA-s, Kodi i Ri i Transmetimit do të promovohet në një fushatë të gjerë informimi, e cila planifikohet të zhvillohet paralelisht si në media ashtu edhe në terren.

## 7.7 GARANTIMI I SË DREJTËS SË INFORMIMIT PËR "KOMUNITETIN ME NEVOJA TË VEÇANTA SHQISORE"

Në kuadrin e përpjekjeve për ofrimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive në muajin prill 2022 KA/AMA ka pasur korrespondencë me Ministrinë e Shëndetsisë dhe Punëve Sociale (nr.1764/1, dt. 27.04.2022), në të cilën, dikasteri përkatës informohet për sa më poshtë:

“Autoriteti i Mediave Audiovizive që prej vitit 2017 është në komunikim të vazhdueshëm jo vetëm shkresor me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, duke i nxitur të përmbushin detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimeve të interpretimit ose “gjuhën e shenjave”, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, rezulton të aplikojë shërbim interpretimi për Personat që nuk Dëgjojnë në “gjuhën e shenjave”. Komunikimi me operatorët e tjerë me licensë kombëtare, ka evidentuar mungesën e interpretëve, që do të ofronin shërbimin e “gjuhës së shenjave”. Operatori audioviziv “Tv Klan” i është drejtuar me një kërkesë (Nëntor 2020) bashkëpunimi Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Personave që nuk Dëgjojnë, por vetë Shoqata, në përgjigje të kërkesës, ka vënë në dijeni operatorin audioviziv se “nuk disponon specialistë që mund të vihen në dispozicion për këtë shërbim të përditshëm”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, sipas të cilit

“Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë” (pika 15, kreu II); dhe

“Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimit të gjuhës së shenjave shqipe” (pika 16, kreu II), Autoriteti i Mediave Audiovizive, me anën e shkresës nr. 1232 Prot., datë 11.03.2021 u sugjeroi ministrive përkatëse (Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) nxitjen dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e shërbimeve të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë në transmetimet audiovizive, nëpërmjet përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave.

Në shtator 2022, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive në vijim të nismës se vet të për të sensibilizuar si institucionet ashtu edhe Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv për nevojën e ofrimit të shërbimit të interpretimit për Personat që nuk Dëgjojnë, ka pasur një korrespondencë elektronike me Drejtorinë e Punësimit pranë Agjencisë së Punësimit dhe Aftësive (dt. 29.09.2022).

Pasi u informua nga mediat për çertifikimin e interpretëve të parë me bashkëpunimin e AKPA & Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë, KA kërkoi informacion zyrtar për:

- Numrin e interpretuesve të diplomuar
- Planet vijuese në këtë drejtim dhe numrin e kandidatëve në proces
- Numrin e interpretuesve të punësuar ose në proces punësimi

Lidhur me informacionin e kërkuar, AKPA, më datë 02.10.2022 u përgjigj po nëpërmjet postës elektronike, si më poshtë vijojnë: “Ndërkohë janë çertifikuar 5 interpretë, por, duke qenë, se ata janë edhe vetë Persona me Kufizim në Dëgjim, punësimi i tyre në institucione apo OSHMA është i pamundur. Në fund të muajit tetor ka nisur kursi i formimit të 15 interpretëve të tjerë, kohëzgjatja e të cilit është rreth një vit e gjysëm”.

Në kuadrin e kërkimit dhe mbledhjes së informacionit për çështjen, KA/AMA u informua për startimin edhe të një projekti të financuar nga BE, me vlerë prej 2,3 milionë Eurosh, prezantuar më 27 shtator 2022, në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë, nga Komisioni i BE dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, i cili synon përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të fëmijëve në arsimin fillor në Shqipëri, përfshirë mbështetjen e dy institute,ve të nxënësve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë, në mënyrë që t'i transformojnë ato në qendra burimore kombëtare. Nga projekti mendohet të përfitojnë mbi 135.000 fëmijë në Shqipëri, përfshirë dhe mbi 130 nxënës që ndjekin institutet e nxënësve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë si edhe mësuesit e tyre.

Ndërkohë që procesi vazhdon dhe mendohet se do zgjasë, nga diskutimet e zhvilluara me grupet e interesit në kuadrin e tryezave konsultative në Tiranë dhe në rrethe, ka rezultuar, se një zgjidhje alternative të pranueshme dhe më pak të kushtueshme për periudhën kalimtare deri në sigurimin e interpretëve të certifikuar, paraqet edhe titrimi. Qasja është ndarë edhe me OSHMA-të, të cilat, të paktën në tryeza, janë treguar të gatshme ta fusin praktikën në përdorim.

# 8

## AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE



# AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

---

## 8.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit

AMA e mbështet veprimtarinë e vet administrative dhe rregullore në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe në legjislacionin sekondar (rregullore, vendime dhe udhëzime) të miratuar në bazë dhe zbatim të ligjit të posaçëm organik. Gjithashtu, veprimtaria e AMA-s ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë fushën e medias audio dhe audiovizive.

Kuadri ligjor, mbi të cilin mbështetet veprimtaria administrative e Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk ka pësuar shtesa apo ndryshime gjatë periudhës raportuese. Gjatë kësaj periudhe, përmes legjislacionit sekondar është plotësuar kuadri ligjor me akte rregullore që synojnë krijimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive.



## 8.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator për shërbimet audio dhe audiovizive, ka të drejtë dhe kompetencë për të hartuar akte nënligjore në zbatim të ligjit organik dhe në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2022, është punuar për hartimin apo ndryshimin e legjislacionit sekondar, me qëllim që, brenda kuadrit ligjor, të përmirësohet aktiviteti i AMA-s dhe të lehtësohet veprimtaria e operatorëve audio/audiovizivë.

Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik dhe në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit, hartimi i kuadrit nënligjor është shoqëruar me kryerjen e procesit të konsultimit dhe këshillimit publik.

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, në vitin 2022 ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Ndryshime në rregulloren *“Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio analoge”*, miratuar me vendimin nr. 187, datë 18.07.2016, i ndryshuar. Në kuadër të procesit të këshillimit, AMA ka zhvilluar tryeza konsultimi në qytetin e Korçës dhe Shkodrës, me përfaqësues nga të gjithë qarqet e Shqipërisë.

Ky akt, është bërë pjesë e mbledhjes së AMA-s të datës 22 dhjetor 2022 dhe pritet të miratohet në mbledhjen e parë të AMA-s për vitin 2023.

Me miratimin e këtij akti, rregullorja e vitit 2016 do të shfuqizohet.

Më poshtë, një shpjegim lidhur me nevojën e ndryshimit të këtij akti rregullator:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016, ka miratuar rregulloren *“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”* si dhe më tej me vendimet nr. 232, datë 03.11.2016 dhe nr. 192, datë 06.10.2017, ka miratuar disa ndryshime dhe shtesa në të. Gjatë implementimit të këtij akti janë hasur disa problematika mbi aspekte procedurale por edhe materiale të tij.

Anëtarët e AMA-s kanë kërkuar rishikimin e tij, i cili është përfshirë në Strategjinë e AMA-s dhe Planin e Veprimit për vitet 2021-2023, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 94, datë 14.10.2020.

Projekt - akti përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e lëshimit dhe rinovimit të licencës të transmetimit audio analoge, duke hequr rregullimin e procedurave për lëshimin e licencave të transmetimit audio mbështetur në rrjet numerik, pasi aktualisht nuk zbatohet dhënia e këtyre licencave.

Në këtë akt është hequr procedura rinovimit të licencës të transmetimit audio me përsëritës pasi duke marrë parasysh edhe eksperiencat e vendeve të tjera do të rregullohet me akt të veçantë.

Prej vitit 2016, kur është miratuar rregullorja audio, nuk është lëshuar asnjë licencë transmetimi audio numerike, si dhe nuk ka patur kërkesë apo interes nga subjekte për t'u pajisur me këtë lloj licence.

Në rregulloren në fuqi janë njësuar kriteret si për subjektet analoge dhe ato numerike ndërkohë që natyra e shërbimit të tyre ndryshon. Në transmetimet analoge ofrohet një program mbështetur në një rrjet, ndërsa në transmetime numerike ofrohet më shumë se 1 program, në një rrjet.

Po ashtu, referuar Strategjisë së AMA-s të sipërcituar, implementimi i teknologjisë së transmetimit audio T-DAB paraprakisht kërkon realizimin e një studimi (duke përfshirë identifikimin e interesit për këtë shërbim) dhe analizimi të një zbatimi teknik të planifikimit të frekuencave T-DAB, në përputhje me marrëveshjen GE06 dhe marrëveshje shumëpalëshe midis vendeve të rajonit, lidhur me alokimet e spektrit frekuencor VHF.

Ligji organik i AMA-s, nuk përcakton afat konkret për fillimin e ofrimit të shërbimeve audio numerike, prandaj vlerësojmë që procedurat dhe kriteret për lëshimin e licencës së transmetimit audio numerike të rregullohen me një akt të veçantë dhe të posaçëm nënligjor.

Projekt - akti ka pësuar ndryshime sa i përket:

-Procedurës së dorëzimit të aplikimeve dhe dokumentacionit pjesë e aplikimit;

-Shqyrtimit të aplikimeve dhe vendimmarrjes (duke rishikuar kriteret e pikëzimit, shtuar procedurën e shortit etj.);

-Rregullimit të plotë të procesit të rinovimit të licencave audio analoge, etj.

## 8.3 Kodi i Transmetimit

Drejtoria Juridike dhe e Licencave asistoi Këshillin e Ankesave gjatë hartimit të Kodit të Transmetimit, i cili është aktualisht në proces rishikimi nga AMA.

Takimet konsultuese janë paraprirë nga një takim përgatitor (datë 13 qershor 2022) i përfaqësuesve të Drejtorisë Ligjore dhe Këshillit të Ankesave të AMA-s, së bashku me ekspertin për hartimin e Kodit të Ri të Transmetimit, znj. Vasilika Hysi, ku u diskutua hollësisht (nen për nen) Seksioni i barazisë Gjinore para hedhjes në konsultim publik, për të vijuar më pas me të tjera konsultime nen për nen të të gjithë draftit të ri të Kodit të Transmetimit me ekspertin, të zhvilluara në datat: 21, 22, 24 qershor 2022. Rezultatet e këtyre konsultimeve paraprake si edhe sugjerimet e drejtorive/njësive përbërëse të AMA-s u hodhën në draftin e dytë të Kodit të Ri të Transmetimit, dorëzuar më datë 1 korrik 2022.

Në datën 16 qershor 2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive nisi tryezat konsultuese me grupet e interesit për rishikimin e Kodit të Transmetimit. Takimi i parë konsultativ u zhvillua në bashkëpunim me UN WOMEN në Shqipëri, me pjesëmarrjen e gazetarëve të terrenit që mbulojnë kronikën dhe çështje të aktualitetit, si dhe me moderatorë programesh me natyrë sociale.

Gjatë kësaj tryeze u prezantuan ndryshimet e bëra në Projekt - Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive, përfshirë seksionin e posaçëm për çështjet e barazisë gjinore. Fokusi i këtij propozimi lidhet me promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi gjinor përfshihen për herë të parë në Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive në Shqipëri.

Në datën 17 qershor 2022 u zhvillua takimi i dytë, Autoriteti i Mediave Audiovizive vijoi tryezat konsultuese për Projekt - Kodin e ri të Transmetimit, me pjesëmarrjen e shoqatave të grave në vendin tonë. Përfaqësueset e shoqatave të grave vlerësuan përfshirjen e kapitullit të posaçëm për çështjet e barazisë gjinore dhe theksuan nevojën që ka tregu audioviziv në lidhje me trajnimin për këtë fenomen. Shoqëria civile dha sugjerime konkrete sesi Kodi mund të shërbejë si nxitës për parandalimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

Gjatë muajit korrik 2022, Këshilli i Ankesave, si njësi përgjegjëse për ndjekjen e procesit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive verifikoi shkallën dhe mënyrën e reflektimit në Projekt - Kod të propozimeve, të dala nga konsultat e para si edhe të propozimeve të njësive përbërëse të AMA-s dhe ndërmori redaktimin e tekstit për ta bërë gati për konsultim publik.

Në periudhën korrik – dhjetor 2022, AMA në zbatim të Planit Strategjik për vitet 2021-2023, ka vijuar procesin e rishikimit të Kodit të Transmetimit (miratuar me vendimin nr. 228, datë 11.12.2017).

Ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 u evidentuan problematikat e hasura ndër vite, u angazhua eksperti për hartimin e Kodit të Ri të Transmetimit, u organizua konsulta ndërkombëtare hapëse në konferencën “Përballë Kodit të Transmetimit”, u dorëzua Drafti i rishikuar i Kodit të Transmetimit dhe u zhvilluan dy tryezat e para konsultuese – me pjesëmarrjen e gazetarëve të terrenit që mbulojnë kronikën (në bashkëpunim me UN WOMEN) dhe me pjesëmarrjen e shoqatave të grave – ku u prezantuan ndryshimet e bëra në Kodin e Transmetimit me fokus çështjet e barazisë gjinore, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 u vijua me këto hapa:

-Eksperti dorëzoi pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive Draftin e dytë të Kodit të Ri të Transmetimit, në të cilin u reflektuan rezultatet e konsultimeve të zhvilluara gjatë gjashtëmujorit të parë.

-Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive verifikoi shkallën dhe mënyrën e reflektimit në Projekt - Kod të propozimeve, të dala nga konsultat e para dhe të sugjerimeve të drejtorive përbërëse të AMA-s dhe ndërmori redaktimin e tekstit për ta bërë gati për konsultim publik.

-Po nga Këshilli i Ankesave – si njësi e ngarkuar me menaxhimin e procesit të Rishikimit të Kodit të Transmetimit – u hartua Kalendari i dymbëdhjetë i konsultimeve publike vijuese, prej të cilave, dy tryeza konsultuese tematike në Tiranë dhe dhjetë tryeza konsultuese gjeneraliste në qarqet e tjera të vendit (Shkodër/Lezhë, Kukës, Dibër, Elbasan, Korçë, Durrës, Gjirokastër, Berat, Fier, Vlorë).

-Nga fillimi i muajit tetor 2022, Projekt - Kodi i plotë i Transmetimit u publikua në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi Publik – ku do të qëndrojë deri në fund tremujorit të parë të vitit 2023, për të garantuar akses të plotë në dokument jo thjesht dhe vetëm të OSHMA-ve dhe grupeve të tjera të interesit, por edhe të publikut të gjerë, si për t’u njohur me të, ashtu edhe për të formuluar vërejtje dhe sugjerime për aspekte të caktuara të tij.

-Më 5 tetor 2022, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e tretë tematike të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Diskutimi i radhës u përqendrua tek “Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive” si edhe te “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”.

Të dyja problematikat janë kapitur të mëvetësishëm të Kodit ekzistues të Transmetimit, të cilët gjatë rishikimit janë pasuruar ndjeshëm. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile me fokus të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, shoqatave që operojnë në fushën e medias dhe të drejtave të njeriut, botës akademike, studiove ligjore, institucioneve qendrore dhe lokale, pranisë së OSBE-së dhe Këshillit të Europës në Tiranë. Përfaqësuesit e OSHMA-ve, shoqatave për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe atyre për Mbrojtjen e Fëmijëve parashtruan disa problematika dhe bënë disa propozime për ndërhyrje. Ata u përqendruan në rastet kur raportimi në media ka ndikuar identifikimin direkt apo indirekt të fëmijëve, të përfshirë në ngjarje të rënda, mungesën e emisioneve dedikuar fëmijëve, publikimin e pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen edhe nga të miturit, problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, problemet e terminologjisë përkitazi PAK, segregimit apo/dhe mospërfshirjes së tyre në formate gjeneraliste, reklama apo publicitete, mospërfshirjen e titrave në transmetimet audiovizive, problemet e aksesimit fizik të mediave nga ana e PAK dhe diskriminimit pozitiv të tyre në përmbajtje audiovizive, etj.

- Më 6 tetor 2022, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit, Këshilli i Ankesave si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi tryezën e katërt tematike të këshillimit publik, me temë “Parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes” dhe “Të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”, ku morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, botës akademike, të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit Shqiptar të Medias, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Policisë së Shtetit, Bashkisë Tiranë, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në Tiranë. Përfaqësuesit e institucioneve dhe grupeve të interesit veçuan një sërë problematikash shqetësuese, duke propozuar qasjet dhe këndvështrimet e tyre lidhur me kapitujt e Kodit të Transmetimit në diskutim, duke sjellë në vëmendje raste kur raportimi në media ka shkelur të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, të drejtën për prezumimin e pafajsisë apo ka përdorur gjuhë urrejtjeje, duke nxitur urrejtje dhe përçarje shoqërore. Ata theksuan rëndësinë e Kodit të Transmetimit edhe si mjet sensibilizimi për rritjen e përgjegjësisë profesionale dhe sociale të medias audiovizive në përpjekjet për ndalimin e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore.

-Më 13 tetor 2022, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organizoi në Shkodër, tryezën e pestë të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Në ndryshim me katër tryezat paraprëse me karakter tematik, të zhvilluara në Tiranë, tryeza e zhvilluar në Shkodër pati karakter gjeneralist. Por ndonëse si paraqitja ashtu edhe diskutimet e nxitura prej saj, prekën të gjithë kapitujt e Projektkodit, vëmendja kryesore u përqendruar veçanërisht te “Barazia gjinore dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive”, te “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”, te “Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes” si edhe tek “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”.

Pjesë e këshillimit u bënë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve arsimore, institucioneve lokale, etj. Përfaqësuesit e OSHMA-ve dhe grupeve të interesit u ndalën të publikimi i pamjeve të rënda ose të papërshtatshme në orare që mund të ndiqen fëmijët, te problemet e intervistimit dhe paraqitjes së fëmijëve, te përpjekjet për shmangien e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit të komuniteteve të caktuara shoqërore, në problemet e aksesit përmbajtësor dhe fizik të PAK në mediat audiovizive, etj.

Duke e shtrirë diskutimin edhe përtej çështjeve të rishikimit të Kodit të Transmetimit, të pranishmit formuluan edhe disa shqetësime të mediave lokale në tërësi, përfshirë vështirësitë financiare, rritjen e detyruar të peshës së njoftimeve me pagesë në programacion, minutazhin e tejzgjatur të komunikimeve tregtare dhe problemet e tyre etike, nevojën e formateve të dedikuara për pakicat kombëtare dhe shtresat vulnerabël, etj.

Që prej publikimit të Projekt - Kodit të plotë të Transmetimit në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Elektronike – në rubrikën Këshillimi publik – dhe në vijim, AMA ka vijuar gjatë gjithë kohës, që si me njoftime për shtyp përkitazi tryezave konsultuese, ashtu edhe me publikime të herëpashershme, të cilat evidentojnë ndërhyrjet dhe shtesat në Projektkodin e Ri krahasuar me Kodin ekzistues të Transmetimit, jo vetëm të informojë për ndryshimet, por edhe të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, që të konsultohen me këtë draft dhe të bëjnë propozimet e tyre.

## 8.4 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit

Siç është raportuar më parë, Autoriteti Shqiptar i Mediave Audiovizive (AMA) ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit nr. 97/2013, datë 4.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013, i cili është në përputhje me Direktivën 2010/13/EC për Shërbimet Mediatike Audiovizuale, rregullon veprimtarinë e mediave audio - vizuale dhe shërbimet mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të neutralitetit të teknologjisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka vijuar plotësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore përkatëse që prekin veprimtarinë e mediave audiovizive. Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik dhe në kuadër të transparencës institucionale, si dhe nevojës për të kërkuar nga palët e interesuara opinione, propozime dhe reagime, hartimi i legjislacionit zbatues u shoqërua me një proces konsultimi dhe këshillimi publik midis palëve të interesuara. Lidhur me Direktivën e re për Shërbimet Mediatike Audio-vizuale të rishikuar në vitin 2018, e cila është planifikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Shqiptar për 2022-2024, Shqipëria aplikoi për një Workshop TAIEX mbi përvojën e BE-së për zbatimin e Direktivës së ndryshuar të medias audio-vizuale 2018/1808/ BE.

Në vijim në kuadër të kësaj asistence me qëllim njohjen me praktikën më të mira të vendeve të BE-së, si dhe me problematikat e ndeshura në këto vende gjatë transpozimit të direktivës 2018/1808, në muajt shkurt dhe qershor 2022, u zhvilluan seminare me ekspertët e BE - së. Materialet e prezantuara në seminarët e zhvilluara, njohja me rastet praktike të disa vendeve të BE - së mbi mënyrën e zgjedhur për transpozimin e Direktivës (BE) shërbyen gjatë hartimit të draftit paraprak të projekt - ligjit.

AMA në muajin qershor 2022, ka përcjellë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), draftin paraprak të projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, si dhe dokumentacionin shoqëruar të projekt - ligjit.

Në vijim, MIE dhe AMA dërguan draftin e projekt - ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", relacionin shpjegues mbi analizën e arsyeve që kanë çuar në propozimin e tij, tabelën e përpuethshmërisë, si dhe raportin e vlerësimit të ndikimit, për mendim në Ministritë përkatëse, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), të cilat kanë sjellë komente mbi zbatimin e teknikës legislative dhe përditësimin e përkufizimeve sipas legjislacionit në fuqi, të cilat janë pasqyruar në draftin e projekt - ligjit.

Po kështu, këto dokumente janë publikuar në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, për një periudhë 30 ditore, janë publikuar në faqen zyrtare të AMA-s ([www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)), si dhe i janë dërguar për mendim tek Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA).

Në vijim, në AMA janë depozituar komente nga Dhoma Amerikane e Tregtisë lidhur me dispozitat për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit dhe përfshirjen e tyre në projekt - ligjin e sipërcituar, ndërsa sa i përket komenteve të ardhura nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe zj. Sabina Kodra, të cilat i referohen aspekteve të barazisë gjinore, konkretisht garantimin e barazisë gjinore dhe luftës kundër seksizmit në median audiovizive, garantimin e barazisë gjinore në zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s si dhe atyre të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar (KDRTSH).

Qëndrimin për këto komente AMA ia ka përcjellë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (si Ministri e linjës) në formë shkresore, duke nënvizuar se sa i përket dispozitave lidhur me ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit (komente nga Dhoma Amerikane e Tregtisë) dhe përfshirjen e tyre në projekt - ligjin e sipërcituar, në këtë fazë, ndryshimet e ligjit nr. 97/2013, vijnë si pasojë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me direktivën 2018/1808 (BE).



Ndërsa, lidhur me komentet për përfshirjen në projekt - ligj të disa aspekteve të barazisë gjinore, konkretisht garantimin e barazisë gjinore dhe luftës kundër seksizmit në median audiovizive, garantimin e barazisë gjinore në zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s si dhe të KDRTSH-s, këto do të merren në konsideratë gjatë procesit të miratimit të Kodit të Transmetimit, i cili është në proces rishikimi publik dhe përmban një seksion të veçantë, dedikuar promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

Ndërkohë, në vijim të takimit teknik të mbajtur online, në muajin nëntor 2022, me ekspertë të shërbimeve të Komisionit Evropian, Observatorit Evropian, si dhe me përfaqësues të AMA dhe MIE, u kërkua përfshirja në projektligj e parashikimeve të Direktivës 2018/1808, lidhur me platformat për shpërndarjen e videove (Video Sharing Platforms/VSPs), të cilat fillimisht nuk ishin përfshirë në draftin e projektligjit. Kjo detyrë vjen edhe si një kërkesë që Republika e Shqipërisë të vijojë të mbështetet nga “Creative Europe”.

Në vijim të këtij takimi, AMA dhe MIE përgatitën ndryshimet e sugjeruara dhe përfshirjen e tyre në draftin e projekt - ligjit, të cilat iu përcollën sërish për mendim Komisionit Evropian në javën e parë të muajit dhjetor 2022. Në vijim të këtij komunikimi, AMA dhe MIE janë njoftuar prej Komisionit mbi akordimin e një zgjatjeje kohore prej 6 muajsh, me qëllim finalizimin e punës legjislative në vazhdim dhe përmbylljen e hapave të procesit të transpozimit në nivelin e kërkuar.

Pas përfshirjes në këtë nismë të rregullimeve lidhur me video sharing platforms, dokumentet e rishikuara janë publikuar sërish në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik gjatë periudhës 12 – 26 Dhjetor 2022 si dhe janë pasqyruar komentet e ardhura nga Ministria e Drejtësisë, në datën 23 dhjetor 2022 dhe 23 janar 2023, lidhur me teknikën legjislative, por edhe përmbajtësore, të cilat janë reflektuar në versionin e ripunuar. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhë është ripunuar dokumenti i quajtur “Vlerësimi i Impaktit Rregullator (RIA)”, pas komenteve të ardhura nga Kryeministria në muajin nëntor 2022.

## 8.5 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Fokusi kryesor, edhe gjatë vitit 2022, sa i takon mbikëqyrjes së shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, ka qenë monitorimi në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës numerike nga operatorët privat kombëtarë audioviziv, identifikimi i mbulimit me sinjal numerik audioviziv të territorit të vendit si dhe verifikimi i mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtarë numerike.

Nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit, rezulton se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara të vendit, si më poshtë:

### 1. OPERATORI PUBLIK SHQIPTAR, RTSH

#### QARKU BERAT

- Lagjet mbas Kalasë së Beratit
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çepan.

*Rreth 5% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Çerravë (qendër)
- Njësia administrative Mokërr (pjesërisht)
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash.

*Rreth 6% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### QARQET TIRANË - DURRËS

- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 2% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### QARKU ELBASAN

- Njësia administrative (Fushë-Xibrakë)
- Njësia administrative Qukës (pjesërisht)
- Njësia administrative Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë).

*Rreth 1% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### QARKU VLORË

- Njësia administrative Borsh (pjesërisht)
- Njësia administrative Himarë (pjesërisht)
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç).

*Rreth 3% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Ana e Malit
- Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht)
- Njësia administrative Kelmend

*Rreth 4% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Picar
  - Njësia administrative Zagori
  - Njësia administrative Kurvelesh
  - Njësia administrative Krahës
  - Njësia administrative Qesarat
  - Njësia administrative Dropull i sipërm
  - Njësia administrative Pogon.
- Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

## QARKU DIBËR

- Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
  - Njësia administrative Sllovë, Kala e Dodës
  - Qyteti i Bulqizës (pjesërisht)
  - Njësia administrative Shupenzë, Zerçan dhe Ostren.
- Rreth 6% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

## QARKU KUKËS

- Njësia administrative Lek Bibaj.
- Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

## 2. SHOQËRIA “MEDIA VIZION”

### QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
  - Njësia administrative Polican
  - Njësia administrative Çorovodë.
- Rreth 19% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

### QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
  - Njësia administrative Dardhë
  - Njësia administrative Cërravë
  - Njësia administrative Mokër.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

### QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
  - Njësia administrative Shëngjergj
  - Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
  - Njësia administrative Krrabë
  - Njësia administrative Ndroq.
- Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

### QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
  - Njësia administrative Cudhi.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

### QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
  - Njësia administrative Pukë
  - Njësia administrative Vau i Dejes
  - Njësia administrative Fushë - Arrëz
  - Njësia administrative Ana- Malit.
- Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

## QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
  - Njësia administrative Has.
- Rreth 12 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU PESHKOPI

- Njësia administrative Peshkopi
  - Njësia administrative Bulqizë
  - Njësia administrative Klos
  - Njësia administrative Maqellarë
  - Njësia administrative Burrel.
- Rreth 41 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Përrenjas
  - Njësia administrative Librazhd
  - Njësia administrative Qukës
  - Njësia administrative Peqin
  - Njësia administrative Gramsh.
- Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
  - Njësia administrative Përmet
  - Njësia administrative Këlcyrë
  - Njësia administrative Krahës
  - Njësia administrative Picar
  - Njësia administrative Zagorie
  - Njësia administrative Kurvelesh
  - Njësia administrative Qesarat
  - Njësia administrative Dropull
  - Njësia administrative Pogon.
- Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU VLORË

- Njësia administrative Delvinë
  - Njësia administrative Dhërmi
  - Njësia administrative Borsh
  - Njësia administrative Konispol
  - Fshatrat e lumit të Vlorës ( Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).
- Rreth 7 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## 3. SUBJEKTI TV “KLAN”

## QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
  - Njësia administrative Dardhë
  - Njësia administrative Çërravë
  - Njësia administrative Mokër (pjesërisht).
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
  - Njësia administrative Shëngjergj
  - Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
  - Njësia administrative Krrabë
  - Njësia administrative Ndroq.
- Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
  - Njësia administrative Cudhi.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
  - Njësia administrative Pukë
  - Njësia administrative Fushë – Arrëz
  - Njësia administrative Ana e Malit.
- Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Krahës
  - Njësia administrative Picar
  - Njësia administrative Zagorie
  - Njësia administrative Kurvelesh
  - Njësia administrative Qesarat
  - Njësia administrative Dropull
  - Njësia administrative Pogon.
- Rreth 25 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU VLORË

- Njësia administrative Borsh
  - Njësia administrative Konispol
  - Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).
- Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## 4. SUBJETET TV “TOP –CHANNEL”, “DIGIT-ALB” DHE “ADTN”

### QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
  - Njësia administrative Poliçan (DIGITALB” DHE “ADTN”)
  - Njësia administrative Çorovodë.
- Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### QARKU KORÇË

- Njësia administrative Ersekë
  - Njësia administrative Leskovik
  - Njësia administrative Voskopojë
  - Njësia administrative Dardhë
  - Njësia administrative Cërravë
  - Njësia administrative Mokër.
- Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### QARKU FIER

- Pjesërisht Bashkia Divjakë.
- Rreth 0.3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### QARKU TIRANË

- Bashkia Kavajë
  - Njësia administrative Zall Bastar
  - Njësia administrative Shëngjergj
  - Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
  - Njësia administrative Krrabë
  - Njësia administrative Ndroq
  - Pjesërisht Bashkia Vorë.
- Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
  - Njësia administrative Cudhi.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
  - Njësia administrative Vau i Dejës
  - Njësia administrative Fushë - Arrëz
  - Njësia administrative Ana- Malit.
- Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
  - Bashkia Kukës
  - Njësia administrative Has.
- Rreth 75% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU DIBËR

- Njësia administrative Bulqizë
  - Njësia administrative Peshkopi ("DIGIT-ALB" DHE "ADTN")
  - Njësia administrative Klos
  - Njësia administrative Maqellarë
  - Njësia administrative Burrel.
- Rreth 41% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU ELBASAN


- Njësia administrative Përrenjas
  - Njësia administrative Librazhd ("DIGITALB" DHE "ADTN")
  - Njësia administrative Qukës
  - Njësia administrative Peqin
  - Njësia administrative Gramsh.
- Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
  - Njësia administrative Përmet
  - Njësia administrative Këlcyrë
  - Njësia administrative Krahës
  - Njësia administrative Picar
  - Njësia administrative Zagorie
  - Njësia administrative Kurvelesh
  - Njësia administrative Qesarat
  - Njësia administrative Dropull
  - Njësia administrative Pogon.
- Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## QARKU VLORE

- Njësia administrative Borsh
  - Njësia administrative Selenicë
  - Njësia administrative Himarë ("DIGITALB" DHE "ADTN")
  - Njësia administrative Dhërmi ("DIGITALB" DHE "ADTN")
  - Njësia administrative Konispol.
  - Njësia administrative Delvinë ("DIGITALB" DHE "ADTN").
  - Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).
- Rreth 16 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*




Në nivel kombëtar, përqindja e popullsisë së pambuluar me shërbim audioviziv numerik është paraqitur në tabelën si vijon për çdo operator.

<b>Nr</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Perqindja e popullsisë e pambuluar me shërbim audioviziv numerik</b>
<b>1</b>	<b>RTSH</b>	<b>2.8%</b>
<b>2</b>	<b>TV KLAN</b>	<b>3%</b>
<b>3</b>	<b>TOP CHANNEL</b>	<b>11%</b>
<b>4</b>	<b>DIGITALB</b>	<b>11%</b>
<b>5</b>	<b>MEDIA VIZION</b>	<b>7.5%</b>
<b>6</b>	<b>ADTN</b>	<b>11%</b>

Informojmë se për zonat e pambuluara me shërbim audioviziv nga rrjetet kombëtare tokësore numerike, mundësohet ofrimi i shërbimit audioviziv nëpërmjet platformave kablore, satelitore, IPTV, OTT dhe Internet TV, sipas përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.


Ndërkohë në kuadër të projektit të BE-së “Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit” përfituar nga MIE, lidhur me lirimimin e brezit DD2, AMA në përmbushje të kërkesave të konsulentëve të huaj mbi disa paqartësi mbi numrin e stacioneve të transmetimit të operatorëve audioviziv kombëtar publik dhe privat, u angazhua në kryerjen e inventarizimit të rrjeteve numerike në të gjithë Republikën e Shqipërisë, një nismë e marrë për herë të parë nga AMA dhe e realizuar me sukses.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, në zbatim të detyrave funksionale të Autoritetit është kryer monitorimi i shfrytëzimit të spektrit audio, nga sistemi i qendëruar i monitorimit, si dhe në terren, në kuadër të vlerësimit të shfrytëzimit sa më eficient të brezit FM, si dhe zgjidhjen e ankesave të paraqitura në AMA për interferencë.



# 9 | TRANSMETIMET NUMERIKE





---

## 9.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital

Pas finalizimit me sukses të procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, një tjetër proces, po kaq i rëndësishëm dhe në të njëjtën kohë edhe sfidues për rregullatorin, është procesi i lirimit të brezit të Dividentit Digjital, i njohur si brezi DD2. Lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke siguruar përmbushjen e kërkesës në rritje të përdoruesit për trafik dhe ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

AMA, më 26 nëntor 2021, ka miratuar Planin e ri Numerik Frekuencor (470-694 MHz), një Plan i hartuar më konsulentë të huaj, në kuadër të asistencën teknike nga ITU në bashkëpunim me rregullatorin hungarez, përfituar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Ky Plan parashikon 7 rrjete numerike kombëtare si dhe disa rrjete lokale.

Pas miratimit të Planit, AMA inicoi procesin e koordinimit ndërkufitar, me qëllim marrjen e dakordësisë nga vendet fqinje, mbi modifikimin e Planit GE06, në zbatim të dispozitave të Marrëveshjes Gjenevë 2006, ratifikuar me ligjin nr. 9851, datë 26.12.2007 “Për ratifikimin e akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor (RRC-06)”.

---

Autoriteti, gjatë vitit 2022, u përball me një proces koordinimi shumë kompleks, për shkak të papajtueshmërive midis allotmenteve kufitare me fqinjët, si dhe numrit të lartë të rrjeteve numerike në operim në Shqipëri. Për të zgjidhur këto problematika, u angazhuam në takime bilaterale, multilaterale, komunikime të vazhdueshme shkresore dhe me e-mail me vendet fqinje, për të përshpejtuar dhe nxitur marrjen e dakordësisë mbi Planin (470-694 MHz). Pavarësisht përpjekjeve tona, për shkak të kompleksitetit të këtij procesi, e patëm të pamundur finalizimin brenda afateve të kësaj procedure, duke sjellë efekt domino në vonesa në proceset e mëtejshme të liritimit të brezit 700 MHz (DD2).

Në shtator 2022, fal rolit, kontributit, përpjekjeve të pashtershme, këmbënguljes dhe bindjes së homologëve, AMA finalizoi me sukses procesin e koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti, të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), i cili modifikon Planin GE06.

Realizimi i këtij objekti ishte shumë i rëndësishëm për Autoritetin, pasi i hapi rrugë vijimit të proceseve pasardhëse në kuadër të liritimit të brezit 700 MHz (DD2) dhe dhënien në përdorim të këtij brezi në të ardhmen për rrjetet e shpejtësisë së lartë 5G.

Bazuar në Marrëveshjet shumëpalëshe të koordinimit ndërkufitar (si SEDDIF dhe Adriatik & Jon), ku respektohet parimi i ndarjes së barabartë dhe cilësore e kanaleve frekuencore, administratat nënshkruese mundësojnë operimin e 6 rrjeteve kombëtare.

Ndërkohë fal negociatave të AMA-s, si dhe vullnetit të mirë të fqinjëve, u mundësua dakordësia për operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin e AMAs për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audioviziv kombëtar në operim (publik/privat), me qëllim shmangien e deformimit të tregut audioviziv, impaktin negativ tek konsumatori, si dhe garantimin e pluralizmit mediatik.

Shqipëria do të jetë i vetmi vend në rajon, me 7 rrjete numerike kombëtare, ndërkohë që vendet me popullsi dhe hapësira territoriale më të mëdha të tilla si Slloveni, Kroaci, Greqi, Serbi..., do të operojnë me 6 rrjete të tilla.

Për shkak të reduktimit të ndjeshëm të brezit UHF, për të mundësuar operimin e 7 rrjeteve numerike tokësore, AMA është angazhuar në harmonizimin e parametrave teknik në allotmentet kufitare me këto vende, një tjetër sfidë e rregullatorit, të cilat do të reflektohen tek përditësimi i licencave të operatorëve kombëtar, konkretisht “Kushtet teknike”, proces vijues.

Ndërkohë lidhur me arritjen e dakordësisë mbi operimin e rrjetit/shtresës 8 (parashikuar për transmetime lokale), AMA nuk ka mundur të marrë dakordësinë e Serbisë për kanalet e shtuara jo sipas Planit GE-06. Momentalisht, për mundësimin e operimit të rrjeteve lokal/rajonale do të mund të përdoren vetëm kanalet të drejta përdorimi të ALB në Planin GE-06. Gjithashtu, në kuadër të procesit të lirimit të brezit 700 MHz (DD2), në janar 2022, u përfitua nga MIE projekti i BE-së “Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit”, i cili u finalizua në dhjetor 2022. Ky projekt bazohej në dy komponent kryesor: transpozimin e Kodit të ri të Komunikimeve Elektronike si dhe lirimin e brezit 700 MHz (DD2).

Në zbatim të komponentit 2, AMA përgjatë vitit 2022, ka bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët e huaj, duke kontribuar me komente dhe sugjerime mbi dokumentat:

- Strategjinë e Migrimit të Frekuencave;
- Vlerësimin e Kostove të Migrimit;
- Rekomandime mbi licencat.

Theksojmë se lirimi i brezit 700 MHz (DD2) është një proces kompleks, i cili përfshin disa vendimmarrje në kuadrin ligjor, financiar, teknik i cili ngarkon me përgjegjësi jo vetëm AMA-n por një sërë aktorësh (të tillë si MIE, MFE, MPJE, MD, Autoriteti i Konkurrencës, AKEP, operatorët audioviziv kombëtar publik dhe privat), të cilët të gjithë së bashku duhet të kenë vullnetin e mirë për të nxitur dhe përshpejtuar arritjen e objektivit. Për këtë qëllim, me urdhrin nr. 113, datë 20.07.2022 të Kryeministrit, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për lirimin e brezit digjital dividet dy (DD2), i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e veprimtarive lidhur me lirimin e këtij brezi, si dhe për propozimin e të gjitha vendimmarrjeve të nevojshme tek organet kompetente për realizimin e tij. Punimet e këtij grupi priten të zhvillohen gjatë vitit 2023.



---

## **9.2 Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit**

AMA, gjatë vitit 2022, në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirim të frekuencave të Dixhital-Dividendit”, të ndryshuar, vendimit nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonalë që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017, të ndryshuar”, të ndryshuar me vendimin nr. 69, datë 19.05.2021, vijoi me procesin e kompensimit financiar për ish operatorët ekzistues analogë lokalë/rajonalë, të mbështetur në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara.

Ecuria e kompensimit financiar (në fondin prej 1,000,000 euro), për periudhën korrik 2019 - 31 dhjetor 2022, është realizuar në masën totale 607,446 euro, si më poshtë:

Nr.	Emri tregtar/ televizioni vendor	Berat	Korcë	Fier	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Gjirokast	Dibër	Totali/ subjekt
1	"Tv Scan"			12.916	16.647			5.303			34.866
2	"Report TV"	7.316	10.987	15.717	20.257						54.277
3	"TV Lobi"		3.785								3.785
4	"TV Berati"	7.315									7.315
5	"TV UTV Education"		10.987		20.257			13.904			45.149
6	"CLUB TV"		10.987		20.257			8.838			40.082
7	"TV Apollon"			12.915			11.969				24.884
8	TV "A2"	-			20.257						20.257
9	"TV SOT 7"		10.987								10.987
10	"News 24 TV"			12.916	16.647		6.086				35.649
11	"Fax News"				15.451						15.451
12	"TV Ora News"			12.916	21.212		4.565				38.692
13	"TV Channel One"			12.916	23.717			1.768			38.401
14	"TV BBF"				16.647						16.647
15	"TV Shijak"				12.779						12.779
16	"Tv Syri"				20.257						20.257
17	TV "4+"			2.464							2.464
18	TV "Kopliku"					10.506					10.506
19	TV "BS"					10.506					10.506
20	Tv "Channel 7"								1.741		1.741
21	Tv "Channel 1"					10.506					10.506
22	Tv "ABC News"			18.517	21.636			22.506			62.659
23	TV "Euro Balkans News"				12.876						12.876
24	TV "Premium Channel"				20.257		11.969				32.226
25	Tv "Alpo"								3.686		3.686
26	TV "Antena Nord"					6.161					6.161
27	TV "Star plus"					8.014					8.014
28	"ONE TV Vlora"						9.129				9.129
29	"TV Klaudiana"							13.904			13.904
30	"TV Mati"									3.588	3.588
	<b>Totali euro/ allotment</b>	<b>14.631</b>	<b>47.735</b>	<b>101.27 6</b>	<b>267.51 9</b>	<b>45.693</b>	<b>48.284</b>	<b>73.293</b>	<b>5.427</b>	<b>3.588</b>	<b>607.446</b>

## 9.3 Kontrata AMA – RTSH

Gjatë vitit 2022 AMA realizoi dy shqyrtime, një në muajin qershor dhe një në muajin dhjetor, ku në fokus ishin përmbajtjet e transmetuara nga kanalet e RTSH-së, si dhe të dhënat mbi mosmbulimin me sinjal të disa zonave të shërbimit në territorin e vendit tonë.

Shqyrtimet nga AMA kryen bazuar në kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht, nenet 18 dhe 19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e AMA-s; nenin 33, mbi detyrimet e OSHMA-ve; kreun 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH-së, ku përfshihen nenet 90 – 126 etj; si dhe i referohet përmbajtjes ekzistuese të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, me vendim nr. 18, datë 02.03.2017.

Gjetjet kryesore të shqyrtimit që u realizuan në fund të vitit 2022 ishin:

- Vlerësimi për mbulimin e përditshëm nga kanalet RTSH 1 dhe RTSH SPORT të Kampionatit Botëror të Futbollit në Katar, si një përmbushje dhe e detyrimit nga Kontrata e Shërbimit të Transmetimit Publik për transmetimin e drejtpërdrejtë të veprimtarive kulturore, sociale, sportive, ose ngjarjeve të tjera me interes për publikun e gjerë. Hapësira që iu kushtua kësaj veprimtarie, përmes transmetimit të drejtpërdrejtë të ndeshjeve, emisioneve të posaçme me informacione, analiza, intervista, kuriozitet, apo formate të tjera tërheqëse, u identifikua si përmbajtje e shumëllojshme dhe cilësore.
- AMA është informuar nga drejtuesit e RTSH-së për përpjekjet aktuale që po bëhen në procesin e gjetjes së ekspertëve të gjuhës së shenjave dhe pret me padurim rikthimin të përmbushja e detyrimeve që ka Transmetuesi Publik, sipas Kontratës, për të aktivizuar standardin e shoqërimit të programeve të caktuara me këtë teknikë.
- Për Autoritetin, kanali RTSH KUVENDI, krahas transmetimit apo ritransmetimit të seancave parlamentare ose punimet e komisioneve të përhershme, duhet të përfshijë dhe përmbajtje informuese e shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave, apo analizave profesionale me ekspertë të fushës, mbi projekt - ligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin. Kjo qasje do të ketë më shumë impakt në nxitjen dhe gjallërimin e konsultimit publik për aktet ligjore, para se ato të diskutohen dhe votohen në seancë plenare nga deputetët. Kujtojmë dhe një rekomandim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, (mbledhja e datës 26.06.2020), që RTSH KUVENDI “të ketë më shumë hapësirë, duke qenë më shumë aktiv dhe t’u vijë në ndihmë deputetëve dhe Kuvendit, ku të pasqyrojë jo vetëm seancat por dhe dokumentarë, intervista, reportazhe, duke sjellë këtu dhe një paralelizëm me vendet fqinjë”.

- Kanali RTSH FËMIJË, lidhur me përmbajtjen e programeve që transmeton aktualisht, përgjithësisht, i përmbush kërkesat që ishin parashikuar në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik të RTSH-së. Por, ashtu si në monitorimet e mëhershme, na duhet të përsërisim nevojën e rritjes së numrit dhe të llojeve të emisioneve me dhe për fëmijë, emisione apo programe argëtuese, kulturore e edukative, prodhime të RTSH-së, edhe për mosha më të larta, konkretisht grupmoshave 10-14 vjeç, si dhe 15 deri në 18 vjeç. Në këtë mënyrë, kanali RTSH FËMIJË do të pasurojë e përmirësojë në vijimësi strukturën programore, duke u dhënë hapësirë programeve cilësore të llojeve të ndryshme, dedikuar fëmijëve, me format dhe fizionomi të përcaktuar dhe sidomos me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në ekran.
- AMA përsërit sugjerimin për kanalin RTSH SHKOLLË, i cili mund të pasurohet me emisione kulturore e rubrika argëtuese, veçanërisht në fundjava, si dhe me një programim më të përshtatshëm të transmetimeve në ditët e pushimeve shkollore. Shumëllojshmëria e programeve “pas shkollë” do të bëjë kanalin edhe më tërheqës për fëmijët, duke përmbushur kërkesat e dëshirat e tyre, sipas grupmoshave të ndryshme.
- Në buketën programore të RTSH-së duhet të vijojnë përpjekjet për të përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Në nenin 1 të këtij ligji thuhet se, RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08.00 deri në orën 22.00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash, transmetohet detyrimisht nga ora 17.00 deri në orën 22.00”.

Sa i takon respektimit të Kontratës së Shërbimit, lidhur me mbulimin me sinjal numerik të operatorit publik, lutem referojuni pikës 9.4, të këtij raporti.

## 9.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave audio/audiovizive realizohet në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore e rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menaxhimi në mënyrë sa më efektive i shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv krijon mundësi për licencimin e operatorëve të rinj në treg, siguron shmangien e interferencave të dëmshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe garanton cilësi të lartë shërbimi te përdoruesit fundorë.

## 9.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Bazuar në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, brezi frekuencor, i përcaktuar për transmetime tokësore numerike DTT, është brezi UHF dhe VHF. Bazuar në Planin Kombëtar Numerik (PKN), banda UHF, aktualisht, është në përdorim nga operatorët audiovizivë, që mundësojnë transmetimet numerike në të gjithë territorin e vendit.

Operatori publik shqiptar RTSH disponon frekuenca për dy rrjete numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuenca për 1 rrjet numerik secili prej tyre. Ndërkohë është licencuar edhe një rrjet lokal, i cili mbulon me shërbim allotmentin Elbasan. Gjithashtu, në PKN parashikohen edhe disa frekuenca të lira për licencimin e operatorëve lokalë/rajonalë. Plani Frekuencor Numerik, paraqitet si më poshtë:

Plani Frekuencor Numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të RTSH-së (i miratuar nga AMA me V. nr. 27, datë 01.02.2013)

Rrjetet Shqipëria	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë
RTSH (MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
RTSH (MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Plani Frekuencor Numerik për 5 rrjetet kombëtare private në brezin UHF në RSH

Rrjetet Kombëtare Private	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë
KLAN (MUX-3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
DIGITALB (MUX-4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
TOP CHANNEL (MUX-5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
MEDIA VIZION (MUX-6)	22	36	54	-----	57	46	29	24	21	48	53
ADTN (MUX-7)	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	51



Shoqëria “Era Digital” sh.p.k., me vendim të AMA-s nr. 186, datë 19.12.2019, është pajisur me licencë lokale transmetimi audioviziv numerik për qarkun Elbasan. Në përdorim i është përcaktuar kanali frekuencor Ch37.

#### Kanalet frekuencore të lira në brezin VHF dhe UHF

	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D	AL-012D Sub.
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë	Tiranë
Kanalet e lira në VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
		56				56		52	28	38		26
						58			59	56		44
Kanalet e lira në UHF										58		50
										60		60

Referuar tabelës më sipër, janë 6 blloqe frekuencore të lira në brezin III VHF për shërbimin audioviziv tokësor digjital (DTT) të cilët mundësojnë një rrjet numerik kombëtar. Ndërkohë për shërbimin audio tokësor digjital (T-DAB) janë 6 kanale të lira, konkretisht Ch11A, Ch11B, Ch11D, Ch12A, Ch12B dhe Ch12C, të cilët mundësojnë dy rrjete numerike kombëtare.

Sa i takon brezit UHF, numri i kanaleve të lira reduktohet, duke pasur parasysh lirimin e brezit 694-790 MHz i njohur si brezi DD2. Konkretisht, mbeten: 1 frekuencë në qarkun e Korçës (Ch28), 1 frekuencë në qarkun e Gjirokastrës (Ch38) dhe 2 frekuenca në suballotmentin e Tiranës (Ch 26 dhe Ch44).

Bazuar në Planin Frekuencor Numerik, rezulton se rreth 30.9 % e kanaleve të frekuencave, të përcaktuara nga AMA, për 5 rrjetet UHF private kombëtare, i përkasin brezit DD2.

Ndërkohë, në kuadër të procesit të lirimit të brezit 700 MHz (DD2), me vendim të AMA-s, nr. 96, datë 26.11.2021, është miratuar Plani i ri Numerik Frekuencor për transmetimet numerike tokësore (ku nuk përfshihet brezi DD2), i cili parashikon 7 rrjete numerike kombëtare si dhe disa rrjete lokale/rajonale si më poshtë:

Rrjetet	AL001D	AL002D	AL003D	AL004D	AL005D	AL006D	AL007D	AL008D	AL009D	AL010D	AL011D	Numri i kanaleve në total
MUX 1 (RTSH)	33	33	42	33	33	42	31	36	27	37	31	6
MUX 2 (RTSH)	34	34	40	34	34	40	39	41	28	38	39	6
MUX 3 (Klan)	28	28	30	28	28	30	29	30	45	29	23	5
MUX 4 (Digitalb)	21	36	38	21	21	48	21	48	48	48	28	5
MUX 5 (Top Channel)	22	22	24	22	22	24	27	47	24	26	27	5
MUX 6 (Media Vizion)	45	45	32	45	45	46	43	43	43	44	43	5
MUX 7 (ADTN)	23	23	25	23	23	25	35	32	21	35	35	5
Lokale	29	26	27	29	-	37	-	34	-	42	-	

Pas finalizimit me sukses të koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti të Planit të ri Numerik Frekuencor (470-694 MHz), më shtator 2022, Plani, i ndryshuar miratuar nga AMA më shkurt 2023 është sipas tabelës më poshtë:

Rrjetet Numerike	AL001D	AL002D	AL003D	AL004D	AL005D	AL006D	AL007D	AL008D	AL009D	AL010D	AL011D	AL012D	Numri i kanaleve në total
MUX 1 (RTSH)	33	42	42	33	33	42	28	36	27	37	28	na	6
MUX 2 (RTSH)	34	40	40	34	34	40	27	22	28	38	27	na	6
MUX 3 (KLAN)	28	30	30	28	41	30	41	29	45	29	23	na	6
MUX 4 (DIGITALB)	21	36	38	21	21	48	31	48	48	48	31	na	5
MUX 5 (TOP CHANNEL)	22	32	24	22	39	24	39	47	47	26	39	na	6
MUX 6 (MEDIA VIZION)	45	45	29	45	37	46	43	43	43	44	43	na	6
MUX 7 (ADTN)	23	23	25	23	23	25	35	32	21	35	35	na	5
Lokale	41	26	27*	na	na	na	na	34*	na	42*	na	26	
												44	

\* për shtresën e 8 (lokale), çelja e garës për dhënien në përdorim të kanaleve frekuencore do të hapet vetëm nëse finalizohet koordinimi ndërkufitar dhe regjistrimi i tyre në ITU, si dhe mungesës së interferencave të brendshme pas implementimit të procesit të migrimit të operatorëve kombëtar (publik/privat).

## 9.4.2 Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv

Në vijim të miratimit të Planit Numerik Frekuencor (pa përfshirë brezin 700 MHz), AMA ka inicuar procedurën e koordinimit të brezit UHF me vendet fqinje, duke dërguar me shkresë zyrtare kërkesën për koordinim ndërkufitar, me qëllim marrjen e dakordësisë nga administratat përkatëse, për ndryshimet e propozuara të Planit GE-06.

Gjatë muajit shkurt dhe mars 2022, AMA është angazhuar në disa takime dypalëshe me vendet e rajonit si Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Greqi, Kroaci, Itali, Serbi për të arritur dakordësinë e tyre mbi Planin Frekuencor Shqiptar.

Me qëllim nxitjen, përshpejtimin e finalizimit të kësaj procedure koordinimi, ndarjen e eksperiencave dhe diskutimeve mbi përdorimin e brezit UHF dhe VHF, sfidat rregullatore, konsiderata për të ardhmen referuar çështjeve të koordinimit frekuencor, AMA ka organizuar dy takime rajonale (shkurt 2022 dhe gusht 2022), në njëërën prej të cilave janë nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, me qëllim angazhimin e palëve për lirimin sa më të shpejt të brezit 700 MHz (DD2) nga transmetimet audiovizive.

Gjithashtu, me të njëjtën frymë bashkëpunimi, AMA në mënyrë intensive ka vijuar negociatat me fqinjët me komunikime shkresore dhe takime online dypalëshe dhe shumëpalëshe, për të zgjidhur problematikat e hasura për përdorimin e kanaleve të përbashkëta në allotmente kritike dhe për të përfituar përdorimin e 7 rrjeteve numerike audiovizive, pasuri kombëtare.

Arritja e dakordësisë e të gjithë fqinjëve mbi Planin e ri Numerik (470-694 MHz) është finalizuar në shtator 2022, duke i hapur rrugë vijimit të procedurave të mëtejshme si hartimi i Strategjisë së Migrimin, regjistrimin e kanaleve frekuencore në ITU, implementimin e ndryshimeve përkatëse në rrjetet numerike kombëtare, si dhe nënshkrimin, nga pala shqiptare, e marrëveshjeve shumëpalëshe për përdorimin e brezit UHF, si SEDDIF dhe Adriatik e Jon.

Në kuadër të procesit të koordinimit të brezit III VHF për transmetimet audio/audiovizive digjitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe T-DAB) me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon (Itali, Kroaci, Slloveni, Mal i Zi, Bosnje-Hercegovinë, Greqi dhe Shqipëri), iniciuar nga administrata e Italisë, edhe gjatë vitit 2022 janë organizuar disa takime, me qëllim rialokimin dhe përdorimin e këtij brezi në mënyrë efikase, proporcionale dhe pa interferenca të dëmshme.

Ky proces, i nisur në tetor 2019, është drejt finalizimit. Pas shumë diskutimesh dhe propozimesh midis administratave pjesëmarrëse, është dakordësuar, në parim, draft plani i ri frekuencor i rialokimit të brezit të III VHF, procedurë e cila është ende në koordinim me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon, si dhe vendet kufitare të secilës administratë të këtij grupi. Bazuar në Planin GE-06, Shqipëria mund të ndërtojë një rrjet kombëtar që mundëson transmetime audiovizive tokësore digjitale (DTT) dhe dy rrjete kombëtare që mundësojnë transmetime audio tokësore digjitale (T-DAB).

Ndërkohë draft plani i ri frekuencor i rialokimit të brezit të III VHF nga grupi Adriatik dhe Jon, në krahasim me Planin GE-06, mundëson, për administratën shqiptare, përveç sa më sipër, rrjetin e tretë kombëtar për transmetime audio digjitale T-DAB, në mënyrë ekskluzive. Për rrjetin e tretë, AMA në negociata me administratën e Italisë mbi përdorimin e kanalit Ch 10C, ka mundësuar përdorimin e këtij kanali në mënyrë ekskluzive nga të dy administratat, me kushtin e respektimit të parametrave teknik të transmetimit, duke përfituar ndarje proporcionale dhe eficiente të brezit III VHF.

Referuar procedurës së koordinimit me vendet fqinje, që nuk janë pjesë e grupit Adriatik dhe Jon, Shqipëria ka koordinuar me administratat e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, për të marrë dhe dakordësinë e tyre. Në këtë kuadër, Shqipëria ka marrë dakordësinë nga administrata serbe, për ndryshimet e propozuara të Planit GE06, për përdorimin e kanaleve frekuencore në shërbimet DTT dhe T-DAB. Ndërkohë nga pala maqedonase ka marrë dakordësi vetëm për kanalet frekuencore të shërbimit T-DAB.

Procesi i koordinimit, me palën maqedonase, vijon sa i takon dakordësisë për frekuencat e shërbimit DTT. Gjatë vitit 2022, AMA është angazhuar në komunikime të vazhdueshme me palën maqedonase për të zgjidhur papajtueshmëritë mbi përdorimin e sistemeve DTT, duke i propozuar zgjidhje, analiza teknike mbi bashkëpërdorimin e kanaleve të ngjashme në allotmentet kufitare. Pavarësisht insistimeve të vazhdueshme nuk kemi marrë përgjigje konkrete nga kjo administratë. Në mbledhjet e grupit të koordinimit të brezit III VHF “Adriatik dhe Jon”, AMA në mënyrë të vazhduar ka raportuar mbi mosdakordësinë e administratës së Maqedonisë së Veriut mbi draft Planin e rialokimit të brezit III VHF, dhe pamundësinë për zgjidhjen e kësaj problematike.

Në takimin e fundit, dhjetor 2022 administrata e Italisë është shprehur e gatshme të japë kontributin e saj teknik mbi zgjidhjen e papajtueshmërisë ALB-MKD, me qëllim që edhe Shqipëria të jetë firmëtare e Marrëveshjes multilaterale “Adriatik dhe Jon”, për mundësimin e operimit të rrjeteve numerike audio/ audiovize në brezin III VHF.

Gjatë vitit 2023, pritet firmosja e kësaj Marrëveshjeje nga të gjithë vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon.

Transmetimet digjitale radio, hapin një dritare të re në zhvillimin e këtij tregu mediatik, duke rritur cilësinë e transmetimit, kapacitetet programore, pluralizmin mediatik, konkurrencën në treg.

## 9.4.3 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Për planifikimin dhe administrimin e spektrit audio FM 87.5-108 MHz, AMA, në vijimësi, ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio, si dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të Frekuencave për këto shërbime. Disponueshmëria e frekuencave të lira, të brezit audio FM, mbetet një tjetër sfidë për rregullatorin, duke qenë se në qarqet ku ka më shumë kërkesë për këtë shërbim si Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier dhe Vlorë, identifikohen mungesa në burime të fundme, ndërkohë disponohen resurse të nevojshme për qarqet e tjera të vendit.

AMA, gjatë vitit 2022, ka kryer studime teknike me qëllim rinovimin e licencave të subjekteve që ofrojnë transmetime audio analoge në qarqe të ndryshme të vendit. Gjatë këtij viti, nuk janë çelur gara për dhënie në përdorim të frekuencave audio FM për transmetime analoge, për shkak të mungesës së disponueshmërisë së frekuencave të lira, në ato qarqe ku është shprehur interesi për transmetime audio analoge nga subjektet përkatëse, si dhe nevojës për koordinim ndërkombëtar.

Në funksion të detyrave të saj, AMA ka kryer, gjithashtu, studime mbi kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit. Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

---

## 9.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave, që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë, si dhe marrjen e masave për shmangien e tyre, edhe gjatë vitit 2022, AMA ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e spektrit audio FM, në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi synon identifikimin dhe zgjidhjen, në kohë të shpejtë, të interferencave që shkaktohen nga sinjalet e emetuara nga transmetuesit e vendeve fqinje. Në këtë kuadër, AMA administron sistemin e qendëruar të monitorimit të spektrit audio FM, në 12 stacione transmetimi.

Sic kemi informuar edhe më parë, ky sistem, monitoron on - line spektrin audio FM, përkatësisht në qytetet Kukës, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër, Korçë, Pogradec, Librazhd dhe Sarandë. Krahas identifikimit të menjëhershëm të interferencave, sistemi bën të mundur: a) Identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët në treg ndryshojnë frekuencat; b) Identifikimin e menjëhershëm të përdorimit në mënyrë ilegale të spektrit audio; c) Kontrollin e gjendjes reale të transmetimit të subjekteve audio të licencuar (janë në transmetim apo jo); d) Kontrollin e parametrave teknikë të transmetimit të subjekteve audio. Në qytetet e tjera, monitorimi i spektrit audio është kryer në mënyrë periodike nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLMF).

## **Interferencat e shkaktuara nga transmetime FM në brezin e navigacionit ajror**

Gjatë vitit 2022, AMA ka administruar ankesën e “Albcontrol” sh.a për interferenca të dëmshme në frekuencat e komunikimit tokë - ajër 122.5 Mhz dhe 123.5 Mhz në zonën e aeroportit të Rinasit.

Ekspertët e AMA-s, pasi u njohën me këtë problematikë, organizuan një monitorim të përbashkët me ekspertët e AKEP, si dhe përfaqësues nga Albcontrol në zonën pranë aeroportit të Rinasit, si dhe në disa pika të perimetrit të pistës ku ulen avionët. Në përfundim të matjeve të kryera nuk u identifikua prezenca e sinjaleve interferuese.

## **Interferencat e shkaktuara në vendet fqinjë në brezin FM (VHF)**

Referuar interferencave të brendshme, AMA gjatë vitit 2022, ka administruar ankesën e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Vodafone Albania” sh.a., mbi shkaktimin e interferencave të dëmshme në brezin uplink GSM 900, uplink GSM 1800 dhe uplink LTE 800 nga transmetuesit audioviziv, në qarkun Gjirokastër.

Për zgjidhjen e ankesës së sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., u ngrit një grup i përbashkët monitorimi AMA, AKEP dhe operatori mobile.

Pas verifikimeve të nevojshme në terren u identifikua burimi i interferencës dhe u morën masat e menjëhershme për eliminimin e tij.

Ndërkohë për sa i përket interferencave drejt vendeve fqinje, për shkak të operimit të sistemeve MFCN në brezin 694-790 MHz, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Italia identifikojnë nivele shumë të larta sinjali në territoret e tyre respektive të emetuara nga transmetuesit tanë audioviziv kombëtar. Për këtë qëllim, në mënyrë të vazhduar, në takimet multilaterale të zhvilluara në kuadër të koordinimit frekuencor kanë kërkuar, lirim në një kohë sa më të shpejt të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive, pasi në të kundërt do të kenë interferenca të dëmshme, që do të pengojnë operimin e transmetimeve të lëvizshme 5G.

Në kuadër të lirimit të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive në Shqipëri, AMA në janar 2023, ka administruar dokumentet finale, përcjellë nga MIE mbi projektin e BEsë “Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit”, si Strategjia e Migrimit, Vlerësimi i kostove të migrimit dhe rekomandime mbi licencat.

Duke vlerësuar kompleksitetin e këtij procesi, AMA do të vijojë, të bashkëpunojë me operatorët kombëtar audioviziv dhe fqinjët për të finalizuar me sukses lirim të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive numerike në RSH. Për këtë qëllim, Autoriteti do të konsiderojë dhe vlerësojë skenarë të mundshëm teknik mbi një migrim tranzitor, përpara migrimit në kanalet frekuencore sipas Planit (470-694 MHz), për të lehtësuar sa më shumë, impaktin negativ që mund të sjellë çdo vonesë e këtij procesi tek fqinjët.

**10**

**AUTORITETI NË  
PËRMBUSHJE TË  
TRANSPARENCËS  
DHE RRITJES SË  
IMAZHIT  
INSTITUCIONAL**

**2022**

## 10.1 Organizimi i brendshëm i institucionit

Gjatë vitit 2022 Autoriteti i Mediave Audiovizive mbështetur në detyrat funksionale të njësive organizative në përbërje të tij ka vijuar veprimtarinë e tij për arritjen e objektivave të vendosura në planin strategjik të veprimit 2021-2023.

Menaxhimi i burimeve njerëzore për Autoritetin e Mediave Audiovizive ka përbërë një kërkesë specifike me qëllim rritjen e rezultateve dhe transparencës në shërbim duke synuar kështu krijimin e një administrate dinamike në punën e përditshme për realizimin e objektivave në vazhdimësi.

Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative është mbështetur në manualin e politikave të burimeve njerëzore, një dokument ky i krijuar specifikisht për rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të stafit të AMA-s me përfshirjen e të gjithë legjisllacionit të nevojshëm për nëpunësin civil dhe jo vetëm (punonjësit me kontratë pune), por dhe praktikën e punës bazuar në përvojën administrative.

Nisur nga funksionet institucionale dhe objektivat e planit strategjik të veprimit 2021-2023 të AMA-s, duke konstatuar pamjaftueshmëri në mbulimin e të gjitha funksioneve e proceseve të kërkuara për realizimin e këtyre objektivave strategjike, përfshirë dhe përballimin e sfidave të hasura nga detyrimet e akteve ndërkombëtare dhe zhvillimet teknologjike në fushën e medias, mbështetur në ligjin organik të AMA-s neni 19 pika 17, AMA i propozoi Kuvendit të Shqipërisë ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Ndryshimet strukturore të propozuara u hartuan në vlerësim të plotë të ligjshmërisë, konkretisht ligjit të AMA-s, atij të pagave e shpërblimeve të strukturave të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe u miratuan me vendimin nr. 64, datë 07.07.2022 të anëtarëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në unanimitet.

Me vendimin nr. 86/2022 të Kuvendit të Shqipërisë u miratua struktura dhe organika e AMA-s. Në përmbushje të afateve ligjore, gjatë muajit dhjetor 2022 u krye procesi i ristrukturimit në mbështetje të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe akteve nënligjore për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil.

Në vijim të procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të AMA-s, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 17.02.2022 ka zgjedhur 6 anëtarë të AMA-s. Mbledhja e parë e konstituimit të anëtarëve të AMA-s është zhvilluar në datën 17 mars 2022. Me vendimin nr. 13 datë 17.03.2022 "Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të AMA-s" znj. Desada Metaj është zgjedhur Zëvendës Kryetar i AMA-s.

Gjatë vitit 2022 mbledhjet e anëtarëve të AMA-s kanë vijuar normalisht dhe në raste të veçanta janë zhvilluar nëpërmjet platformave hibride. Në total gjatë këtij viti raportues janë zhvilluar 25 mbledhje.

Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit mbi "Bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndër-institucional midis AMA-s dhe Universitetit Politeknik të Tiranës" me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike në fushën e mediave audiovizive dhe krijimin e hapësirave mbështetëse në veprimtarinë trajnuese, praktikave mësimore të studentëve pranë AMA-s janë trajnuar 7 (shtatë) student të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Universiteti i Tiranës, për një periudhë 1 mujore me mbështetje të plotë të stafit të AMA-s.

Autoriteti i Mediave Audiovizive si institucion pjesë e programit të praktikave kombëtare të punës, edhe gjatë vitit 2022 është bërë pjesë e Thirrjes VII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Mbështetur në vendimin nr. 395 datë 29.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, i ndryshuar, pikës 12/a të metodologjisë dhe planit të veprimit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, AMA, përfshiu në aktivitetin e saj praktikën mësimore të dy studentëve të cilët përfunduan me sukses praktikën pranë strukturave organizative të Autoritetit duke përfituar një përvojë kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale duke u certifikuar edhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

## 10.2 Programi i transparencës

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion i pavarur publik, krahas veprimtarisë së tij, të përcaktuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, sigurohet që të jetë transparent ndaj publikut, duke zbatuar dispozitat që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

Programi i transparencës, i rishikuar, është i ndarë në disa nënkategori për publikimin e informacionit nga autoriteti publik, ku në të përfshirën korniza ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AMA-n, informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AMA-s, informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, shërbimet që ofrohen nga AMA, procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve, etj.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Autoritetit, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al). Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet me linkun përkatës. Përveç kësaj, çdo dokument i bërë publik, është përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMA-s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve, gjë e cila mbikëqyret dhe nga nëpunësi për mbrojtjen e të Dhënave Personale i caktuar nga institucioni si person përgjegjës.

AMA ka ndjekur standartin e tërheqjes së mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga ana e grupeve të interesit, duke zbatuar me rigorozitet proceset e konsultimi dhe këshillimit publik, prej të cilave përmirëson draftet e paraqitura në faqen zyrtare të AMA-s.



Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive, publikon “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, i cili pasqyron të gjitha kërkesat për informacion, që kanë mbërritur në institucion dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Autoritetit. Gjatë vitit 2022, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, kanë mbërritur rreth 54 kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afatit të parashikuar në ligj (10 ditë pune), duke shënuar kështu një rekord pozitiv për Autoritetin.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjital për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, ndikon në fuqizimin e besueshmërisë së qytetarëve.

Lehtësimi i barrës burokratike, nëpërmjet komunikimit me publikun apo dhe me subjektet që autoriteti licenccon/autorizon, është një nga synimet kryesore të Autoritetit, kjo dhe falë postës elektronike të AMA-s, [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al), përgjigjet e të cilëve dërgohen sipas afateve të përcaktuara nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar. Gjithashtu, duke qënë se rrjetet sociale facebook dhe instagram janë të aksesueshëm nga shumë qytetar, AMA ka adresat e saj zyrtare, gjë e cila ka rritur interaktivitetin me qytetarët dhe është parë si mënyrë efikase për të arritur qëllimet në rrugë më të shpejtë dhe më pak burokratike.

AMA ka publikuar një bazë të dhënash me informacion rreth operatorëve audio dhe audiovizivë në Republikën e Shqipërisë, e cila gjëndet në rubrikën OSHMA në faqen WEB të saj. Në të përfshihen të dhënat e gjithë OSHMA-ve që AMA ka autorizuar/licencuar, të përmbledhura në një format i cili është lehtësisht më i aksesueshëm nga qytetarët apo grupet e interesit.

Ambientet e Autoritetit të Mediave Audiovizive janë të hapura për takimet me qytetarët që kanë ankesa/pyetje apo për subjektet që kanë paqartësi në procesin e plotësimit të dokumenteve, vështirësi në fazat e aplikimit apo pyetje rreth procesit të marrjes/ rinovimit të licencës. Drejtoritë e Autoritetit, të udhëhequra kryesisht nga drejtori, zhvillojnë takime ballë përballë në sallën e pritjes duke vendosur në shërbim të subjekteve apo qytetarëve informacionin e nevojshëm, duke shmangur procesin burokratik që mund të krijohet nëpërmjet komunikimit shkresor. Po ashtu, në vijim të komunikimit dhe transparencës mes subjekteve/ qytetarëve dhe autoritetit në faqen zyrtare të AMA-s krahas e-mailit zyrtar janë të publikuara dhe e-maillet e secilës drejtori dhe numrat e telefonit për të lehtësuar dhe adresuar problematikat në departamentin përkatës.

## 10.3 Aktivitete të Autoritetit

Gjatë vitit 2022 AMA ka vijuar aktivitetet e saj me grupet e interesit në lidhje me çështje të rëndësishme që prekin median audiovizive. Në kuadër të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz me vendet e rajonit, rishikimin i Kodit të Transmetimit si dhe çështjeve të tjera me rëndësi, AMA ka kryer një sërë takimesh si:

- **Lirimi i brezit 700 MHz, AMA agjendë koordinimi me vendet e rajonit, çelur nga takimi me homologët Malazezë**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive Armela Krasniqi dhe delegacioni i AMA-s ka zhvilluar një takim me homologët e Agjencisë për Komunikimet Elektronike dhe Shërbimet Postare të Malit të Zi. Znj.

Krasniqi u prit nga Drejtori Ekzekutiv Darko Grguroviç me të cilin nënvizuan nevojën e koordinimit të frekuencave në kuadër të procesit të lirimimit të brezit 700 MHz dhe avancimit sa më të shpejtë të këtij të kësaj agjende. Palët u dakordësuan në parim dhe vendosën piketat për vijimin e bashkëpunimit në këtë drejtim duke hartuar një plan të detajuar sesi do të arrihet deri tek marrëveshja finale e cila pritet të nënshkruhet në një afat sa më të shkurtër. Në kuadër të këtij procesi, Shqipëria për planin e saj frekuencor ka marrë miratimin e Bosnjë - Hercegovinës dhe ka vijuar agjendën e takimeve koordinuese me të gjithë shtetet fqinjë në rajon me qëllim finalizimin e këtij procesi në një kohë sa më të shkurtër.

- **Lirimi i brezit të frekuencave 700 Mhz, AMA dakordësohet në parim me Maqedoninë e Veriut**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive znj. Armela Krasniqi, së bashku me një delegacion nga AMA nisi një tur takimesh në vendet fqinjë për koordinimin e punës për lirimimin e brezit të frekuencave 700 MHz.

Gjatë vizitës në Maqedoninë e Veriut, znj. Krasniqi u takua edhe me homologët e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMA), kryetarin z. Zoran Trajčevski dhe nënkryetarin z. Selver Ajdiniku me të cilët u diskutua për detyrimet që rrjedhin nga Direktiva 2018/1808 e BE-së si dhe harmonizimi i rregulloreve aktuale me praktikën europiane.

Palët u angazhuan për thellimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave për çështje të përbashkëta që prekin të dy autoritetet.

- **Takim me përfaqësuesit e Agjencisë Rregullatore e Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare (RATEL) Serbi**

Në vijim të takimeve rajonale delegacioni i AMA-s ishte në një vizitë zyrtare në shtetin Serb për të diskutuar me homologët mbi koordinimin e planit frekuencor dhe harmonizimin e parametrave teknik. Diskutimet kishin për qëllim evidentimin e sfidave mbi lirimimin e brezit 700 MHz (dhe jo vetëm). Takimet bilaterale dhe komunikime të vazhdueshme shkresore me vendet fqinje vijuan për të përshpejtuar dhe nxitur marrjen e dakordësisë mbi Planin (470-694 MHz).

- **Lirimi i brezit të frekuencave 700 MHz, AMA takim në Greqi**

Në vijm të agjendës së takimeve në vendet fqinj me Shqipërinë për koordinimin e procesit për lirin e brezit të frekuencave 700 MHz, Kryetarja e AMA-s Armela Krasniqi dhe delegacioni që e shoqëron zhvilluan një takim në Ministrinë e Qeverisjes Dixhitale shtetin fqinj, Greqi. Në këtë takim znj.Krasniqi u prit nga Sekretari i Përgjithshëm i Telekomunikacionit dhe Postës, Dr.Athanasios Staveris Polykalas. Kryetarja e AMA-s, ndau eksperiencën dhe diskutimet që pati me homologët në vendet e tjera të rajonit për sfidat dhe mundësitë për lirin e këtij brezi. Përfaqësuesit e dy institucioneve ranë dakord të vijojnë diskutimin e çështjeve dypalëshe dhe të kërkojnë për zgjidhje në funksion të koordinimit teknik me qëllim çuarjen përpara të këtij procesi, i cili kërkon bashkëveprimin e të gjithë vendeve fqinjë.

- **Takim pune mes rregullatorëve rajonalë për Direktivën e BE-së dhe Brezin Frekuencor 700 MHZ**

Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi një takim pune mbi hapat e implementimit të Direktivës AVMS dhe lirin e Brezit Frekuencor 700 MHz. Në këtë tryezë morën pjesë drejtues të autoriteteve nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Implementimi i Direktivës është një proces në të cilin Shqipëria është e angazhuar në kuadër të Integritit Europian, siç është nevoja për të përmirësuar kuadrin kombëtar ligjor dhe nënligjor në fushën e mediave audio/audiovizive, harmonizimi i legjislativës “acquis communautaire” të fushës audiovizive. Transpozimi i Direktivës 2018/1808, është planifikuar në Planin Kombëtar të Integritit Europian (PKIE) 2022-2024. Bashkëbiseduesit ndanë mendimin se sfida kryesore që hasin autoritetet rregullatore në transpozimin e Direktivës, lidhet me “video sharing platforms”. Pjesëmarrësit nga vendet e rajonit vlerësuan këtë iniciativë të AMA-s si tejet të frytshme jo vetëm sa i takon shkëmbimit të eksperiencave, por edhe forcimit e konsolidimit të bashkëpunimit mes fqinjëve.

- **Lirimi i brezit frekuencor 700 MHz: Krasniqi takim në Autoritetin Rregullator Kroat për Industrinë e Rrjeteve (HAKOM) Kroaci**

Shqipëria vijon agjendën e takimeve për të koordinuar Lirin e Brezit Frekuencor 700 MHz (njohur si DD2). Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive znj.Armela Krasniqi dhe delegacioni i AMA-s ishin në një vizitë zyrtare në Kroaci për të diskutuar me homologët kroat mbi koordinimin e planit frekuencor dhe harmonizimin e parametrave teknik. Palët diskutuan mbi pikat në të cilat dy vendet kanë çështje për të zgjidhur në vijim të koordinimit të frekuencave të brezit UHF dhe brezin e III- VHF.

Pala kroate u dakordësua në parim me planin frekuencor të Shqipërisë dhe do të vijojë punën me administratën e AMA-s për harmonizimin e parametrave teknikë për të shmangur interferenca në të ardhmen. Kroacia ishte një ndër vendet e fundit në rajon që nuk kishte dhënë dakordësinë e saj për planin frekuencor shqiptar.

- **Takimi rajonal “Përdorimi i brezit UHF dhe VHF, sfidat rregullatore, konsiderata për të ardhmen referuar çështjeve të koordinimit frekuencorë”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në kuadër të procesit të koordinimit të brezit 470- 694 MHz, me qëllim lirim të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe dhënien në përdorim për rrjetet e lëvizshme 5G, organizoi në datën 30 Gusht 2022, në qytetin e Durrësit tryezën rajonale me temë “Përdorimi i brezit UHF dhe VHF, sfidat rregullatore, konsiderata për të ardhmen referuar çështjeve të koordinimit frekuencorë”. Pjesëmarrja e përfaqësuesve nga rregullatorët homologë respektivë të vendeve fqinjë të tillë si Slloveni, Kroaci, Mal i Zi, Serbi, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, shënoi interes e vlerësim të lartë sa i përket diskutimeve teknike profesionale mbi pritshmëritë dhe vijimësinë e punës në arritje të qëllimit të vetëm, përdorimin sa më eficient të spektrit audio/audiovizive. Ky takim erdhi gjithashtu edhe si shenjë mirënjohjeje për bashkëpunimin e vazhdueshëm, intensiv dhe të frytshëm me homologët e vendeve fqinje, për të koordinuar dhe dakordësuar ndryshimet e Planit GE06 të Shqipërisë.

- **Plani i ri Frekuencor, AMA me ekspertët e BE-së dhe operatorët kombëtarë**

Lirimi i brezit frekuencor 700MHz, i njohur si DD2, kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve institucionalë dhe privatë të përfshirë në këtë proces me qëllim finalizimin e tij brenda afateve të rekomanduara në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në ambientet e AMA-s u nis një javë intensive diskutimesh pune mes operatorëve kombëtarë (publikë dhe privatë) me grupin e ekspertëve të BE-së, të përfituar nga pala shqiptare në kuadër të asistencës teknike për lirim të DD2 nga transmetimet audiovizive. Grupi i ekspertëve, vijoi me vizitën zyrtare edhe pranë pikave të transmetimit audioviziv, për të patur një një tablo sa më reale dhe të qartë për çdo rekomandim që do të ofrojë në këtë proces.

- **Dita botërore e Radios / AMA konsultim publik për Projekt - Rregulloren e Re të Radiove**

Me rastin e Ditës Botërore të Radios, Autoriteti i Mediave Audiovizive organizoi në mjediset e Bibliotekës së Re të qytetit të Korçës një takim me ofrues të shërbimeve audio. AMA ka pasur dhe ka në vëmendje ndjekjen e performancës së radiove përmes lehtësimit të procedurave për licencim/ rilicencim; ka mbështetur redaksitë radiofonike në përballimin e situatës së COVID-19, duke ju reduktuar detyrimin financiar sipas nivelit të zonës së mbulimit me sinjal. Në këtë takim u diskutua mbi Projektregulloren e radiove që AMA ka në proces konsultimi publik me synimin për të ndarë me redaksitë mendime dhe propozime për të krijuar lehtësi procedurash, transparencë dhe për të garantuar konkurrencën e lirë në treg. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga radio private dhe publike në Korçë, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Lushnjë dhe Berat.

- **AMA në proces konsultimi publik të Projekt - Rregullores së Radiove**

Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi tryezën e dytë të diskutimit mbi Projekt - Rregulloren e AMA-s për transmetimet audio analoge, e cila është në fazën e konsultimit publik. Takimi i zhvilluar në Shkodër, pason tryezën e parë që u mbajt në qytetin e Korçës me ofrues të shërbimeve audio. Procesi i konsultimit publik, i ndërmarrë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, pati si synim komunikimin e drejtpërdrejt me përfaqësuesit e redaksive të radiove, shkëmbimin e mendimeve e propozimeve mes palëve, për të krijuar kështu procedura të lehtësuara, transparencë dhe konkurrencë të lirë, ku mendimet dhe propozimet konkrete mbi Projekt - Rregulloren e diskutuar, konsiderohen nga Autoriteti si një kontribut i rëndësishëm në hartimin e një projekti final, gjithmonë në favor të cilësisë dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve radiofonike. Në tryezën e diskutimit “Mbi procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio analoge”, morën pjesë përfaqësues nga radio private dhe publike të Shkodrës, Tiranës, Lezhës, Kukësit dhe qarkut Dibër.

- **Rishikimin i Kodit të Transmetimit si nevojë e zhvillimit të tregut audioviziv 22-04-2022**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, nisi procesin e rishikimit të Kodit të Transmetimit në një konferencë në Tiranë, ku ishin prezent përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues të grupeve të interesit, nga OJF - të etj.

Znj. Krasniqi, përmendi rëndësinë e Kodit të Transmetimit dhe nevojën për të rishikuar këtë dokument, i cili është miratuar që në vitin 2017, por që kërkon rishikimin pothuajse në të gjithë gamën dhe shumëllojshmërinë e veprimit të këtij akti nënligjor.

AMA ka nisur përpjekjet për impelementimin e Direktivës Evropiane për Shërbimet Audiovizuale të miratuar në vitin 2018 nga Parlamenti Evropian, akt që do të kërkojë ndryshim të ligjit organik të AMA-s.

Ekspertet e Jashtëm që morën fjalën në këtë konferencë, ishin: Dr. Wolfgang Kreissig, Kryetari i Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të Landeve Gjermane dhe i Komisionit të Licencimit dhe Mbikëqyrjes, prezantoi eksperiencën gjermane në menaxhimin e medias dhe aktet ligjore të cilat aplikohen në këtë shtet.

Francesco Sciacchitano, konsulent për çështjet ligjore në autoritetin rregullator Italian, AGCOM dhe drejtues i grupeve të punës për platformat ndërkombëtare të rregullatorëve, solli modelin vendit të tij në kë fushë dhe sfidat që hasen.

Zëvendëskryetari i EPRA-s, njëherësh konsulent ligjor për çështjet evropiane pranë Konferencës së Drejtorëve të Autoriteteve të Mediave Audiovizive të landeve gjermane, Peter Metzner, u ndal tek përpjekjet që po bëjnë organizmat ndërkombëtarë në fushën e rregullatorëve të medias për të zgjidhur këto sfida të ngjashme në të gjitha vendet.

Autoriteti i Mediave Audiovizive po punon me znj. Vasilika Hysin në cilësinë e ekspertes për hartimin e Kodit të Ri të Transmetimit. Ajo bëri një prezantim të momenteve më të rëndësishme në të cilat do të preket Kodi Aktual dhe ato që kanë nevojë të shtohen apo planifikohen. Fushat që do të trajtohen janë “Përmbajtjet për fëmijë, gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar, Gjuha e urrejtjes dhe mbrojtja e viktimave.

Ky ishte takimi i parë hapës, i planifikuar në kuadër të Rishikimit të Kodit të Transmetimit. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar diskutimin e këtij dokumenti me të gjithë grupet e interesit dhe më tej konsultimin publik me qëllim hartimin e një dokumenti të kuptueshëm, të zbatueshëm, që garanton besueshmëri dhe barazi.

- **AMA- KiE bashkëpunim për të rishikuar Kodin e Transmetimit dhe modernizimin e studios së monitorimit**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive znj. Armela Krasniqi zhvilloi një takim me z. Cesare Pitea, menaxher i projektit rajonal Jufrex 2, komponenti Liria e Shprehjes dhe Medias në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, në kuadër të instrumentit horizontal II, projekt i përbashkët i Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Në këtë takim u fol për projekte konkrete në kuadër të forcimit të kapaciteteve të institucionit të cilat shkojnë përkrah fokusit të këtij projekti që po zhvillohet në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Në këtë kuadër, AMA do të bashkëpunojë me Këshillin e Evropës për rishikimin e Kodit të Transmetimit. Gjatë këtij procesi, AMA do të asistohet nga ekspertë të KiE të cilët do të kontribuojnë në hartimin dhe standartizimin me praktikën dhe dokumentet më të mirë ndërkombëtare. Modernizimi i studios së monitorimit në AMA është një tjetër çështje për të cilën palët do të bashkëpunojnë. Ky projekt i vjen në ndihmë institucionit gjatë punës së përditshme duke rritur cilësinë, gamën dhe shpejtësinë e monitorimit.

- **AMA dhe KPM në Departamentin Amerikan të Shtetit**

Një delegacion i përbashkët i dy rregullatorëve të medias, së Shqipërisë dhe Kosovës, përkatësisht Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) zhvilluan një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përfaqësuesit e dy autoriteteve rregullatore, kryesuar nga znj. Armela Krasniqi dhe z. Xhevat Latifi, në Departamentin Amerikan të Shtetit, u pritën nga z. Martin McDowell, Drejtor i Zyrës për Europën Qendrore dhe Juglindore.

Dinamika e zhvillimeve në të dy autoritetet rregullatore, si dhe sfidat me të cilat ato përballen, u prezantuan gjatë takimit, ku u vu theksi tek garantimi i lirisë së medias dhe konkurrencës së ndershme në transmetimet audio/audiovizive, por edhe duke përmendur përpjekjet që bëhen për të evituar fenomenet e çrregullimit informativ, më shumë në formën e dezinformimit apo propogandës. Të gjitha përpjekjet bëhen edhe më të domosdoshme duke patur në vëmendje luftën në Ukrainë dhe dezinformimin që është një kërcënim në vijimësi për të gjithë shoqëritë demokratike. Drejtori McDowell përcolli përshëndetjet më të mira të z. Gabriel Escobar, zëvendësndihmës sekretar i Zyrës për Çështje Europiane dhe Euroazinë. Z. Escobar për shkak të një agjende pune në rajon nuk mundi të t'i kontaktonte personalisht delegacionet e AMA e KPM.

- **AMA dhe KPM takojnë Federal Communication Commission**

Delegacionet e rregullatorëve të Shqipërisë dhe të Kosovës gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u takuan me përfaqësues të lartë të institucionit homolog amerikan Federal Communication Commission (Komisioni Federal i Komunikimit).

AMA e KPM u takuan për herë të parë me Komisionin Federal të Komunikimit dhe vendosën nisjen e bashkëpunimit në tre fusha me interes të përbashkët:

- Lirimi i brezave frekuencorë me fokus të veçantë informimin e shikuesit mbi procesin;
- Procesi i rinovimit të licensave;
- -Rregullimi audiovizual dhe i përmbajtjes.

Bashkëbiseduesit shprehën vullnetin për të forcuar bashkëpunimin institucional dhe dakordësuan një kalendar bashkëpunimi.

- **Washington, AMA dhe KPM në National Press Club**

Delegacionet e Autoritetit të Mediave Audiovizive të Shqipërisë dhe Komisionit të Pavaruar të Mediave të Kosovës gjatë qëndrimit të tyre në SHBA, zhvilluan një takim me Bill McCarren Drejtor Ekzekutiv i National Press Club (Klubit Kombëtar të Shtypit) dhe Gilbert Klein President i Institutit të Gazetarisë, ish President i National Press Club. Në takim morën pjesë për AMA Kryetarja znj. Armela Krasniqi, Sekretarja e Përgjithshme në detyrë, njëkohësisht Drejtore e Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Romelda Rrapollari ndërsa për KPM Kryetari z.Xhevat Latifi, zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv Faruk Rexhaj.

Bashkëbiseduesit diskutuan mbi sfidat me të cilat po përballet media sot në të gjithë botën dhe vështirësitë e gazetarëve profesionistë për të ushtruar profesionin e tyre në shërbim të publikut pa u ndikuar nga fenomene të ndryshme që po e çenojnë median.

U ra dakord që me National Press Club të nisë eksplorimi i mundësive për shkëmbimin e eksperiencave përmes praktikave më të mira dhe mbështetjen e medias mbarë shqiptare me projekte për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve.

- **Barazia gjinore, tryezë konsultimi mbi Kodin e Transmetimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive nisi tryezat konsultuese me grupet e interesit për rishikimin e Kodit të Transmetimit. Takimi i parë konsultativ në bashkëpunim me UN WOMEN në Shqipëri, u zhvillua në datën 16 Qershor 2022, me pjesëmarrjen e gazetarëve të terrenit që mbulojnë kronikën dhe çështje të aktualitetit, si dhe me moderatorë programesh me natyrë sociale.

Gjatë kësaj tryeze u prezantuan ndryshimet e bëra në Projekt - Kodin e Transmetimit për Median Audiovizive, ndër të cilat është përfshirë është një seksion i posacëm për çështjet e barazisë gjinore.

Konsultimi publik mbi Kodin e Transmetimit do të vijojë me takime dhe tryeza të Autoritetit me grupe të interesit dhe medias për të konceptuar dhe miratuar më shumicë një kod gjithëpërfshirës, largpamës, të kuptueshëm, të zbatueshëm që garanton besueshmëri por mbi të gjitha barazi.

- **Barazia gjinore për herë të parë në Kodin e Transmetimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka nisur me tryezat konsultuese për Projekt - Kodin e ri. Takimi i dytë konsultativ në bashkëpunim me UN Women Albania në Shqipëri, u zhvillua në datën 17 Qershor 2022, me pjesëmarrjen e shoqatave të grave në vendin tonë. Ky takim pasoi atë me gazetarët e terrenit që mbulojnë kronikën dhe çështje të aktualitetit, si dhe me moderatorë programesh me natyrë sociale. Në këtë tryezë u prezantuan ndryshimet e bëra në draft-Kod, ndër të cilat është përfshirë është një seksion i posacëm për çështjet e barazisë gjinore. Shoqëria civile dha sygjerime konkrete sesi kodi mund të shërbejë si nxitës për parandalimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive.

- **Tryeza e tretë e këshillimit publik në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organizoi më 5 tetor 2022 tryezën e tretë tematike të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Diskutimi i radhës u përqendrua tek "Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive" si edhe tek "Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive". Të dyja problematikat janë kapituj të mëvetësishëm të Kodit ekzistues të Transmetimit, të cilët gjatë rishikimit janë pasuruar ndjeshëm.

- **Tryeza e katërt e këshillimit publik në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit**

Në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organizoi më 6 tetor 2022, tryezën e katërt tematike të këshillimit publik, me temë “Parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes” dhe “Të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, botës akademike, të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit Shqiptar të Medias, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Policisë së Shtetit, Bashkisë Tiranë, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në Tiranë.

- **Zhvillohet në Shkodër tryeza e pestë e këshillimit publik në kuadër të rishikimit të Kodit të Transmetimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organizoi në Shkodër, më 13 tetor 2022, tryezën e pestë të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Në ndryshim prej katër tryezave paraprëse me karakter tematik, të zhvilluara në Tiranë, tryeza e zhvilluar në Shkodër pati karakter gjeneralist. Por ndonëse si paraqitja ashtu edhe diskutimet e nxitura prej saj, prekën të gjithë kapitujt e Projekt - Kodit, vëmendja kryesore u përqendrua veçanërisht tek “Barazia gjinore dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive”, tek “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”, tek “Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes” si edhe tek “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Pjesë e këshillimit u bënë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve arsimore, institucioneve lokale, etj.

- **Bashkëpunim ndërinstitucional për edukimin mediatik për fëmijët dhe të rinjtë**

Kryetarja e Autoritetit të Medias Audiovizive, znj. Armela Krasniqi ka pritur një delegacion nga Ministria e Arsimit për Shkencën, Arsimin e Lartë dhe Rininë të Kantonit të Sarajevës së Bosnje-Hercegovinës, kryesuar nga ministrja, Prof.dr. Aleksandra Nikolić. Tema kryesore e diskutimit ishte bashkëpunimi ndërinstitucional mbi edukimin për median dhe informacionin që i promovon ato nga këndvështrimi i debatit qytetar dhe i pjesëmarrjes sociale.

Krasniqi dhe Nikolić theksuan rëndësinë jetike që ka në një shoqëri demokratike media dhe informacioni, që nxisin lirinë e shprehjes, pluralizmin dhe pjesëmarrjen efikase të qytetarëve. Iniciativat për përfshirjen në edukimin për media dhe informacion, u tha gjatë takimit, ndërmerren nga aktorë të ndryshëm institucionalë dhe shoqëria civile, ku merr rëndësi koordinimi i këtyre kontributeve që targetojnë nga nxënësit e arsimit fillor dhe në nivele të tjera parauniversitare dhe universitare.

Gjithashtu, AMA ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA, REFRAM etj. Përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2022, kanë marrë pjesë në rreth 61 konferenca, takime apo seminare, kryesisht fizik dhe online, në të cilat AMA ka qenë e ftuar për të marrë pjesë apo kontribuar në organizmat dhe platformat evropiane/rajonale të medias audiovizive.



- **Tryeza e katërt e këshillimit publik në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit**

Në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organizoi më 6 tetor 2022, tryezën e katërt tematike të këshillimit publik, me temë “Parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes” dhe “Të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të OSHMA-ve, botës akademike, të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit Shqiptar të Medias, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Policisë së Shtetit, Bashkisë Tiranë, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në Tiranë.

- **Zhvillohet në Shkodër tryeza e pestë e këshillimit publik në kuadër të rishikimit të Kodit të Transmetimit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organizoi në Shkodër, më 13 tetor 2022, tryezën e pestë të këshillimit publik, në kuadrin e rishikimit të Kodit të Transmetimit. Në ndryshim prej katër tryezave paraprëse me karakter tematik, të zhvilluara në Tiranë, tryeza e zhvilluar në Shkodër pati karakter gjeneralist. Por ndonëse si paraqitja ashtu edhe diskutimet e nxitura prej saj, prekën të gjithë kapitujt e Projekt - Kodit, vëmendja kryesore u përqendrua veçanërisht tek “Barazia gjinore dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audiovizive”, tek “Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe aksesit i tyre në transmetimet audiovizive”, tek “Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes” si edhe tek “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”. Pjesë e këshillimit u bënë përfaqësues të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve arsimore, institucioneve lokale, etj.

- **Bashkëpunim ndërinstitucional për edukimin mediatik për fëmijët dhe të rinjtë**

Kryetarja e Autoritetit të Medias Audiovizive, znj. Armela Krasniqi ka pritur një delegacion nga Ministria e Arsimit për Shkencën, Arsimin e Lartë dhe Rininë të Kantonit të Sarajevës së Bosnje-Hercegovinës, kryesuar nga ministrja, Prof.dr. Aleksandra Nikolić. Tema kryesore e diskutimit ishte bashkëpunimi ndërinstitucional mbi edukimin për median dhe informacionin që i promovon ato nga këndvështrimi i debatit qytetar dhe i pjesëmarrjes sociale.

Krasniqi dhe Nikolić theksuan rëndësinë jetike që ka në një shoqëri demokratike media dhe informacioni, që nxisin lirinë e shprehjes, pluralizmin dhe pjesëmarrjen efikase të qytetarëve. Iniciativat për përfshirjen në edukimin për media dhe informacion, u tha gjatë takimit, ndërmerren nga aktorë të ndryshëm institucionalë dhe shoqëria civile, ku merr rëndësi koordinimi i këtyre kontributeve që targetojnë nga nxënësit e arsimit fillor dhe në nivele të tjera parauniversitare dhe universitare.

Gjithashtu, AMA ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA, REFRAM etj. Përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2022, kanë marrë pjesë në rreth 61 konferenca, takime apo seminare, kryesisht fizik dhe online, në të cilat AMA ka qenë e ftuar për të marrë pjesë apo kontribuar në organizmat dhe platformat evropiane/rajonale të medias audiovizive.

Përfaqësuesit e AMA-s kanë qenë prezent dhe kanë dhënë kontributet e tyre në takimet e organizuara nga:

- **Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA)** në “Takimi i 55-të i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore” si dhe Takimi i 56-të i EPRA-s “Disiformimi dhe Rregullatorët e Medias në Mjedisin Digital”;
- **Observatori Evropian Audioviziv (OBS)**, AMA ka marrë pjesë në Konferencat :“Takimi i 68-të i Këshillit Mediatik”, “Mbedhja e Këshillit Ekzekutiv dhe Konferenca e Presidencës”, “Konferenca e Kanës” si dhe Konferenca online “Përrjashtëmi i Federatës Ruse nga OBS”;
- **Fondacioni Ndërkombtar për Sisteme Zgjedhore (IFES)**, në aktivitetin me temë “Integriteti i zgjedhjeve në mjedisin e ri informativ” zhvilluar në Maqedoninë e Veriut;
- **Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AEK)**, ka zhvilluar në Maqedoninë e Veriut “Konferencën Ndërkombëtare të Rregullatorëve”;
- **OSBE/ODIHR** ka organizuar konferencën “Një prespektivë rajonale mbi fushatën zgjedhore Online-Sfidat dhe mundësitë për integritetin zgjedhor” në Malin e Zi;
- **Këshilli i Mediave të Bullgarisë (CEM)** “Sfidat e rregullatorëve, disiformimi, gjuha e urrejtjes dhe edukimi mediatik”;
- **Këshilli i Evropës**, “Takimi i 13-të i Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca”;
- **Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Mediatike Audiovizive (ERGA)**, AMA ka marrë pjesë në “Takimi i parë i vitit për anëtarët e ERGA-s”, “ Takimi Plenar i ERGA-s”, si dhe mbledhjet online “Takimin e parë të Rrjetit të Kontaktit” dhe “Takimet e Rrjetit të Kontaktit”;
- **Instituti ASPEN dhe Shoqata e Europës Juglindore**, AMA ka marrë pjesë në Konferencën “Shqëria civile dhe Forumi Think Tank”. Një panel i veçantë i Forumit iu dedikua ç’rregullimit të informacionit në Ballkanin Perëndimor dhe edukimit për median dhe informacionin. Në panelin e diskutimeve u ftua të marrë pjesë Znj. Armela Krasniqi, kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në kuader të bashkëpunimit në zgjerimin e marrëdhëniëve ndërkombëtare:

- **Kryetarja e AMA-s, Znj.Armela Krasniqi zgjidhet Zv. Presidente e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA)**

Pas një procesi votimi ku u përfshinë përfaqësues nga 27 vendet anëtare. Kjo është hera e parë që Shqipëria merr një pozicion të lartë drejtues në një nga platformat më të rëndësishme në fushën e transmetimeve të mediave audiovizive.

MNRA është themeluar në nëntor të vitit 1997, si një hapësirë dinamike komunikimi dhe shkëmbimi praktikash mbi modelet dhe transformimin e tregut audioviziv. Një nga qëllimet parësore të Rrjetit mbetet forcimi dhe përafrimi i qasjeve të vendeve anëtare në ballafaqimin e sfidave të sektorit audioviziv. Pjesë e Rrjetit janë autoritete rregullatore të Francës, Spanjës, Izraelit, Italisë, Greqisë, Kroacisë, Portugalisë, Marokut etj, vende që përfshijnë gjirin e Mesdheut.

Aktualisht Presidencën e MNRA-së e mban Presidenti i Rregullatorit Kroat, ndërsa zj. Armela Krasniqi do të ushtrojë detyrën e zv.Presidentes.

## 10.4 AMA NË BASHKËPUNIM ME PARTNERËT

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me partnerë të ndryshëm që punojnë në fushën e medias, për realizimin e projekteve të ndryshme në favor të përmirësimit të raportimit në median audiovizive, të pasurimit të literaturës profesionale, në dobi të standardizimit të raporteve mes punëdhënësit dhe punëmarrësit etj.

### **“Roli i medias audiovizive, në formimin e personalitetit tek fëmijët e moshës 6 -14 vjeç”.**

Ky projekt i mbështetur nga AMA u mbështet dy komponentë kryesorë: së pari, në vlerësimin e situatës të përmbajtjeve audiovizive për fëmijët e grupmoshës që ka në fokus, duke i monitoruar transmetimet dhe duke marrë opinione nga ndjekësit; së dyti, duke krijuar hapësira diskutimi me grupet e interesit mbi problematikat që hasen dhe sfidat për përmirësimin e cilësisë dhe shumëllojshmërisë së programacionit. Në kuadër të projektit është realizuar dhe një monitorim, i fokusuar në transmetimet e dy OSHMA-ve me licencë kombëtare, RTSH dhe Vizion Plus, si dhe dy OSHMA-ve me licencë rajonale ABC dhe News 24.

Monitorimi shkoi dhe më tej në “fotografimin” e situatës duke realizuar dhe sondazhin në Tiranë dhe Elbasan. Monitorimi i OSHMA-ve dhe gjetjet e sondazhit ishin pjesë publikimit që u realizua, titulluar “Roli i medias audiovizive, në formimin e personalitetit tek fëmijët e moshës 6 -14 vjeç”. Këto të dhëna kanë qenë dhe objekt gjatë diskutimeve që janë organizuar në Tiranë dhe Elbasan me fëmijë e prindër, si dhe pjestarë të komunitetit të medias.

### **“Tregu i punës dhe kontrata kolektive në mediat audiovizive”**

Projekti u përqëndrua në fushën e marrëdhënieve të punës së gazetarëve audiovizivë dhe për prezantimin e modeleve bashkëkohore, duke filluar me analizimin e situatës, çfarë ndodh konkretisht me marrëdhëniet e punës, qoftë në sektorin publik dhe atë privat.

Problematikat e nxjerra nga monitorimi dhe kontaktet me grupet e interesit në disa qytete të vendit si, Korçë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Tiranë, ishin pjesë e diskutimeve me komunitetin e gazetarëve që punojnë për mediat lokale dhe ato kombëtare. Në takime janë përmendur rastet e angazhimit në redaksi pa kontrata, ose në rastet kur nga punëdhënësi nuk janë shlyer rregullisht dhe në mënyrë të plotë kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe sociale. Objekt diskutimi ishte dhe aplikimi konkret i modeleve të kontratave të punës nga një vend anëtar i BE-së, Italia, si dhe modeli i një vendi nga rajoni ynë, nga Kosova.

Projekti ka pasur jo vetëm natyrë njohëse, konstatuese lidhur me situatën e marrëdhënieve të punës në vendin tonë, por dhe me alternativat më të përshtatshme për kontratat kolektive, si një mënyrë e duhur për komunitetin e medias që të përshtasë një version të zbatueshëm në kushtet e vendit tonë.

## **“Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore dhe teknike të transmetimeve audio/udiovizive”**

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi të fushave përkatëse, gjatë proceseve të punës së përbashkët të dy institucioneve, në datën 7 prill 2021, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërinstytucional” midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, gjatë vitit 2022, është rinovuar Kontrata e Shërbimit me objekt “Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore dhe teknike të transmetimeve audio/udiovizive”.

Detyrimet e FTI (UPT) ndër të tjera ishin:

- Të ndjekë dhe të marrë pjesë në grupet studimore të ngritura nga strukturat e ITU-së dhe konkretisht Zyra e Radiokomunikimit, Zyra e Standardizimit dhe Zyra e Zhvillimit, për çështjet audiovizive.
- Të angazhohet në plotësimin e pyetësorëve të përgatitur nga këto grupe pune, në bashkëpunim të ngushtë me AMA-n.
- Të analizojë konkluzionet e dala nga grupet e studimit si dhe të shprehë opinionin në nivel akademik mbi këto konkluzione. Për sa më sipër, FTI (UPT), në dhjetor 2022, ka depozituar në AMA informacionin final mbi propozimet e grupeve të punës të ITU-së, si dhe konkluzionet e nxjerra prej tyre, sa i takon çështjeve teknike dhe rregullatore të transmetimeve audio/udiovizive.

Këto materiale do t'i vijnë në ndihmë AMA-s, për përgatitjen paraprake mbi çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) që do të zhvillohet në vitin 2023, për të cilat administrata shqiptare, si anëtare me të drejta të plota në ITU, do të ketë vendimmarrje.

## **“Prirje dhe sfida të mediave televizive shqiptare në epokën e postdigjitalizimit”**

Studimi “Prirje dhe sfida të mediav e televizive shqiptare në epokën e postdigjitalizimit”, nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, i cili është në përputhje me qëllimin dhe kërkesat e Thirrjes së AMA-s, ka paraqitur në mënyrë të qartë e të argumentuar problematikat aktuale të realitetit mediatic postdigjital në Shqipëri, sfidat e reja të tregut audioviziv, llojshmëria dhe cilësia e përmbajtjeve të transmetuara, prirjet, inovacioni dhe ndikimi i zhvillimeve teknologjike në marrëdhëniet e operatorëve televizivë me publikun, domosdoshmëria e pluralizmit, larmisë programore dhe garantimi i standardeve e parimeve themelore të transmetimeve.

Departamenti ka përfshirë në studim dhe disa aspekte kryesore që janë ndeshur gjatë analizës së situatës aktuale në tregun audioviziv shqiptar, si efekte të procesit të digjitalizimit, aspekte që lidhen me shqyrtimin e programacionit, fashave orare dhe minutazhit të emisioneve të çdo dite, si edhe totalin javor për çdo emision; tregues financiarë dhe funksionalë në dinamikë të pesë viteve të fundit, të ardhurat vjetore; krijimi i kanaleve të reja televizive brenda kompanisë, lëvizjet në burimet njerëzore të angazhuara; aplikacionet e përdorura, reklamat dhe komunikimet tregtare etj.

---

Një vlerë e shtuar e projektit është organizimi i konferencës shkencore me produkt konkret studimet e paraqitura si referate, në një botim që, pas realizimit, mund të shfrytëzohet nga përdorues të shumtë.

### **“Përkthime nga literatura e huaj në shqip”**

Projektit i paraqitur nga UET “Përkthim në shqip i tekstit universitar “Understanding Human Communicattion” të Oxford University Press, është kryer në përputhje me qëllimin dhe kërkesat e komponentit të thirrjes së AMA-s për “Përkthime nga literatura e huaj në shqip”. Përzgjedhja e tekstit është konform standardeve të një kërkimi akademik e shkencor, duke i ofruar kështu studentëve, pedagogëve dhe studiuesve të fushës së komunikimit publik, mediave dhe gazetarisë një vlerë të shtuar literaturës shkencore në gjuhën shqipe. Ky tekst ka për autorë, personalitete të shquara të fushës së shkencave sociale e të komunikimit, profesorë të Universiteteve prestigjioze angleze dhe amerikane. Për realizimin e këtij projekti janë angazhuar ekspertët e lëmit akademik e shkencor për unifikimin e termave gjuhësore e shkencore e teknik, për hulumtimin e burimeve të literaturës për përkthimin e tekstit, për redaktimin dhe përgatitjen e tekstit për botim.

Sipas kontratës, do të ketë një prezantim dhe promovim të këtij produkti për audiencë të specializuar, sic janë personalitete të shquara të fushës së shkencave sociale e të komunikimit, profesorë, pedagog, studentë institute kërkimore, si dhe pjesëmarrjen e grupit të punës dhe ekspertëve nga Autoriteti i Medias Audiovizive.

## 10.5 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

Më 21 shkurt 2022 në Tiranë u nënshkruan Deklarata dypalëshe Dakordësie me Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe me Kosovën. Deklarata dypalëshe Dakordësie për Direktivën AVMSD të BE-së dhe Lirimin e Brezit frekuncor 700 MHz, të cilat do të pasohen nga Marrëveshjet përkatëse për lirimin e brezit frekuencor dhe përfundimin e këtij procesi brenda afatave të përcaktuara në aktet ndërkombëtare. Palët nënshkruese konfirmojnë arritjen e një plani të përpuethshëm të frekuencave ndërmjet administratave përkatëse mbi koordinimin e frekuencave numerike tokësore, në brezin 470-694 MHz.

### **Deklaratat e përbashkëta mbi bashkëpunimin Ndërinstitucional ndërmjet:**

1. Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Komisionit të Pavarur për Median (KPM), nënshkruar nga z. Xhevat Latifi, Kryetar i Komisionit të Pavarur të Medias në Kosovë;

2. Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Agjencisë Elektronike të Komunikimit (AEK), nënshkruar nga z. Jeton Akiku, Drejtor i Agjencisë për Komunikime Elektronike në Maqedonia e Veriut;

3. Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Agjencisë Elektronike e Komunikimit dhe Shërbimeve postare (EKIP), nënshkruar nga z. Darko Drgurovic, Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Komunikimet Elektronike dhe Shërbimeve Postare (Ekip) të Malit të Zi.

### **Palët bien dakord të nënshkruajnë deklaratën e përbashkët me qëllim fokusimin në mënyrë të veçantë për:**

-Shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencës për harmonizimin e legjislacioneve kombëtare me standardet e praktikave më të mira evropiane;

-Zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në fushën e mediave audiovizive;

-Organizimin e këshillimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta për të evidentuar përvojën e të dy palëve në fushën e mediave audiovizive;

-Dhënien e asistencës në hartimin e kuadrit të nevojshëm rregullator;

-Pjesëmarrjen e ekspertëve të palëve në takime, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta, me pjesëmarrjen e ekspertëve të të dy palëve mbi aspekte të ndryshme në fushën e mediave audiovizive.

Palët në takim dakordësuan mbajtjen e takimeve rajonale në mënyrë periodike si dhe me qëllim bërjen efektive të bashkëpunimit, ranë dakord që stafet teknike të vendosin ura direkte komunikimi dhe bashkëpunimi. Shqipëria për planin e saj frekuencor DD2 ka marrë miratimin edhe të Italisë e Greqisë.

---

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës**

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi të fushave përkatëse, gjatë proceseve të punës së përbashkët të dy institucioneve, në datën 7 prill 2021, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërinstitucional” midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, gjatë vitit 2022, është rinovuar Kontrata e Shërbimit me objekt “Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore dhe teknike të transmetimeve audio/audiovizive”.

Detyrimet e FTI (UPT) ndër të tjera ishin:

- Të ndjekë dhe të marrë pjesë në grupet studimore të ngritura nga strukturat e ITU-së dhe konkretisht Zyra e Radiokomunikimit, Zyra e Standardizimit dhe Zyra e Zhvillimit, për çështjet audiovizive.

- Të angazhohet në plotësimin e pyetësorëve të përgatitur nga këto grupe pune, në bashkëpunim të ngushtë me AMA-n.

- Të analizojë konkluzionet e dala nga grupet e studimit si dhe të shprehë opinionin në nivel akademik mbi këto konkluzione. Për sa më sipër, FTI (UPT), në dhjetor 2022, ka depozituar në AMA informacionin final mbi propozimet e grupeve të punës të ITU-së, si dhe konkluzionet e nxjerra prej tyre, sa i takon çështjeve teknike dhe rregullatore të transmetimeve audio/audiovizive.

Këto materiale do t'i vijnë në ndihmë AMA-s, për përgatitjen paraprake mbi çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) që do të zhvillohet në vitin 2023, për të cilat administrata shqiptare, si anëtare me të drejta të plota në ITU, do të ketë vendimmarrje.

## **10.6 PUBLIKIMI I BULETINIT PERIODIK TË AMA-S**

Gjatë vitit 2022, AMA përgatiti Edicionin 8 të Buletinit Periodik, që jep një pasqyrë të dinamikës në tregun audio/audioviziv, ku përfshihen dhe tregues me natyrë ekonomike dhe financiare, teknike e teknologjike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., në vitin 2021. Buletini është një produkt i standardizuar dhe i qëndrueshëm, si ndihmë konkrete për analizuar problematika e prirje brenda një viti.

Buletini Periodik është material ndihmës jo vetëm për stafet e OSHMA-ve, ku shikohet performanca e subjektit të tyre në raport me të gjithë tregun, ose segmente të caktuara të tij, por në versionin hard copy ose soft copy preferohet nga kërkuesit dhe studiuesit e tregut audio/audioviziv, studentët e gazetarisë e të komunikimit, për institucionet vendase dhe të huaja që monitorojnë dhe mbështesin projekte dhe programe në sektorin mediatik etj.

## 10.7 MENAXHIMI I PËRFORMANCËS SË BURIMEVE NJERËZORE

Zhvillimi organizativ i institucionit është ndërtuar duke u mbështetur në komunikimin e strukturave organizative të brendshme të tij, bashkëpunimin dhe konsultimin ndërmjet tyre ka krijuar një mjedis pune profesional dhe mbështetës për personelin.

Zbatimi i politikave të trajnimit si pjesë e strategjisë së burimeve njerëzore duke u zhvilluar dhe rishikuar në mënyrë dinamike i ka mundësuar AMA-s përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore.

Në përmbushje të detyrimit ligjor struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore si për çdo vit ka hartuar kalendarin e nevojave për trajnim mbështetur në një plan trajnimi të detajuar në bazë të kërkesave specifike të çdo njësie organizative si dhe në përkrahje të angazhimit të punonjësve për të zhvilluar njohuritë e tyre profesionale e organizative.

Në ndjekje të zbatimit të këtij kalendarit trajnimi dhe në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, roli koordinues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ka mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë nëpunësve civil në trajnimet specifike, të përgjithshme dhe sipas nevojave, por dhe ato online me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës së çdo nëpunësi civil.

Përpjekjet janë bërë edhe për pjesëmarrjen dhe trajnimin e stafit të institucionit në takime dhe workshop-e të organizuara në kuadër të projekteve të ndryshme ku AMA është palë. Konkretisht, përmendim projektin “Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit”, projekt i cili është mundësuar nga MIE në bashkëpunim me PLANET (konsulentë të huaj nga BE).

Nëpërmjet këtij projekti përveç të tjerash u synua plotësimi i njohurive të inxhinierëve dhe teknikëve mbi Marrëveshjen GE06 për transmetimet tokësore numerike, principe të koordinimit ndërkombëtar, kuadri ligjor dhe teknik në Shqipëri, Plani i ri numerik frekuencor (470-694 MHz) (allotmentet e reja SFN, interferencat e jashtme dhe të brendshme, matrica e përpunueshmërisë), implementimi i ishujve numerik, implemetimi i procesit të migrimit (procesi teknik, roli i palëve të interesit në këtë proces migrimi, vendimet që duhet të merren nga AMA/MIE), fushata e informimit, mbështetja e popullatës gjatë këtij procesi, si dhe koordinimi dhe kontrolli.

### POLITIKAT E TIK

Në kuadër të përmirësimit të përdorimit të teknologjisë së informacionit, për të shmangur rreziqet e mundshme nga sulmet apo hyrjet e paautorizuara në sistemin TIK, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe qasjes në publik, gjatë vitit 2022, AMA ka miratuar dokumentin mbi politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail. Kjo politikë është e detyrueshme për të gjithë punonjësit e AMA-s dhe për çdo person të jashtëm (kontraktor, konsulent, nëpunës të përkohshëm etj.), i cili mund të aksesojë sistemet dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit të AMA-s.

Objekti i kësaj politike është disiplinimi i përdorimit të internetit në AMA (nëpërmjet vendosjes së rregullave dhe të procedurave të nevojshme) për të minimizuar pasojat e mundshme të pafavorshme dhe për të siguruar që i gjithë personeli të ketë mundësi të përfitojë maksimalisht përparësitë që ofron përdorimi i internetit, duke qenë të mbrojtur e të sigurt.



**11**

**TREGUESIT  
FINANCIARË  
DHE  
MENAXHIMI I  
BURIMEVE**

**2022**

## 11.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit ka qenë një ndër objektivat e realizuara të AMA-s, në zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit 3-vjeçar, 2021-2023.

Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin  
agjentit tatimor;
- d) financime nga Buxheti i Shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin me nr. 97, datë 21.12.2021, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2022", të ndryshuar, ka miratuar projekt - buxhetin për vitin 2022 për "Të ardhura totale" (Të ardhura korrente të pritshme; Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar; Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar; dhe "Shpenzime totale" (Paga, kontribute dhe shpërblime; Mallra dhe shërbime; Investime korente).

Vendimi nr. 97, datë 21.12.2021 ka pësuar disa ndryshime gjatë vitit 2022, për nevoja të institucionit, si dhe për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjeshme lokale datë 06 mars 2022, në bashkitëShkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje.

## 11.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2022

**Ecuria e arkëtueshmërisë së burimeve të vetëfinancimit për "Të ardhurat korrente të periudhës" dhe "Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar"**

Nr.	Emërtimi	Parashikimi i të ardhurave për vitin 2022	Detyrimeve financiare të lindura OSHMA-ve të licencuara/autorizuara në vitin 2022. Faturime gjatë vitit 2022)	Hequr/shpalur të pavlefshme licenca/autorizime/sistemi me faturash gjatë vitit 2022	Totali i të ardhurave të realizuara viti 2022	Realizimi në % (sipas projekt buxhetit)	Realizimi në % (sipas faktit)
		1	2	3	4	$5=4/(1-3)*100\%$	$6=4/(2-3)*100\%$
A	Të ardhurat korrente të periudhës (1+2+3+4+5+6)	242,223	240,409	8,284	199,575		
1	Të ardhura nga licenca/autorizim + pagesat për rinovimet	214.161	220,089	2,334	181,936	86	84
	a) Realizimi i pagesave nga subjektet televizive privat vendorë		19,272	891	12,404		
	b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale		56,592	0	41,932		
	c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA për OTT, IPTV, Internet TV		61,806	603	50,384		
	d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonike privat vendorë analog		12,990	285	11,302		
	e) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA (kabllorë)		69,429	555	65,914		
2	Të ardhura si agjent tatimor	662	662	3	550	83	83
	- Nga subjektet e licencuar/autorizuar		662	3	548		
	- Nga subjektet hequr licenca/autorizimi				2		

3	Të ardhura nga përpunimi administrativ	1,080	1,930	0	1,970	182	102
4	Të ardhura nga interesat bankare	60			80	134	
5	Të ardhura të tjera (lëshim DVD, fotokopje materialesh)	60	56		56	94	
6	Të ardhura të tjera:	26,200	17,672	5,945	14,984	56	
	-Nga kamatëvonësas	6,113	13,384	1,330	4,682		
	-Nga gjobat	452	4,288	200	1,190		
	-Nga debitorët e viteve të kaluara (licenca/autorizime +5% tarifë RTV)	19,228		4,415	8,376		
	-Të ardhura nga debitorët hequr licenca/autorizimi	407			736		
B	Të ardhura nga paga të kthyera nga ish-punonjës të AMA-s				408		
	<b>Totali i të ardhurave (A+B)</b>	<b>242,223</b>	<b>240,409</b>	<b>8,282</b>	<b>199,984</b>	<b>85</b>	<b>86</b>

AMA, gjatë vitit kalendarik 2022 vijoi me ndjekjen e arkëtueshmërisë të burimeve të tij të financimit, në përbushje të objektivave dhe realizimin e parashikimit buxhetor vjetor. Arritja e këtyre rezultateve u mundësua duke ndjekur kryerjen e pagesave të detyrimeve financiare të lindura në vitin 2022, të subjekteve të licencuara/autorizuara, përmes rrugës shkresore, postës elektronike dhe komunikimit telefonik. AMA, gjatë vitit raportues, ka investuar organet gjyqësore për vjeljen e detyrimeve financiare të lindura ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit nga subjektet të cilave iu janë hequr ose bërë konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve gjatë viteve 2016 - 2022.

AMA, në vitin 2021, në kushtet e krijuara prej vështirësive nga efektet e pandemisë Covid-19, si dhe duke reflektuar përmes dimensionit social në lehtësimin e detyrimeve financiare të OSHMA-ve, kryesisht ndaj subjekteve të transmetimit audio, miratoi vendimin nr. 70, datë 19.05.2021, "Për miratimin e lehtësimit financiar për subjektet audio dhe audiovizivë".

Pikat 2 dhe 3, të vendimit të sipërcituar u zbatuan menjëherë pas marrjes së vendimit, ndërsa pika 1 e tij u zbatua në janar të 2022. Në zbatim të të pikës 1 të vendimit, përfituan reduktimit e pagesës vjetore për licencë për vitin 2022, subjektet audio të cilët kishin shlyer detyrimet për vitin 2021, brenda datës 30 qershor 2021.


Subjektet që përfituan në vitin 2022, janë si më poshtë:

- 8 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge me zonë ofrimi shërbimi deri 1 (një) bashki, përfituan faljen e pagesës vjetore për licencë të vitit 2022, në masën totale 540,000 lekë;
- 33 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge me zonë ofrimi shërbimi mbi 1 (një) bashki deri në 4 (katër) qarqe, përfituan faljen në masën 50% të pagesës vjetore për licencë të vitit 2022, në masën totale 5,460,000 lekë;
- 3 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge kombëtare, përfituan faljen në masën 500,000 lekë, nga pagesa vjetore për licencë të vitit 2022, në masën totale 1,500,000 lekë.

Burimi kryesor i vetëfinancimit të AMA-s janë “Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”. AMA, gjatë vitit 2022, ka ndjekur arkëtueshmërinë e burimeve të saj të financimit, ku zëri “Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”, për periudhën 2018-2022 paraqitet si më poshtë vijon:

000 lekë

Vitet	Të ardhura vjetore të pritshme	Të ardhura vjetore të realizuara	Realizimi në %
2018	190,052	177,352	93%
2019	188,192	183,229	95%
2020	201,973	190,573	94%
2021	216,717	202,107	94%
2022	217,756	181,936	84%




Ulja e realizimit të të ardhurave nga pagesa vjetore për licencë/autorizim në vitin 2022, ka ardhur si rezultat i mosmbylljes së pagesave nga 2 subjekte të licencuara për rrjete numerike kombëtare private tokësore, 1 subjekt i autorizuar për rrjet satelitor dhe 3 subjektete të autorizuar për përsëritje të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në OTT. Në fillim të vitit 2023, subjektet e licencuara për rrjete numerike kombëtare private tokësore dhe subjekt i autorizuar për rrjet satelitor kanë kryer pagesa nga detyrimi vjetor për vitin 2022.

Nënzëri "Të ardhura nga gjobat", bazuar në pikën 13, të nenit 133, të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Gjoha është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s", AMA parashikoi të ardhura për vitin 2022, në masën 452,619 lekë (referuar vjeljes mesatare të gjobave në vitet 2020-2021). Në fund të vitit 2022, si rezultat i pagesave nga vetë subjektet (referuar akt - marrëshjeve të lidhura për pagesa me këste) apo si rezultat i kontratave të lidhura me përmbarues privatë gjyqësorë, AMA arkëtoi 5,950,666 lekë, prej të cilave 1,190,133 lekë (5,960,666 lekë x 20%) i përkasin të ardhurave të institucionit.

Ecuria e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, për sanksione me gjobë, gjatë viteve 2018-2022, për arkëtimet e kryera dhe të ardhurat të cilat i takojnë institucionit, paraqitet si më poshtë:

Titujt ekzekutivë me sanksion gjobë/vitet	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Arkëtimet në total (100%)</b>	12,977	8,832	2,008	2,553	5,951
<b>Të ardhura për AMA-n (20%)</b>	2,595	1,766	402	511	1,190

■ "Arkëtimet në total (100%)  
 ■ "Të ardhura për AMA-n (20%)



Gjatë vitit 2022, pati rritje të arkëtueshmërisë së pagesave për sanksionet me gjobë në krahasim me parashikimin e bërë në masën 452,619 lekë.

## 11.3 Detyrimet financiare të OSHMA-ve

### a) OSHMA të licencuara/autorizuara gjatë vitit 2022

Pasqyra përmbledhëse e OSHMA-ve të licencuara/autorizuara, që rezultojnë me detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, deri në fund të vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Kategorizimi i subjekteve	Licencë/autorizim	Tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive RTV	Kamatëvonesa	Totali
Televizione analoge	6,656	0	2,017	8,673
Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale	14,660	1,896	6,331	22,887
Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT)	9,412	0	3,110	12,552
Radio analoge	1,427	288	532	2,247
Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor	2,721	0	1,257	3,978
<b>Shuma totale</b>	<b>34,876</b>	<b>2,184</b>	<b>13,247</b>	<b>50,337</b>

### b) OSHMA me licenca/autorizime të hequra/konstatim pavlefshmërie, në vitet 2015-2022

AMA, gjatë vitit 2022, ka marrë vendime për heqje/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve. 6 (gjashtë) OSHMA rezultojnë me detyrime financiare, në masën totale 6,220,806 lekë. Kjo shumë përbëhet prej:

- 2 (dy) subjekte të autorizuara për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, në masën 1,569,730 lekë;
- 1 (një) subjekt i autorizuar për ofrim shërbim programi në rrjet IP, Internet TV, në masën 446,250 lekë;
- 2 (dy) subjekte të licencuar për televizion privat vendor, në masën 27,018 lekë;
- 1 (një) subjekt i autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet IP, OTT, në masën 4,177,808 lekë.

Ndërkohë gjatë vitit 2022, nga ana e subjekteve debitorë (hequr/konstatim pavlefshmërie të licencë/autorizime) janë shlyer vullnetarisht dhe nëpërmjet shërbimit privat përmbarimor, detyrimet ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën totale 803,707 lekë (743,874 lekë për pagesë vjetore për licencë/autorizim dhe 59,833 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive).

Për sa më sipër, masa e detyrimeve financiare të subjekteve hequr licenca/autorizimi apo bërë konstatim pavlefshmërie e tyre, ka pësuar një rritje nga 95,027,024 lekë (mbyllja e vitit 2021) në 100,444,123 lekë, (mbyllja e vitit 2022), si më poshtë vijon:

000 lekë

Kategorizimi i subjekteve/vitet	Televizione analoge		Ripërsëritës programi		Ofrues programi		Radio analoge	
	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar
2015	-	-	5	10,405	-	-	-	-
2016	4	5,388	13	40,557	2	25,042	3	1,923
2017	2	276	7	2,754	1	162	3	1,105
2018	6	3,179	7	670	-	-	1	106
2019	1	100	2	2,121	-	-	1	0.3
2020	1	415	1	87	-	-	1	114
2021	1	17	1	51	1	215	-	-
2022	1	9	3	5,748	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>100,444</b>							

## 11.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2022

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projekt - buxhetin për vitin 2022, të ndryshuar, si dhe në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, të ndryshuar.

AMA ka bërë disa ndryshime në projekt - buxhetin për vitin 2022, për nevoja të institucionit, si dhe për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjeshme lokale datë 06 mars 2022, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje.



## 11.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2022

Për sa më sipër, masa e detyrimeve financiare të subjekteve hequr licenca/autorizimi apo bërë konstatim pavlefshmërie e tyre, ka pësuar një rritje nga 95,027,024 lekë (mbyllja e vitit 2021) në 100,444,123 lekë, (mbyllja e vitit 2022), si më poshtë vijon:

000 lekë

Nr.	Shpenzime/Investime	Plani	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2022	Fakti	% e realizimit
		1	2	3	3/(1+2)*100
I	<b>Shpenzime korrente (a+b)</b>	<b>203,969</b>	<b>(7,780)</b>	<b>111,655</b>	<b>57</b>
	a) Paga, kontribute për sig. shoq. dhe shënd., shpërblime	84,161	965	75,406	
	b) Shpenzime për mallra dhe shërbime	119,808	(8,745)	36,248	
II	<b>Shpenzime për investime (a+b+c)</b>	<b>173,280</b>	<b>8,400</b>	<b>13,375</b>	<b>7</b>
	a) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	16,092	2,600	6,992	
	- Studime dhe kërkime (2022)	7,500	2,600	3,800	
	- Studime, kërkime, anketime (të filluara në vitin 2021, për tu përfunduar në vitin 2022)	3,612	0	2,412	
	- Programe/aplikacione	4,980	0	780	
	b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	155,809	5,800	5,160	
	- Instalime, mjete dhe pajisje të tjera, teknike	153,891	0	524	
	- Mobilje dhe pajisje të tjera zyre	1,918	200	148	
	- Mjete transporti	0	5,600	4,488	
	c) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme	1,379	0	1,223	

1.Me fondet e veta AMA realizoi:

Shpenzimet për paga e shpërblime, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (për punonjësit sipas strukturës organizative të AMA-s, si dhe shpenzimet e nevojshme për mallra dhe shërbime të kërkuara nga drejtoritë/njësitë e saj.

AMA, mbuloi me fondet e veta shpenzimet për pagesa për monitoruesit e jashtëm për zgjedhjet zgjedhjet e pjesshme lokale datë 06 mars 2022, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje.

AMA, në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), mbështeti financiarisht KMD në vitin 2021, për projektin: Sfidë urrejtjes - "Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit", në masën 1,496,500 lekë. KMD përfundoi në vitin 2021 projektin në masën 1,089,980 lekë, duke kthyer në llogari të AMA-s shumën e pashpenzuar prej 406,520 lekë.

Zhvillime në të njëjtin profil pati dhe nga Ministria e Kulturës, e cila në vijim të mbështetjes financiare të dhëna nga AMA në tetor 2020 për dy projekte, në masën totale 7,200,000 lekë (3,600,000 lekë/projekt), përfundoi në vitin 2021 projektin "Edukimi përmes Kulturës" në masën 3,550,000 lekë, duke kthyer në llogari të AMA-s shumën e pashpenzuar prej 50,000 lekë dhe në vitin 2022 projektin "Blerje pajisje për Arkivën e Filmit" në masën 3,466,336 lekë lekë, duke kthyer në llogari të AMA-s shumën e pashpenzuar prej 133,664 lekë.

## 11.4.2 Ecuria e investimeve:

Në zërin "Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara", u realizuan:

-Zëri "Studime, kërkime dhe anketime", ndarë si më poshtë:

Projekte të nisura në vitin 2021, për tu finalizuar në vitin 2022, u realizuan në masën 2,412,020 lekë për financime të projekteve me tema: "Monitorimi i zgjedhjeve dhe prioritetet për t'u adresuar në të ardhmen"; "Roli i medias audiovizive në formimin e personalitetit tek femijët"; "Kontrata e munguar e punës dhe dy modele pranë nesh".

Projekte të vitit 2022, u realizuan në masën 3,800,000 lekë për financime të projekteve me tema: "Ndjekja/pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore, teknike të transmetimeve audio/audiovizive"; "Përkthime nga literatura e huaj në shqip" (faza e parë); "Prirje dhe sfida të mediave televizive shqiptare në epokën e postdigjitalizimit" (faza e parë).

-Në zërin "Programe/aplikacione" u krye pagesa në masën 780,000 lekë për "Program kompjuterik për shërbimin Helpdesk" (procedurë e përfunduar në fund të vitit 2021).

Në zërin "Aktive të qëndrueshme të trupëzuara" u realizuan:

-Zëri "Instalime, mjete dhe pajisje të tjera, teknike", në masën 523,880 lekë për: Kaseta LTO; HDD të jashtme dhe Kufje profesionale;

-Zëri "Mobilje dhe pajisje të tjera zyre", në masën 147,900 lekë;

-Zërin "Mjete transporti" në masën 4,880,000 lekë për blerje të një automjeti tip fuoristradë tip 4x4.

Në zërin "Shpenzime për rritjen e aktive të qëndrueshme" u realizuan:

-Zëri "Projekte", në masën 78,958 lekë për projekt - preventin për punime në hollin e AMA-s, për rikonceptimin e tij për realizimin e një biblioteke për qëllime studimore;

-Zëri "Punime", në masën 1,125,534 për punime në hollin e AMA-s;

-Zërin "Supervizime" në masën 19,052 lekë për mbikëqyrjen e punime në hollin e AMA-s.

## 11.5 Pasqyrat Financiare

### Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2021-2022

Referenca e llogarive	Emertimi	Viti 2022	Viti 2021
<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>892.110.808</b>	<b>792.454.406</b>
	<b>I. Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>747.365.452</b>	<b>634.004.089</b>
	<b>1. Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>252.075.212</b>	<b>181.773.131</b>
531	Mjete monetare ne arke	634	186
512, 56	Mjete monetare ne banke	252.074.041	181.772.408
520	Disponibilitete ne thesar	537	537
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	<b>2. Gjendje inventari qarkullues</b>	<b>3.436.703</b>	<b>4.126.082</b>
31	Materiale	3.436.703	4.126.082
32	Inventar i imet		
33	Prodhim ne proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	<b>3. Llogari te arketushme</b>	<b>489.228.525</b>	<b>445.521.863</b>
411	Kliente e llogari te ngjashme	386.476.963	342.683.700
423.429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		

433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetsore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore	6.283	5.483
44	Institucione te tjera publike		5.096.500
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	102.745.279	97.736.180
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	<b>4. Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>2.625.013</b>	<b>2.583.013</b>
409	Parapagime	2.625.013	2.583.013
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	<b>II. Aktivet Afat gjata</b>	<b>144.745.356</b>	<b>158.450.317</b>
<b>20</b>	<b>1. Aktivte Afatgjata jo materiale</b>	<b>36.139.321</b>	<b>38.290.211</b>
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	36.139.321	38.290.211
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
<b>21</b>	<b>2. Aktivte Afatgjata materiale</b>	<b>108.606.035</b>	<b>120.160.106</b>
210	Toka, T,roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesa e Konstruksione	78.644.034	82.417.346
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	19.127.550	28.634.023
215	Mjete Transporti	9.812.612	6.172.429

216	Rezerva Shteterore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	1.021.839	2.936.308
24	Aktive afatgjata te demtuara		
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	<b>3. Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	<b>4. Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Per Aktive Afatgjata materiale		
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>375.361.150</b>	<b>367.051.234</b>
	<b>I. Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>375.361.150</b>	<b>367.051.234</b>
	<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>375.361.150</b>	<b>367.051.234</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	23.583	1.059.893
42	Detyrime ndaj personelit	24.646	23.007
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	911.122	930.798
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	303.908	315.788
436	Sigurime Shendetsores	42.133	44.582
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	51.765.588	55.029.627

467	Kreditore te ndryshem	250.000	
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	322.040.170	309.647.539
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim (-)		
	<b>2. Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
	<b>II. Pasivet afat gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/FONDET (A-B)</b>	<b>516.749.658</b>	<b>425.403.172</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR:</b>	<b>516.749.658</b>	<b>425.403.172</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	293.487.857	232.862.405
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	118.261.801	87.540.767
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale te Brendshme	105.000.000	105.000.000
106	Teprica e Granteve kapitale te Huaja		
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi i Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE (B+C)</b>	<b>892.110.808</b>	<b>792.454.406</b>

## 11.5 Pasqyrat Financiare

### Pasqyra të ardhura dhe shpenzimeve për vitet 2021-2022

Nr. llogarie	Pershkrimi i operacioneve	Viti 2022	Viti 2021
<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>237.954.143</b>	<b>229.227.329</b>
<b>70</b>	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>14.042.309</b>	<b>7.640.106</b>
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogel		
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7020	Tatim mbi pasurine e palujtshme		
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
7029	Te tjera tatime mbi pasurine		
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>658.830</b>	<b>663.970</b>
7030	Tatim mbi vleren e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	658.830	663.970
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombetare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombetare		
<b>705</b>	<b>5.Takse e rruges</b>		
<b>708</b>	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombetare</b>		
<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamate vonesa</b>	<b>13.383.479</b>	<b>6.976.136</b>
<b>75</b>	<b>II.Kontribute Sigurime Shoqerore E Shendetesore</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
750	Nga te punesuarit		
751	Nga punedhenesi		
752	Nga te vetpunesuarit		
753	Nga fermeret		
754	Nga Sigurimet vullnetare		
755	Kontribute nga buxheti per sigurime shoqerore		
756	Kontribute nga buxheti per sigurime shendetesore		
<b>71</b>	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>223.830.588</b>	<b>221.555.542</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>223.830.588</b>	<b>221.555.542</b>

7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	217.756.263	215.452.298
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	1.986.325	3.103.244
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	4.088.000	3.000.000
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>76</b>	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>81.246</b>	<b>31.681</b>
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave	80.030	28.769
766	Nga kembimet valutore	1.216	2.912
<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>720</b>	<b>1.Grant korent i Brendshem</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)		
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshem nga buxheti		
7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)		
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
<b>721</b>	<b>2.Grant korent i Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni i investimeve		
<b>73</b>	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>119.692.342</b>	<b>141.686.562</b>
<b>600</b>	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJESVE</b>	<b>65.905.169</b>	<b>76.378.563</b>
6001	Paga, personel i perhershem	58.274.963	63.732.645
6002	Paga personel i Perkohshem	0	1.707.511
6003	Shperblime	7.630.206	10.938.407
6009	Shpenzime te tjera per personelin		



<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>9.501.403</b>	<b>10.602.039</b>
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	8.530.823	9.513.706
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	970.580	1.088.333
<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>35.180.606</b>	<b>27.816.510</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1.712.340	2.248.315
6021	Materiale dhe sherbime speciale		
6022	Sherbime nga te trete	8.740.623	9.198.694
6023	Shpenzime transporti	4.714.503	1.645.135
6024	Shpenzime udhetimi	10.575.019	5.210.362
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1.534.169	2.346.408
6026	Shpenzime per qeramarrje		
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	7.903.952	7.167.596
<b>603</b>	<b>IV. SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6030	Subvecione per difference cmimi		
6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecione per siper marrjet individuale		
6039	Subvecione te tjera		
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>4.556.316</b>	<b>4.349.281</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>4.556.316</b>	<b>3.550.000</b>
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	4.556.316	3.550.000
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6051	Transferime per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime te tjera korrente me jashte shtetit		
<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>0</b>	<b>799.281</b>
6060	Transferta te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		799.281
	<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>2.674.199</b>	<b>1.480.185</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>2.674.199</b>	<b>1.480.185</b>
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. brendshme		
652	Interesa letra tjera vlere qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore	2.674.199	1.480.185
<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
660	Interesa per huamarrje nga qeveri te huaja		
661	Interesa per financime nga institucionet nderkombetare		

662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
<b>63</b>	<b>VII.LNDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>689.379</b>	<b>1.039.821</b>
	<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>1.185.270</b>	<b>20.020.163</b>
<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES</b> <i>(Rezultati i veprimtarise se vitit ushtrimor)</i>	<b>118.261.801</b>	<b>87.540.767</b>

# ANEKS 1

## ÇËSHTJET GJYQËSORE KU ËSHTË PALË AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

### ÇESHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË

Nr.	Paditës/I paditur	Objekti	Faza gjyqësore në të cilën ndodhet procesi	Fituar/ Humbur në fazën aktuale
1	Paditës: AMA I paditur: Albi Kreci (Tv kabllor Alb Vito Peqin)	Detyrime financiare	Në Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Kthim aktesh
2	Paditës: Gëzim Ismaili I paditur: AMA	Shpërblymi i dëmit për shkak vonese në shlyerjen e detyrimit nga AMA	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pushuar gjykimi
3	Paditës: AMA I paditur: Liberta Thanza	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
4	Paditës: AMA I paditur: Tema sh.p.k.	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
5	Paditës: Dritan Memushi I paditur: AMA	Shfuqizim i vendimit 88, datë 15.07.2022, të AMA-s, që ka lënë në fuqi sanksionin me gjobë nr. 3, datë 05.04.2022	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
6	Paditës: AMA I Paditur: Shoqëria "Kombi"	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
7	Paditës: AMA I paditur: Erisa Bakalli (Durrësi TV)	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës	Në proces
8	Paditës: Shoqëria Media + I paditur: AMA	Shpërblymi i dëmit për shkak vonese në shlyerjen e detyrimit nga AMA	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
9	Paditës: Shoqëria "Nisatel" sh.p.k. I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s nr. 94, datë 09.11.2021 të AMA-s, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 11, datë 29.09.2021	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
10	Paditës: Shoqëria "Tibo" sh.p.k. I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s nr. 62, datë 02.06.2022, që ka lënë në fuqi vendimin e dënimin me gjobë nr. 15, datë 28.12.2021	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
11	Paditës: Shoqëria Tibo" sh.p.k. I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s nr. 63, datë 02.06.2022, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 02, datë 28.01.2022	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
12	Paditës: Shoqëria Tibo" sh.p.k. I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s nr. 106, datë 30.09.2022, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 7 datë 24.08.2022	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
13	Paditës: Shoqëria Tibo" sh.p.k. I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s nr. 115, datë 12.10.2022, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 9 datë 02.09.2022	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në proces
